

BK1

F23

ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ
ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟΥ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ



026000334071



Handwritten signature or initials.



Αριθ. εισ. 141.158

KR. FLOQI

Dëshmorët e Rilindjes

OSG

ΕΡΟΠÉ Ε ΚΟΡÇËΣ



TIRANË
SHTËPIJA BOTONJËSE «LUARASI»
1935



HIJEVE TË SHËJTA

TË

DËSHMOREVET TË KOMBIT

SI PENK ADHURIMI

AUKTORI




Σ. ΣΤΑΙΟΘΡΑΚΗ
ΕΤΑΙΡΕΙΑ ΚΟΥΡΙΑΑ
ΛΑΥΡΙΟΥ
ΑΥΕΩΝ ΑΡΙΘ.



ΔΕΣΜΟΡΕΤ Ε ΡΙΛΙΝΔΕΣ





I.

Fermani i Sulltanit

Vajto, moj Zânë, djelmat Shqiptarë,
Që për Atdhenë jetën s' kursyen,
Trego me radhë si kanë ngjarë,
Trimnit' e veprat q' ata rëfyen!
Prej majës së malit, ku rí e qetë,
Zbrit pak të lutem, o Zâna ime,
Me harpën t' ende ti, si di vetë,
Ligjroji burrat me mallëngjime!
Nem edhe mua në k'të fëllqinjë,
Afshtën e shpirtit, të zembrës flagën,
Forcomë zânin kulmin t' harrinjë,
Të ligjronj trimat, që muarr shqagën!

Urdhën i naltë u dha prej Mbretit,
Sulltan Reshadi, Mbretit Turqisë,
T' i ulen gjithë Baba-Dovletit,
T' i shtrohen urdhnit të Qeverisë;
Gjithë Shqiptarët, rajanjt' e vjetër,
Të mos kuxojnë të ngrehin krye,
Lirin' e gjuhën dhe ç' do gjë tjetër,
T' i lenë dorët pa pik' arsye.



Sulltan Reshadi s' desh të dëgjonte,
Farën e racën e ç' do Shqiptari,
Lirin' e tyne krejt u mohonte,
Shpresën i previ ç' do atdhetari!
Fermani dolli i rreptë shumë,
Ç' far' do lëvizje me u ndalue,
Mjerë Shqiptarët, q' ishin për lumë,
Me varje kishin gjith' m' u dënue!

Ah, sa gabime Shqiptarët bënë,
Tuke ndihmue Anadollakun,
Eshtnat e tyne gjithkunt kan' lënë,
Për Turqit kurrë s' kursyen gjakun,
Dhe sot Turqija, si penk shpërblimi,
U mohon gjuhën, u ndal lirinë,
U pret ç' do sulmë, ç' do rast shpëtimi,
Kërkon t' a shdukë krejt Shqipërinë!
Sa gjë e poshtër, mekat e dhunë,
Kjo sjellj' e dobët e një tirani,
Të durosh turpin, përbuzjet, drunë,
Kërbaçin, thundrën e një avâni,
Të ushqesh gjarpnin e helmatisun,
Në gjin' e ngrohtë, në krahënorin,
Anmikun, bishën e nëmatisun,
Ijenën, tigrën, ujkun, gjaksorin,
Të të helmojnë eshtra, kokalla,
E të të shkelin me këmbë fytin,
Dhe të të zhgulin dhëmb' e dhëmballa
Në gjak, në lotte ty të te zhytin!



Jet' e këtitllë ka si kalohet,
Të vdeç për dita, në varr të ndryhesh,
Robni e poshtër munt të durohet
Të gëlltitsh vnerë, në vaj të krydhesh?
Ku janë burrat, burrat Shqiptarë,
Ata fatosa, trimat e naltë,
Që e çuditnë Europën mbarrë,
Sepsë s' duruan plahur e baltë?
Ata luana, që me burrninë,
E flaknë zgjedhën e tiranisë,
Q' e tretnë shqimit gjithë Turqinë,
Q' i ndalë hovin krejt Osmanllisë?
Ata, q' Europën me një grusht trima
Patnë shëlbue prej një rreziku,
Tuke u derdhun rrufë, vettima,
Që nuk e shkelë këmbë anmiku?
Ndryshe, mos t' ishte zogu i Shqiptarit
Vrulën me i ndalë Sulltan Mehmetit,
Mû në Shën-Pjetër, e mbi alltarin,
Tagji do t' hante ati i Mbretit!

Por, ah, Europa e qytetnuem
Harrovi bolbën, harroj mirsinë,
Flit' e therorët tuke mohuem,
Në thonjt' e ujkut e lá Shqipninë!

Po mbrini koha, që atë zgjedhë,
Kaqe mizore, të paduruem,
Shqiptari qafet përtej t' a hedhë,
Tuke e shkelun, tuk' e dërmuem!



Ti, o moj Zânë, Zân' e Tomorit,
Që ja ké njohtun vleftën Shqiptarit,
Ti ja ké ndyem flagën krahnorit,
Që i thek shpirtin dhe buzë varrit,
Shkëndiz' e zjarit nuk ju shojt kurrë,
Sado që vujti, shpresën s' e humbi,
Ky për gjithmonë u nda si burrë,
Kudo që shkeli vëndin e tundi!
Me faqe t' bardhë dalloj Shqiptari,
Nuk i çnderovi armët kreshnike,
Si penk trashigimi, q' ja la i pari,
Përpjet' i mbajti armët jetike!

Vështrimn' e tija Mbret' i Turqisë
Në Korçen plakë ekish vërvitun,
Se Korça ishte djep' i lirisë,
Edhé Sulltanët i kish mërzitun.
Në Korçë shkrepë shkendi' e parë,
Që i dha flagën gjithë Arbrisë,
Aty dha krye e para farë,
Që ideali leu i Lirisë!

Ahmet Hifzinë, q' ishte myshiri
Edhé Valija i Monastirit,
Në Stamboll befas Mbreti e thiri,
Të marrë urdhnin drejt prej Vezirit.
Të marrë urdhnin, atë fermanë,
Që për Shqiptarët po bënte fjalë,
T' i poshtënonte krejt, an' e mb' anë,
Njeri përpara të mos i dalë.



Dhe Hifzi Pasha u lâ i lirë,
Që të përdorte gurin e arin,
Masën më t' ashpër, më të vështirë,
T' a merte ngutas për Shqipëtarin.

Medet ç' të tirret, moj Korç' e mjerë,
Mbi kryet t' ende ç' rrezik, vërtitet,
Në ç' brek anmiku do të bjerrë,
Popull' i ngratë sa do sfilitet!
Ty s' të mjaftuan zjaret, tërmeti,
Vujtjet e gjaku, që rrké ké derdhun,
Tjetër potërë, po po, ç' të gjeti,
Të shoh të krusun, të shoh të dergjun!

Gjer kur kto shujza, këto pjavica
Gjakun e vlyer do t' t' a thëthijnë,
Këto gjarprushe, këto mushica
Do të të tretin, do të të shkrijnë?
Po, mos kij frikë, o Korç' o lule,
Se djelmat trima nuk të turpnojnë,
Nuk do t' të lenë në ferra e sdrule,
Dhe këtë herë do t' të nderojnë!

Pashaj, kur kthehej ish i hutuem,
Ish fort i gjyfkun me shum' andralla,
S' hante, as pinte, rinte i mentuem,
Urdhnat që morri nuk ishin prralla!
Prej atij urdhni varrej shpëtimi
Edhé qendrimi i gjenerallit,
Prej atij urdhni varrej gradimi,
Ose dënimi i mareshallit!



Në merqez Pasha posa ja mbriti,
Thiri me një herë Hafûz Pashanë,
I foli rëndë, e porositi
Qysh t' a zbatonte pikrisht fermanë.
Ky e puth urdhnin, e vé në ballë,
Shumë premtime i dha myshirit,
U kreshperua, u soll vërdallë,
Ky mirallahi i Monastirit.

Qyrdi i egër, fis gjakatari,
Xhelat i famshëm i Ermenisë,
Aju që s' ngopej kurrë së vrari,
Tash do t' i turrej dhe Shqipërisë!
Ky Ermeninë në gjak e mbyti,
Tigrin e bëri si kaşaphânë,
Grâ, pleq e burra i preu nga fyti,
Gjaksit' e tija nuk kishin anë!
Këtë për vegël Valiu c zgjodhi,
Si mirallahin e Vilajetit,
Edhé nga Korça me vrap e hodhi,
Si t' i shërbenjë mirë Dovletit.

N' atë qytetin e Monastirit,
Prej kohësh shumë kishte fillue,
Si një shkëndizë nga shpuz' e hirit,
Frym' atdhesije me gurgullue.
Disa Shqiptarë atjë të mbledhun,
Punonin fshehtas e pa një bujë,
Themel' e parë e kishin hedhun,
Pa turbullime, e pa rëmujë.



Ata Kongresin patnë shkaktue
Për allfabetin e gjuhës s' onë,
Shkronjat llatine patën pranue
Për me e shkruie gjuhën gjithmonë,
Edhé me vujtje e me mundime,
BASHKIMN' E KOMBIT nxuar në dritë,
Gëlltitnin lotte e pikëllime,
Por se punonin si ca petritë!

Doktor Bedrija, q' ish nga Përmeti
Pat kryesue shoqnin' e parë,
Dhe sa do mijra pengime gjeti,
S' u tremb ; pat shokë mjaft kuximtarë.
Ramis bej Dibra dhe Dervish Hima
Ishin Kollonat e Shoqënisë,
Mustafa Qulli me disa trima
Edhe Shqiptarët e Rumanisë.
Levizj' e tyne pati jehime,
Në gjithë këndet e Toskërisë,
Dhe u shënuan mjaft vepërime,
Në popull frynte er' e lirisë.

Viti pas tjetrit tuke kalue,
Ata Shqiptarë kurajo muarr,
Tuke nxitue, tuke kuxue,
Vepra të gjalla prej duarsh nxuar,
Dhe me Xhon- Turqit më von bashkohen.
Për me fitue lirit' e tjera,
Kundra Hamidit për dit forcohen,
Gjer sa i shkrepn një dit potera,



Dhe çpalli vetë Konstitucionin
Për gjithë popujt e Osmanllisë,
U dha të drejtat, q' ata kërkonin,
Ashtu ja njohti dhe Shqipërisë.
Por se Xhon Turqit si u forcuan,
Fjalën s' e mbajtnë, besën e shkelë,
Sulltan Hamidin si e rëzuan,
Zun' e përdornin sheshazi dhelë.
Edhë sulmuan me hov Shqiptarët,
Tuke ndalue të gjuhës msimin,
Msuësit gjithë dhe gazetarët,
Zun' i burgosnin, qetë s' i lijnin !

Në Korçë vetëm burgosun ishin
Dyqint djelmosha, lul' e trimrisë,
Që prej sijsh shumë faj nuku kishin,
Veç se urrejtjen e Qeverisë.
Ish i dyshimtë i tyne fati,
Sepsë në Korçë që shtet-rrethimi,
Mbret' i Turqisë, Sulltan Reshati,
Deshte t' i shdukte farën ç' do trimi!
Kështu Shqiptarët u egërsuan,
Ehë filluan komita, çeta,
Zembrat e tyne nuku duruan,
Liri kërkonin me kraht' e veta!

Komit i parë Tajar Tetova
Dolli ndër male me disa shokë,
U dha Xhon Turqve shëmblla e prova,
Pllanet e tyne i bâni trokë.



Shokë dy nipa kishte të tjtë,
Sadikun trimin dhe Muharremin,
Djelm por si Zâna, si dy petritë,
Edhé Korçarin Misto Gërmenjin.¹⁾
Me 'ta bashkohet edhe Meleqi,
Një div i gjallë, div i Dangllisë,
Xhelal Prevera q' ish vetë dreqi,
Zabit i njohtun midis Ushtrisë.
Kishte akoma shoke të ndjerë,
Spiron, Mihaln nga Bellkameni,
Hakki Devênë, Xhevatn²⁾ e tjerë,
Merron e Zylfon, q' ishin nga Treni.

Kjo çetë Xhonvet ju qit pengime
E u vé këmbët më një këpucë,
Prandaj filluan rahje, dënime,
Shqiptarët ndiqshin vër' e birrucë.

Dy atdhetarë, dy shpesh të lehtë,
Ranë viktima të Xhemijetit,
Sepsé punonin me gjak të nxehtë,
Përkundra urdhnit Sulltan Mehmetit.
Një prej këtyne ish Zavalani,
Memduhu i shkretë, në vluk djalrije,
Dhe Telemaku, vigan vigan,
Vllaj i Gërmenjit, lule trimrije,
Të dy të zgjedhun, djelma Korçarë,
Shkrinë mundime me dit me natë,
Çuna me ndjenja e atdhetarë,
I korri dora xhon-turk' e thatë!

Shumë lëvizje ishin shënue,
Nga gjithë anët e Toskërisë,
Dhe shumë burra ishin dallue,
Tue formû çeta kundra Turqisë.

¹⁾ Themistokli Gërmenji, ²⁾ Xhevat Korça.



Nazif Hajdari nga Gjinokastra,
Çerçiz' i Topullit nga Labërija,
Bektash Cakrâni nga Mallakastra,
Ali Tremishti nga Dangëllija,
Demo Emini nga Kurveleshi,
Mehmet Bitincka ng' an' e Bihlishtit,
Islam bé Goça nga Martëneshi,
Jaup Dishnica ng' an' e Hoçishtit,
Jashar Starova, Misto Gërmëni,
Salih bé Butka mù në Kolonjë,
Ali Çausi, Isref Vërlëni,
Dhe Dilaveri bash në Lubojnë.
Përveç këtyne mjaft atdhetarë,
Çeta, programe oganizonin,
Pa pikë frike, fort kuximtarë,
Nj' Atdhé të lirë gjith' ëndëronin!

Ndër 'ta dallonin Doktor Hakija,¹
Rodhja,² Karoli,³ Bimbli,⁴ Tromara,⁵
Naçi,⁶ Gramenua,⁷ Neps Kërënxhija,
Kosturi,⁸ Gjika,⁹ Goni,¹⁰ Erbara,¹¹
Cilka¹² Avrami,¹³ Qani Dishnica,
Ypi¹⁴ Pojani¹⁵ dhe Mengulâsi,¹⁶
Visua,¹⁷ Aristidhi,¹⁸ dhe Nikolica¹⁹
Pëppua²⁰ dhe Plasa,²¹ Alem Trajâsi²²,
Hafëz-Alija²³ Floqi²⁴, Berati²⁵
Të trë të aftë e me kulturë,
Që Komitetiti faktor' i pati,
Që pënd' e tyre nuk u loth kurrë,

1 Dr. Haki Mborja 2 Kol Rodhja 3 Stavre Karoli 4 Llambi
Bimbli 5 Vasil Tromara 6 Nuçi Naçi 7 Mihal Gramenua 8 Idhomen
Kosturi 9 Vangjel Gjika 10 Goni Katundi 11 Jashar Erabara 12
Grigor Cilka 13 Thoma Avrami 14 Qani bej Ypi 15 Sami bej Po-
jani 16 Emin Mengulasi 17 Gaqi i Thanas Visos 18 Kritaq Aristidhi
19 Hysein Nikolica 20 Gavril Reppua 21 Shaban Plasa 22 Alem Trajasi
nga Vlora 23 Hafëz-Ali Korça 24 Thanas Floqi. 25 Dhimitri Berati.



Dhe sa të tjerë që nuk harrohen,
Për sa shërbime Kombit i prunë,
Që bres-pas-brezi do të kujtohen,
Jetën e tyne në rrezik vunë!

Pëzân burrija, pa gdhirë mirë,
Vihen në vepër pizgat, zurnatë,
Kërcet daullja si e rëpirë,
Frika i morri burrat e gratë!

Zot, ç' ishte gjithë ajo humnerë,
Zhurmi i fortë që pat shbërthyem,
Gjith' ajo gjâmë, ajo poterë,
Që shkrepri befas e pa pandyem?
Mbyllen shtëpitë, mbyllen dyqanet,
Milet' i gjorë tepër po tutet,
Mbyllen kafetë, pjetoret, hanet,
Popull' i ngratë s' di ku të futet!

Javo kasuëci me zâ vikati:

Dëgjoni, popull i Osmallisë,
Urdhën ka dhanë Sulltan Reshati,
T' i binden gjithë Mbretit Turqisë.
Kush të kuxojë të ngrehë krye,
E pret e zeza, e pret litari,
Pa gjyq, pa ligje, pa arësye,
Qoftë i fundit, ose, i pari!

Bije daullja të dytën herë,
Edhé dëgjohet prapë burrija,
Bërtet tellalli me një poterë
Që t' a dëgjojë gjithë djelmrija:



Hej, popull, popull, mbaj veshin mirë,
Arnautllëku zu të lëvizë,
Zu të përpiqet, të rronj' i lirë
Punë të keqe Mbretit t' i ngjizë!
Thonë se qendra â Monastiri,
Ku po punojnë ca Shqipëtarë,
Embën ka dalë sot nga Myshiri,
Kush që të kapet do mbes' i vrarë!
Monastirllinjte të hapin sÿtë,
Me Shqipëtarët të mos shoqnohen,
Në këtë çashtje, kaqe të ndytë,
Pjesë mos marrin, se do pendohen!

Këto kasneci Monastirllinjve,
U tha me gojë, i këshillovi,
Dhe ushtërija e Osmanllinjve
Fërmanin me armë e salutovi.

Ushtria morri rrugën përpara,
Sanxhakut Korçës tue ju drejtue,
Topa e gjyle, fyshek' me barra,
Për Shqipëtarët i kish ngarkue!

Ushtojnë fushat, malet gjëmojnë,
Prej zhurmit turmash të ushtërisë,
Rënkton dhe toka nga do kalojnë
Topat e kuajt e kalorisë;
Nxin fush' e Korçës prej Turkushakësh,
Që u përhapnë si karanxhatë,
Prej Qyrdësh, Llazësh, Anadollakësh,
Q' ishin gjakpirës edhe xhelatë!



Prîjsi i tyne urdhnin e kishte
Për rahje, djegje, vrasje e mvarje,
Dhe si mizuer ky gati ishte
Me vepërue ç' do farë ngjarje!

Në Korçë ndodhej një grup djelmoshash,
Trima, shtat-derdhun, në trup të lidhun,
Gjithfarë vërsash, gjithfarë moshash,
Fytyrë-âmbël e jo të hidhun.
Ishin prej shtpive shumë fisnike,
Të rritun mirë e me tiparë,
Djelma me ndjenja patriotike,
Burra kreshnikë, burra Shqiptarë.
N'ata krahnorë i nxehtë vlonte
Gjak i kulluët, një gjak i vlyer,
Që prej tiranve shpagë kërkonte,
Tue ra therorë pa u kursyer.
Të zjartë, t' hekurt, trima me besë,
Nuk dijshin trembje, frikën s' e njihshin,
Ç' do kush e shihte se do të vdesë,
Për 'ta mjaftonte gjith' flî të bijshin!

Për disa shkaqe, mjaft strategjike,
Q' u biseduan pak dit mâ parë,
Kjo çet' e vogël, çeta kreshnike,
Cak në dy orta ish qën' e ndarë.
I ortës s' parë ish Bellkameni, ¹⁾
Prijës, q' i printe ortës krenare,
Rrufé prej Qjellit, timoni, frêni
Që do përballte turmën barbare.

1) Spfro Bellkameni



Flokët e tija mbi supet bijnin,
Baluket fqollë si ibrishimi,
Dy gjarpërushe buzët i zjnin,
Q' ishin mustaqet e ketij trimi.
Me vehte kishte kushri-Mihalë,²⁾
Një shpesh të lehtë, trim si dragua,
Që nuk i mbshtetej përsipër alë,
Me sÿ të forta, një sÿ-fajkua.
Pason Tërbaçi,³⁾ një djal i hijshëm,
Një buzë-qeshun, i holl' i gjatë,
Djalë dyfegu, në zell i vijshëm,
Syn' i tij s' flinte as dit' as natë.
Furxhiu Kristaqi, një trim i urtë,
Q' i zhgulnje fjalët vetëm me darrë,
Dukej i fjetun, tepër i butë,
Por se në luftë ish krejt i marrë,
Pse, kur dëgjonte zhurmë baroti,
I terrej mëndja, i ndizej gjaku,
Ishte i tmerrshëm, tepër i zoti,
Po dhe i pjekun me mëndje plaku.
Pas atij vinte nje tjetër djalë,
Q' ishte Petraqi Krastafilaku,
Thatik në ftyrë, mjaltë në fjalë,
Fisnik në sjelljet, fisnik nga gjaku.

2) Mihal Bellkameni

3) Halim Tërbaçi



Midis këtyne dallonte bukur
Një fatos tjetër me shtat selvije,
Tepër i matun, tepër i strukthur,
Me ca tiparë, q' i kishin hije.
Ky ish Stefani i Kondillarit,
Trim i përmendun, Shqiptar i kjartë,
Turrej në flagë, në mes të zjarit,
Shumë gjak-nxehtë, tepër i zjartë.

Por, zot, kush ishte ajy fajkua,
Ajy lesh-dredhun, me sÿ gjaksore,
Ajy shtat bukur, si një pallua,
Ajy zok mali, reja mizore?
Oh, ishte Nuçi, aj Nuçi Lapi,
Që nuk i dhimbej gjâja e jeta,
E Turqve kossa, exheli, drapi,
Cok gjeraqiñja me thonjt' e mprehta!
Ky kish luftue kush di sa herë,
Gjilldrim i rrebët, i shpejt' i aftë,
Ku do që binte shkrepthe poterë,
E kapitanit ish dor' e djathtë.

Prijës i dytë ish Panariti,
Qamil' i hijshëm si një pallua,
Shprohë, i turrshëm por si astriti,
Panther i gjallë, tigër, dragua!
Ishte i fortë, mjaft i kuxuem,
Tepër i vrulshëm, teh' jatagani,
Ordhit' e Turkut i kish tmerruem,
I meritonte t' ish kapitani.



Sabri Dajlani, kushriu i tija,
Që me qerpikun të shtinte frikën,
I kuq, i bardhë, trim si lubija,
Përdorte aftas shpatën e thikën;
M' andej Tosûni nga Selenica,
Një trim i rallë, me sÿ skyfteri,
Që mbante pushkë system-Novica,
Shêjën e tija s'ja ndante peri.
Pas Dilaveri, një zok Lubonje,
Djalë shtat-gjatë si qiparisi,
Që nuku ngjinjej sa t'a shëkonje,
Çinar i fortë, si bush, si lisi.
Llambi i Bimblit, një shpatull-gjërë,
Një vetull trashë me sÿ shgabonje,
Q'e ndiqte hasmin vër' e më vërë,
Fytyrë-vrazhët kur e vështronje.
Odhysé Kotta, një djalë-djali,
I gjat'i shtatshëm, një trim me fletë,
Që kur e shihnje hipun një kali,
Thojshë se ashtë ëngjelli vetë!
Kostaq Kosturi, vigan-vigani,
I bir'i Spiros, që Grekt'e vranë,
Në vluk Pranvere, me shpirt luani,
I rinte prijsit gjithënjë pranë.
Ish i patrembun, përpinte retë,
Ishte i aftë, ishte i gjallë,
Turrej si flagë, por si shigjetë,
Kuxim'i tija ishte i rallë!



Pashua nga Butka, një shtat-levendi;
Ngjeshun në armë e fort shtrënguem,
Që kur luftonte s'lose nga vendi,
Si trunxh i fortë, div i kreuem.
I mbrami ishte Musaj nga Psari,
Një burrë-burri, por si çeliku,
Që nuk ish ngjinjun Turqit së vrari,
Q'i bante ballë ç'fardo rreziku.
Munt të luftonte pa lodhun kurrë,
Fuqin' e shkrinte gjer më të mekun,
Në meterizet qendronte burrë,
S'lëshonte vëndin veç se i vdekun!

Por ish një tjetër, që kur e shihnje,
Të merrte frika, hethet të zihnin,
Ari, ujk, bishë ç'ishte s'e njihnje
Dy veta bashkë poshtë s'e vijnin!
Kur fliste tundej trualli, toka,
Zân'i tij ngjiste si halurimi,
Dridheshin suka, dridheshin boka,
Si kur se malet kur shkrep gjëmimi!
Ky ish murrâshi, trim Bajaziti,
Djalë Rehovet, zok Kolonjari,
Që edhe vetë Sulltan Hamiti,
Vleftën ja dinte këtij Shqiptari.

Tetar mâ parë ish i Turqisë,
Shërbente n'armën e Zhandërmasë,
Po, kur dëgjovi zân'e Shqipnisë
Tjetër nuk priti askush t'i flasë,



Rëmbeu dyfegun e ç' tjetër mundi,
Vjen e bashkohet me shoqt' e tjerë,
Luftoj shpeshërë, Turqin' e tundi,
Shpresë, kurajo s' humbi as nj' herë!
Ish burr' i lidhun, mustaqe-verdhë,
Me Bellkamenin ishte vëllamë,
Gjaqe të mjafta kishte pas' derdhë,
Ishte i njohun trim në ç' do lëmë.
Trimnit' e tija edhe kuximi,
Ishin në shëjë, s' kishin të shara,
Ishte agzoti i ç' do sulmimi,
Mbiembnin tjetër e kish *Tromarra!*

Thonë se ishte dikur ngatruë
Me një bimbashin e kalorisë,
Për shkak një pele, që kish kuxue
T'ja marr' eprorit në mes t' ushtrisë!
Ish pel' e tija, në grasht i lindi,
Vet' e kish mbajtun, ushqyem, rritun,
Edhe me pare mbassi s' e bindi,
Bimbashi pelën ja pat grabitun!
Fjalë shkëmbyen, u egërsuan,
Bimbashi tepër randë e shavi,
U kapnë fytas e u grykuan,
Sa Bajaziti i ra, e vravi!
Por se në gjyqin ushtrak që rrodhi,
Heroji jonë ish i përkrahshëm,
Se kryetari një Shqiptar ndodhi,
Dhe Bajaziti doll' i pafajshëm!



Këta të gjithë ishin betue
Për mbi Flamûrin, mbi armët kryqe,
Flî e kurbanë m'u therorue,
Tue kundrështue ordhi, bylyqe.
Ishin të gatshëm për d' do përpjekje,
Dojshin të binin gjithë dëshmorë,
Për symbol kishin LIRI a VDEKJE,
Shkruem secili mbi krahënorë.

Një tmerr i fortë Korçën e kapi,
U mbyllë brenda, u çqetësuan,
U kishte ardhun në prak kasapi,
E kishin humbun gjithë torruan!

Mbushen kazermat plot me nizamë,
Bisha të egra, labica Ferri,
Që si në mveshje, si në të pamë,
Po t'i vezhgllonje të zinte tmerri!

Ditën e nesërt, kur agoj drita,
Mirallaj Pasha parin' e thiri,
Fjalë u bani për ca komita,
U foli ashpër, mnerrën u shtiri!
Edhé kërkovi t'i dorëzohen,
Përndryshe zjarin ky do t'u vinte,
U dha një kohë që të mendohen,
Gjall' ose vdekun ata t'i zinte.

Kto tha Qyrd Pasha, dhambët u ndriti,
Tepër i trembi, i frikësovi,
Masa të rrebta morri *jeziti*,
Korçën e qetë mjaft e trazovi!



Lajmi i hidhun ra si sharpnellë,
Tundi qytetin, tundi krahinat,
Kratër vullkani që zë të vjellë,
Llavat ë tija me djeg' rrethinat!
Po, Korça plakë s' e humbi tragën,
Shum' her' i shkrepnë kësij potera,
Sot do të hidhte terrën, a lagën,
Zarrin e fundit loste e mjera!

Çetat e vogla me një grusht trimë,
Këto të gjitha po i dëgjonin,
Pa mbrijt' ushtrijs, por si shkrepnë
Ishin larguem, rrotull përgjonin.
Ishin përcjellë me shumë urime,
Me armt' e lara ngjeshun, piskllue
Nga do kalonin merrnin bekime
Çetat q'i ishin Kombit kushtue!





Mihal Bellkameni, Gamil Panariti, Siroi Fellononi



II.

T m e r r i

Dolli Hylli mbi Morravë,
Shum' i vrânët, mjergull plot,
Edhé rétë ravë-ravë,
Zunë Qjellin, s' shihet dot!
Moti duket mjaft i trabull,
Poshtë fushës një qetsí,
Nuk pëptin as zhurm' as vrundull,
Vdekj' e plotë, vaj e zî!
Nuk lëvis as gem, as fletë,
S' fryn as erë, zagushí,
Fush' e Korçës asht' e qetë,
Thua se vërtitet shí.
Prrënjt' u thanë, shterroj lumi,
Krua, çezmë ujë s' ka,
Korçën e ka marrë gjumi,
Një rrezik mbi kok' i ra!
J ra mbi krye rreziku,
Shum' e dergji, e dërmoj,
Sepsé s' i ndahet anmiku,
Ky anmik, që e farroj!
As një dritë s' sheh gjëkundí,
As një llambë nuku djek,



Gjâma popullin e tundi.

Shumë vuan, shumë heq!

Kishte shkrepun një dit zije,

Ugursëze e pa hîr,

E përvajshme e pa shihje,

Ditë vneri e plotë cimir!

Nuk kuxon njeri të dalë,

Gjithkush brenda po qendron,

S' dëgjon zâ, kuvent, a fjalë,

Thua jeta po mbarron!

Pushoj kanga e *ahengu*,

Në ç' do kënt e në ç' do cep,

Pushoj mllinja, pushoj bengu,

Pushoj foshnja mù në djep,

Pushoj zân' i bagllamasë,

Pushoj fyell' i bariut,

Pushoj tingll' i tamburasë,

Pushoj vallja e të riut!

Folë ti, moj Zân' Hynore,

Ç' e ka gjetun Korçën sot,

Psé kto suka, kto bregore

Duken se qajnë me lot?

Ç' ashtë ky gazep-gazepi,

Që mbi krye sot i ra,

Kjo e zezë që i shkrep,

Kjo e keqe kjo *hata*?

Pse po qajnë me vaj gratë,

Foshnja pse dridhet në bark,



Korçës mos i ra lëngatë,
A gjâ tjetër-qoftë lark-?
A mos arat karkaleci
Qyme-qyme ja sulmoj,
Apo pemëve bubreci
Palc' e gjethe u lëmoj?
Mos pësuan bagtí, shtâza,
Mos i çqeu ujku mizor,
A në berrat ra gëlbaza,
A sëmundje tjetër' i korr?

Jo, moj Zânë, gjë s' e gjeti,
Korça e pasun ashtë sot,
Djelmt' e saj që nga kurbeti
I dërgojnë pare plot.
Grurë rrafsh i ka hambaret,
Bereqeti veshillon,
Misër dink i ka kosharet,
Korçës gjâ nuk i mungon,
Po, ah. vuan prej sikleti,
Ankth' i saj nuk ka shërim,
Nga Sulltan Reshad Mehmeti
I vjen rrotull një shkatrim!
Djelmt' e saj, q' i pa, q' i rriti,
Nuk i ka brenda në gjí,
Fati duarsh, ah, ja çqiti,
Muarr male, muarr vrí,
Edhe fill' i tyne s' dihet,
Si do vejë paskëtaj,



Qysh se ngryset e se gdhihet
Korçës loti i shkon vaj!

Qajnë mëma, qajnë motra,
Qajnë nuse, vajza, gra,
Ju shkrepnë carrâj e votra,
Fort halldupi i ka vra!
Do të mbesin, ah qyqare,
Do mos gjejnë një ngushllim,
Pa vëllazën, pa djelm fare,
Pa një pikë përdëllim,
Do t' u rijnë vendet zbrazët,
Do të vishen në të zî,
Kukumjaçkat nër pullazët
Do t' u mbajnë shoqëri!

Ah, anmiqtë shekullorë,
Që mëkati n' a i çoj,
Sot n' a kanë rob në dorë,
Hij' e prindve n' a mallkoj!
Ehû! u detmë pas premtimesh,
Nuk menduam për Atdhé,
E u rrejtme prej gadhnimesh,
Q' i fituan po me né,
Dhe sot zogu i Çagatës
Ra si sorra me lakmí,
Edhé me fuqin' e shpatës
E pushtoj këtë Shqipri,
Edhé pse vleftën na njohti
Zu përdori dhelpëri,



Mjaft çifligje n'a dhurojti
Bejllëk, rytbe e florí,
Deri sa n'a ndroj dhe besën,
Që dhe sot mbet trashëgim,
Deri sa n'a previ shpresën,
E n'a la në kaq mjerim!
N'a mundoj, n'a shtiu nër halle,
N'a përçau, në fat n'a lâ,
E n'a futi në një valle
Që të vrasim vlla me vlla!

Deh, moj Zâna e Gramozit,
Si duroj kjo Shqipëri,
Nënë zjar' e mitralozit,
Kaqe shekuj në robni?
Si s'iu tha kamba kur shkeli,
Kjo lubí në Rumeli,
Si u la edhe qysh ngeli
Ky i huaj Turçelli?

Ah, mëkatet katragjyshe
Tash i lajnë nipt' e rí,
Edhé si nuku bajné ndryshe,
Po përpiqen për liri;
Por Shqiptari tash u zgjua,
Tash gabimn' e morri vesh,
Tash qellimit ju afrua,
Nuku mundesh mâ t'a rresh!

Hafuz Pasha asqer' e mblodhi
E kshillon, e përgatit,



Disa oficerë zgjodhi,
Një nga një i porosit,
U dha urdhën të vrapojnë,
Dërgoj shpejt një kalorí,
Që komitat t'i rrethojnë
E t'u bijen me furrí.
Do të tjerë ndau në çeta,
Në për fshatrat i drejtoj,
Korçën me nj'a dy qint veta
An' e mb' an' e qarkulloj,
Dhe në kisha e xhamija
U këndua urdhn' i rí,
Fort e rrepët shkrep stuhija,
Ish një tmerr, një mizorí!

Mbrëmanet në dy-mbë-dhetë
Do të mbyllej ç' do njeri,
Askush jashtë do mos jetë,
Burrë, plak, a miturí,
Dhe me llozet gjith' shtëpitë
Do të ndryjshin an' e kant,
Do mos ndizej as një dritë,
Do mos delte as pasvant,
Përveç rrojet e patrullat
Tjetërkush të drejtë s' kish,
Dhe kalybet edhe kullat
Mbyllun secila do t' ish.
Prindve të disa komitve
Tjetër urdhën u kumtoj,



T' u lajmonin shpejt *jezitive*
Komandanti ç' ka urdhnoj,
Edhé shpejt t' i dorëzohen
Se t' i fal' ishte gatí,
Ndryshe shumë do pendohen,
Po nuk ardhi një ujdí,
Edhé prindët do t' i zinte,
Do t' i kalpte mû në burk,
Kambë synesh do mos linte,
Do të vinte gjaku çurk!

Kështu foli Hafuz Pasha,
Gjithë Korça e dëgjoj,
Qyrdin që hiqte të trasha,
Fort e nami e mallkoj!
Shaloj atin, një dorí,
Me një shalë telatini,
E i vû një fré të rí,
Plot me pulla prej pllatini.
Ngjeshi belthit një nagan,
Mbathi çizmat, u krekua,
Si një shprohë, një vigan,
U ngjesh mir' e u shtërngua.
Kryenalt' i hipën kalit,
Dhe dorriu u turr si ré,
Shetit fushën anës malit
Edhé me dylbí vé ré.
Ka me vehte ca ushtarë,
Graduat' e sufari



Ca Arabë, ca Konjarë,
Ca Çerqez' mustaqe-zî.

Kali sillet djatht' e majtas,
Shkel të mbjellme, kopsht, livath,
Kithi, shulthi, shkarthi, gjatas
Shkel gradinë e shkel garth.

Si një bishë e etuem
Që del shtroklit me furrí,
Dhe nga stel' e saj hutuem
Turret e çan pyll e vrî,
Si një shkerbë që breth shpatit
Edhé gjahun po kërkon,
Dhe tue shkue monopatit
E nuhat e e gjyrmon,
Ashtu Hafuz Pasha brithte,
Ç' do skundill e ç' do tërmall,
Bregje, kodra, sukthe hithte,
Si një ujk, si një çakall.
Moti vjen e errësohet,
Mirallahi po vashdon,
Herë ngutet, herë çohet,
Herë ulet e përgjon.
Fort i gjatë ju duk dhromi,
E zu nata, tërrët ish,
Sorollatet nga Qatromi,
Edhé has më një dervish.

Varfa i gjorë e priti mirë
I shtroj buk' e gjell' e ç' kish,



I dha t' hajë e për të pirë,
Ajk' e qumësht, kos e mish.
Dal-nga-dale kuvent zûnë
Folë për Ushtrí e Mbret,
Në komitat fjalën prunë,
Dervish plaku, dëgjon, s' flet.
Qyrdi i tregon qellimet
Që do vintë në zbatim,
E litarin e mundimet
Për një shtypje, nje shkatrim.
Po dervishi, plak i matun,
E pret me gjakftohtësi,
Dhe kuvendin pa e zgjatun,
Kshtu i thotë qyrdit t' zî:
— E dëgjo, or t' u ngjat' jeta,
Pashaj im, *hasretleri*,
S' kanë vënt kto të përpjeta,
K'tu i thonë Shqipëri!
Ksaj i thonë «Shqipri Plakë»,
S' u çnderua gjer më sot,
Dhe Shqiptari s' ha shuplakë,
S' e ka than' i madhi Zot!
Ju, me krahun e ktij burri
Muarrrt zylm' e muarrrt *shan*,
Ky ju çoj ku piqet guri,
Në Hexhaz, n' Arabistan;
Me Shqiptarin ju kuxuat
E harittë në Vijen,
Me fuqin' e tij zaptuat,



Bagdat, Basrë e Jemen.
Mâ besnik se Shqipëtarin
Osmanllija tjetër s' ka,
Trimn' e math e luftëtarin
T' a poshtnoni, âsht' *hatâ*!
Ç' ju kërkojnë djelmtë t' onë
Perveç gjuhë e liri?
Fort mëkat, *gjynah* për Zonë,
Ju t' ju mbani kaq mëri!
Pasha, dëgjo dervish plakun,
Një Allah të dy n' a sheh,
Mos prish zembrën, mos prish gjakun,
Zoti të drejtën e njeh.
Ktheu, *evlat*, që nga ké ardhun,
Mos derth gjak kështu më kot,
Se Shqiptari e ka zbardhun
Faqen, ballin, me 'të s' lot!
Për ca djelm nuk fletgjâ Mbreti,
Nuk i sjellin një ngatrim,
Nuk do bahet *kijameti*,
Që kërkoni një shkatrim!
Kto tha plaku, mjekër-bardhë,
Mbi shkop mbshtetun, me qetsí,
Nënë një të dendun dardhë,
Fort gjakftoht' e me butsí.
Mirallajt s' i ardhi mirë,
Edhé vrik përpyjet' u hoth,
Ment e çqeu si egërsirë,
Shtat' i tija fort u droth!



S'ish i msuem t'a qortojnë,
U çudit për kët kuxim,
Nuku desh t'a këshillojnë,
Nuk pranont'as një afrim;
Dhe me sýt'e zgurdulluem,
Ftyr'e tij u zbarth, u zbéh,
Si i marr'i çartalluem,
Varfën plak në vënt e vé!
Më së fundi s'ju durua,
Gërcet dhambët, tokën reh,
Shumë tepër u kreshprua,
Thua se i ra rrufé!

— O dervish, ty t'raftë pika,
Nuk e di qysh të duronj,
Fjalët më shpojnë si thika,
Kshtu më vjen të të coptonj!
Më vjen të të shkel në grykë,
Të të shtrinj mbi dhé përmbys,
Paske qënë delí, pykë,
Si duronj e nuk të mbys!
Po, kij hîr për sa që fole,
Se qellove një fetar,
Nuk më trembni me gogole,
Do t' të shkonja në litar.
Po nderova rrobën t'ënde,
Jé një plak e s't'i vé ré,
Sa më thé e sa përmënde
Ktu i fole, ktu i lé.



Po, hap sytë tjetër herë
Dhe pa matun ti mos pré,
Se, vaj halli, mor i mjerë,
Do t'të mbjell si presh në dhé!
Rruji, mos i nqasni pranë,
Mos u bani streh' *jatak*,
Se ju djek teqé e ç'janë,
Ju shtronj gjithve në *dajak*!

Kështu foli qyrd-halldupi,
Dorën heth mbi revolver,
Po dervishi nuk e hupi,
Fjalët mbrapa nuk i merr!
Ishte një plak mjaft i njohtun,
Trim, sy-qutë, plot burrní,
Kishte par'e kishte vojtun,
Ish përpjekun për Shqipnía!
Mjekar'e tij e bardhë dborë,
I harrinte gjer në bres,
I mbulonte gjoks, krahnorë,
Ish shpirt-math e pa një ves.
Me *syr gjyne* ishte mvelun,
Tarablúz, Fas e Misir,
Kurájua e tij s'kish ngelun,
Psé pa burg, pranga, zinxhir!
Morri do memurijetë,
Grada e nishan ngjeroj,
Shërbeu në kaq Vilajete,
Po Atdhenë s'e harroj;
Dhe me gjithë pleqërinë
Shpirt'i tij s'duronte dot,



Kur kujtonte Shqipërinë,
Syt' e tij mbusheshin lot!
Dhe kur pa ky varfë plaku
Që ju mat me revolver,
Ju prish mëndja, ju nxeh gjaku,
Edhe syni fort ju terr!
Desh t' a kapte vrik për fyti,
Por u mbajt e nuk u ngut,
Urtësi' e tij s' e shtyti,
U shtang nj' anas, po s' u tut,
Dhe mjaftoj një sÿ t' i hedhë,
Sÿ që të dërmon, të vret,
Edhe vehten tue përmbledhë,
Nuk e çoj mâ tëj, po mbet!

Katallân-Hafuz-Harapi

Hipi kalit edhe shkoj
Dhe me sa i hante vrapi
Nga qyteti e drejtoj;
Dhe sado që ra me fjetë,
Gjumi nuk e merrte dot,
Kish një ankth e një të nxehtë,
Dervish plaku s' foli kot!
U ngrit shtratit si i marrë,
Tue bërtitë, e tuke shâ,
Kurrë nuk i kishte ngjarrë,
Turp këjo për një pashâ!

Nesërmet pa gdhirë mirë,
Oficerët gjith' i thret,



Ju flet ashpër e rëpirë,
Dhe dy fjalë nuku pret:
— Uh, *harram* buka ju qoftë,
Po nuk batë një kuxim,
Nami juaj krejt u shoftë,
Po s'më prutë një fitim;
Po nuk zutë gjall komitët,
Për nj'at Zot do t'ju dënonj,
Po s'm'i suallt ktu jezitët,
Që të gjith' në plump ju shkonj!
Kryet t'uaja pa tjetër,
Do t'i kem si *qefalët*,
Po s'e kryet këtë vepër,
Mjërë ju se ç'gjâm'ju pret!
Në mos qofshi aq të zottë,
Shkoni, mbyti, mos u shoh,
Në ju vaftë mundi kotë,
Nuku dua mâ t'ju njoh!
Hajt, pra, hapi, zijni shtegjet,
Hiqni shpejt, pa humbun ças,
Merrni malet, merrni bregjet,
Merrni ç'ka ju duhet pas;
Topat, bombat, mitralozat,
Bini, korrni, vini zjar,
Çani rrushkujt, ferrat, shkozat,
Vrisni, prisni ç' do Shqiptar;
Pikë mëshire të mos kijni,
Mos kurseni as pleq, as gra,



Gur mbi gur ju të mos lijni,
Mos u ngijni tuke vrâ!
Dua gjaku rrokë të vejë,
Kamb' Shqiptari të mos lé,
Këjo punë funt të gjejë,
Do t'i baj pluhun e dhé!

Kështu çfryu Halldup-Harapi,
Si rrufé zabitve ju ra,
Frika, tmerri gjith'i kapi,
Gjithësekush u mek, u vra!

Ah, të shkretët oficerë,
Me sa frik'e sa shpejtí,
Fort të prekun e të mjerë,
Më një ças ishin gatí!
U dëgjua turumbeta,
Gjith' ushtria armët merr,
Nisen shpejt si grigje-mbleta,
Buz'e tyne kullon vner!

Por si greñat, kur harbohen,
Edhé derdhen si një ré,
Por si sorrat kur lëshohen
Me ushtim, me bataré,
Ashtu tundet ushtërija,
E gërthet me brohorí,
E përhapet si mizrija
Grigje-grigje, sogorí,
Dhe utrojnë fusha e kodra,
Shkrep një mnerr e një duhí,



Dhe shungllojnë pizga, lodra,
Tallas, zhurmë, një stuhí


Zunë rripat, bregjet majat,
U përhapnë me nxitim,
Zunë bjeshkat e ográjat,
Vunë pllanin në zbatim.
U shpërndanë nër katundet,
U stalisnë në ç' do vënt,
Ushtërija, sa i mundet,
Gjyrmon cep e gjyrmon kënt.

Ti, o Hý, të qofsha falë,
Më trego se ç' ngjau at' dit,
Ç' tmerr, ç' poterë, ç' farë valë
Katundarët i godit!
Si filloj me hov dajaku,
Gjâm' e vaj e ulërim,
Si rrijodhi currill gjaku,
Lot e vner edhe pikllim!
Zot, si digjen kulla, ksolla,
Shtëpi e vathë, strung' e stan,
Si grabiten plângj' e t' holla,
Kusí, enë e kazan,
Si mundohet ç' do barí,
Si rëmbehen dhën e dhí,
Rihen bujq e katundarë,
Vihet zjari nër mullarë,
Digjet misri nër kosharë,
Vëgla, qerre e hularë,



Tymi flaga shkon te Qjelli
Edhé s' mbetet kokër meli!
Ç' ishte gjith' ajy kjamet? —
Oh, fshatarët se ç' i gjet!
Po, ah, kjo qënka e thâna,
Fat' i katundarit t' zî
Të shohin krahët e râna,
Mall e gjâ t' u bahet hî?
Dridhu tok' e Shpipërisë,
Këtë dhunë mos duro,
Ti, moj lule e djalrisë,
Bjerri hasmit e dërmo,
Bjerri shqerbës së mallkuem,
Shkeli fytin, mjaft e lé,
Çeli dita e bekuem,
Të përpiqesh për Atdhé!





ÇETA E SPIRO BELLKAMENIT

III.

Betimi mbi Armët

Folmë, o Hyneshë ti,
Ç'jan'ata dy djelm të rí,
M'ata sý po si shkëndí,
M'ata shtate si selví,
M'ato vetulla si shpata,
M'ato perçe fqoll të gjatta,
Me të bukura tiparë,
Si fatosa legjendarë?

Ç'jan'ata që bisedojnë,
Që po nguten e vrapojnë,
Ndenjun njatë n'hijeshí,
Nën'atë të dendun blí,
Pa më thuaj, pa mërzi,
Psé tregojn'aqe ngutsí,
Psé vezhgojnë me aq droje,
Mos i përgjon ushtrí, roje,
A mos hahen për do troje,
Që po nxjerrin shkumbra goje?

Psé, pa dalë Hyll'i rí,
Afërdita rreth-florí,
Kanë dalë n'atë brek,
Janë unjun n'atë shtek,



Psé kaq shpejt e lanë shtratin,
E muarr përphetë shpatin,
Gjer sa gjetn' atë limer,
Që syn' i njeriut s' e merr,
E shpërndanë karaulla
Rreth e rrotull si patrulla,
Tuke marrë ç' fardo masë,
Që askush mos t' i përkasë?
Ata janë dy fajkonj,
Dy sqyftera, dy drangonj,
Dy petrita, dy luâna,
Dy fatosa kapitana,
Njani Spiro Bellkameni,
Tjetri Qamil Panariti,
I par' i rrebtë si gorrëni,
I dyt' i fortë si graniti,
Që të dy si reze Djelli,
Që të dy rrufë prej Qjelli,
Majë bregut n' atë sllok,
N' atë mrizë, n' atë plok,
Si dy shpeshë, dy petritë,
Flasin në terr e pa dritë,
Japin, marrin, kuvëdojnë,
Herë nxehen, her' qendrojnë,
Herë ulen, herë çohen,
Herë sbuten, her' akrohen,
E flasin sikur ulrijnë,
E gjëmojnë e utrijnë,
Gjer sa gjejnë një afrim,
Gjer sa marrin një vendim!



Bellkameni piksëpari,
Çohet me një afshë zjari
Me një duf, një pezm të plotë,
Qamilit këto i thotë:
— Do t'a bajmë nj'herë fora,
Me kta derra, me kta horra,
Që m' qafë kaq'n'a ranë,
Që një shtek gjëkunt s'n'a lanë,
Qe n'a vrasin por si berra,
Që n'a therrin por si shqerra,
Plânk e pasje që n'a marrin,
Që n'a rrjepin, që n'a varrin,
N'a rëmbejnë nderin t'onë,
Që e mbajtmë nalt gjithmonë,
N'a farrojnë mot për mot,
Edhé po n'a shdukin sot!

Jo, për Zotin, nuk durohet,
Me kta ujqë nuku shkohet,
Nuk duronj shallvar Halldupi,
Burizân'e një magjupi,
As përbuzje, as të shara,
As të ndraqm'e të pa-lara!
Kta gjakpirës mjaft orvatnë,
Mjaft n'a çqyen e n'a çvatnë,
Mjaft n'a shkelë e n'a doqnë,
Mjaft n'a rrjepnë e n'a poqnë!
Lé të ndizet, pra, shkëndija,
Lé të dalë tym e flagë,



Le të çohet krejt Arbnija,
Lé t' u marrë sot një shpagë!
Lé të vejë gjaku krua,
Lé të mbes' e vé ç' do grua,
Lé të qajnë mëma e motra,
Lé të shkrepën shtëpi e votra,
Lé të shëmbet fshat, qytet,
Lé të bahet fusha det,
Të përmbysët rrafsh' e shesh
E të bahet një përsesh,
Mbi gërmadhat të bërtasin,
Huta e sorra të këlthasin,
Se, pa bamë një kuxim,
Nuk shkon ndryshe, o shoku im!

Po s' u ndes kështu Shqiprija,
Po s' u morri Turqvet hakkun,
Po s' u çua sot djalaria,
Po s' u dha shkelmin, shuplakun,
Nesër, ah, do jetë vonë,
Turku rob n' a ka gjithmonë!

Vujtjet t' ona do t' a zenë,
Lotet t' ona qet' s' e lenë,
Lé t' i vjellë sot anmiku,
Që n' a shohti e n' a fiku!
Sa të jemi skllëv' e robë,
Të paguajm harraç, gjobë,
Të n' a kalbin në budrumë,
K' ta, të huaj, k' ta Dudumë,



Lé t'a bajmë sot rëmujë,
Lé të dalë pllamb'e ujë,
Lé t'i ndajmë që sot laknat,
Lé të turbullohen gjaknat,
Të vrengrinjë jatagani,
Që t'a marrë vesht Sulltani,
Dhe Xhon-Turqit aq' të marrë,
Lé t'a njohin sot Shqiptarë,
Për né s'ka Bajram e Pashkë,
Sot s'n'a ndajnë, jemi bashkë!

Kështu foli kapitani,
Gjithë rredhet e kan'ndi,
U droth vendit si luani,
Sÿn'i tij lëshoj shkëndí!
E u nis e u spillua,
Armët fort shtërnguem ngjesh,
Fort u nxeh, u zgurdullua,
Ju skuq faq'e ball'e vesh!

The petrit'i rí Qamili,
Kapitan-Spiros ja pret,
Me një zâ por si bilbili,
Si një rké, që lehtas shqet:
— Sado jemi një grusht trima,
Zembra n'a e thotë sot,
Do të shkrepin si ushtima,
Kohën nuk e bjerrim kot!
Gjithëkushi do çuditet
Qysh u bâ gjithky kuxim,



Gjithsecili do habitet,
Psé nuk patmë pak mejtim!
Do n'a marrin për të marrë,
Do n'a marrin për *deli*,
S' do të lenë gjâ pa sharë,
Do n'a quajn çilimí,
Po, si do që t'a pleqnojnë,
E t'a marrin për gabim,
Nuk prish gjâ psé n'a qertojnë,
Mjaft t'harrijm' atë qellim,
Se, nga fjala njeri s'lot,
Do t'i dalim çashtjes zot!
Kjo e drejtë nuk mohohet,
Zot'i Math ashtë me né,
Se Shqiptari nuk turpnohet,
Kur lufton për një Atdhé!

Këto troje, që të parët
N'a i lanë trashëgim,
S'i lëshojmë né Shqiptarët,
Do t'i mbrojmë me kuxim.
Lé t'a marrë vesh gjith' bota,
Që kto fjalë s'jan' të kotta,
Lé të dalë tym e flakë,
Tue luftu' me Turkushakë,
Pllambë toke nuk cedojmë
Fyt për fyt pa u kap' me 'ta,
Me gjak t'onë do dëshmojmë,
Lé të shuhen burra e gra,



Ojell e Dhé të bâhet një,
Djellë mos flakronjë më,
Shkrump e hî, gjithçka u shk reptë,
Do luftojmë, gur mos mbettë!

Kshtu vikati Panariti,
Shokët gjith'e vunë ré,
Jataganin fora e qiti
Dhe u turr me bataré!

Si një shpirt të gjithë hidhen
Dhe rreth kapitanve mblidhen,
Urdhnin presin shpejt e shpejt
Si t'a marrin shpagën shtrejt!
Vendim marrin me një herë
Gjith'ata trima të ndjerë,
Qysh e nga do t'ja fillojnë
Dhe qysh pllanin do zbatojnë.

Por se, befas Bajaziti
Nuk duron, as nuku pret,
Dhe me syt'e një lluriti,
Kapitanve kshtu ju flet:

Ju, m'a falni, or kapitana,
Që po hynj në bisedim,
Do t'ju flas sa më mban ana,
Thashë t'hesht, po s'kam durim!
Do t'ju çfaq dëshirën t'ime,
Një këshillë do t'ju jap,
Pa ju fyem, pa zembrime,
Nj' ashtu mëndja si m'a kap.



Ju, në dashçi më dëgjoni,
Dashçi mos i merrni sÿsh,
Po të doni m'i pranoni,
Duhet ndamun njâna dysh.
Nuku ban të vepërojmë,
Kshtu si jemi në një bllok,
Duhet pllanin t' a ndryshojmë,
Ndryshe n' a bajnë bërlok!
Nuk ja dalim dot rrezikut,
Po s' e ndamë çetën dysh,
Nuk i bajmë ball' anmikut,
Nuk del mir' as një *yrysh*.
Njana çetë do të zerë
Gjattë grykën e Dërsnikut,
Tjetra në Vockop do bjerrë
Afër majave t' Bejllikut,
Kshtu do mbrohen gjithë grykat,
Klyçet me aq randësi,
Duhet vû të gjitha pyklat
Sa n' a mundet, me ngutsi!
Sa për anën nga Kolonja,
Dy, trë shokë lé t' a marrin,
Mjafton Dilaver Lubonja
Shtek me zânë për mbi Qarrin;
Për skërkat e Boboshticës
N' a mjaftojnë Dvoranakët,
Edhé grykat e Dishnicës
Do t' i rruajn fusharakët,



Sa për Mborjen strategjike
Janë zënë gjith pusitë,
Për ç' do hov, fërtym' anmike,
Janë mjaft ata astritë!
Për Cangonjin e për Plasën
Kemi kush t' u vinjë hakkut,
Se atjë e muarr masën
Burrat trima të Zëmbllakut.
Brenda fushës t' a ndalojmë,
Mos t' i japim një mejdan,
Bash aty t' a kufizojmë,
Sa të thot' vet' «aman»!
Do t' a mbyllim brenda qarkut,
Do t' i presim hovin krejt,
Do t' a shtyjmë tutje tharkut,
T' i kushtojë shumë shtrejt!
Kam luftue me Azabë,
Kam luftue me Moskof,
Me Felah' e me Arabë,
Në Misir, Jemen, Azof;
Ku s' kam vajtun e s' kam qënë,
Në Tunûz, në Qyrdistan,
Në sa luftra nuk kam rënë,
Në Halep, në Llazistan,
Me pak fjalë di nga pllanet,
Edhé nuk gabohem dot,
Shahit kam këto nishanet,
Që s' m' i falnë nj' ashtu kôt!



Kur të shohë Hafuz Pasha,
Se ju zu ç' do shtek e vënt,
Nuk do presë mâ të trasha,
Do të vijë shpejt ndër mënt;
Dhe do Zoti ban një gafë,
E n' a çporret që këtej,
Thyhen xverk e këput qafë,
E merr raqet, shkon përtej!
Kshtu po them me mëndjen t' ime,
Se jam tepër shum' i vojtun,
Do të marrin prej nesh msime,
Turqit bukur i kam njohtun!
Në dëgjofshi këto fjalë,
Në më sjellçi mua besë,
Kujtonj mirë do n' a dalë,
Kam te Zoti shumë shpresë.

Kshtu mbaroj trim-Bajaziti,
Fjal' e tij përshtypje la,
Bellkameni, Panariti,
Gjithkush randësi i dha.
— *Ashk ollsân*, bré Bajazit,
Ja pret Qamil Panariti,
Goja jote, si magnit,
N' a freskoj e n' a përsriti!
Ti pëshoke katër-qint,
Tani po të njoh mâ mirë,
Me një fjalë, n' a ké bint,
Nuk n' a lé në erësirë!



Jé gjakftohtë, flegmatik,
Fjala të ka duk e shije,
Ti do t' ishe një *ferik*,
E një prîjës ushtërije,
Pó të pruni fati sot,
Të të kemi këtu pranë,
Pirolla, bré Rehovjôt,
Dhe lum shokët që të kanë!

E si pa se gjithë çeta
Nuku pat një kundërshtim,
Shtiri sýt e tij të mprehta,
Ju dha shënjën për marshim.

Një kushtim at' ças shbërthen,
Si gjënim, si valë deti,
Si tallaz që me turr vjen,
Si një krizm' e një tërmeti,
Edhé çohet gjer në Qjell,
Zân' i zjart' i Djalërisë,
Si vullkan, që pshtymë vjell,
Si mallkim kundra Turqisë,
E shungllojnë hone, pllaja,
Kodra, brigje prozhme, maja,
An' e kant jehon, buçet,
O Zot ç' ashtë kjo që ngjet!

Një ushtim kumbon me nj' herë
Një lëvizje, një shpejtí,
Edhé kohën pa e bjerrë,
Ç' do fatos u gjent gati!



Armët kryq mbi dhé storasin,
Nxjerin shpat' e jatagan,
Për ty, o Shqipni, bërtasin,
Dhe betohet ç' do vigan!

Kishte shkrep' e bardha ditë,
Hyjet shdukshin me nxitim,
Qjelli kish lëshuem dritë,
Hâna ishte në perndim.
Zoqt' akoma po këndonin
Me një ândje, një galldim,
Thoshe trimat po shoqnonin
Që tregonin aq kuxim!

Aty afër një mburrimi,
Mbshtjellë me lajthiza plot,
Q' ishte shtegu i ç' do trimi,
Q' uji i tij kullonte lot,
U vërsulë gjithë burrat,
Lanë syt' e u freskuan,
Edhé vrik tue hedhë currat
Në një rank gjithë qendruan!

Bellkameni prijs' i parë
Ndan të tij' e i merr pas,
Dhe me shokët pa u ndarë
Përqafohen me një gas.
Edhé nisen e vrapojnë,
Tepër lehtë, por si zoq,
Thua se në dasmë shkojnë,
Shpresën kush prej zembret s'hoq,



Edhé marrin të përpjetën,
Si veriu edhé si era,
Hov'i tyne shkon shigjetën,
Si kur shkrep me vrul humnera!

Prej Vithkuqit rrugën zenë,
Shkojnë gjatë monopatit,
Në Shën-Pjetër mbajnë penë,
Tue i ra tërthoras shpatit;
Aty puthen edhé ndahen,
Të dy çetat dysh përçahen,
Njana merr gjatë Dërsnikun,
Për t'u matun me anmikun,
Edhé çet'e Panaritit,
Merr tërmalin, ec përpjetë,
Zenë Kishën e Shën-Mitrit
Si rrufeja që çan retë,
Dhe kalojnë dushnja e driza,
Edhe zhuga e murriza,
Herë pisha, herë bungje,
Herë ahe, herë sungje,
Në silahet revolverët,
Dhe mhi supet mauzerët,
Kanë kama gjiritllesha,
Që i quajn «pullumbesha»,
Më të mëngjër jataganë,
Të praruem me nishanë,
Dhe disa mjekra të gjata,
Për t'i zanë Turqit data!



Trandet vendi nga do shkojnë,
Si kaprollet fluturojnë,
As minutën nuku ngelin,
Thua se mbi tokë s' shkelin!

Ecën, ecën e s' qendrojnë,
Nga do shkojnë vezhgëllojnë,
Kodra, maja bregje lenë,
Gjer sa sosin në Polenë,
Ku e presin atë rymë,
E qendrojnë e marrin frymë!

Çeta tjetër tuke zbritun,
Në Dërshik qendroj në pritë,
Turkushakët tue i pritun,
Zuni shtegjet e pusitë.

Nër katundet ç' do që ngjiste,
Prej asaj ushtris Tartare,
Ç' do që sillej e lëviste,
I dëgjon çeta Shqiptare.
U vjen keq, u dridhet zembra,
Duan shpagën t' u a marrin,
U gurgllon gjaku në rembra,
Për Halldupin, gjakatarin!

Mjerë fshatrat se ç' pësojnë,
Si të fushës e rrotull saj,
Të këqija sa durojnë,
Sa lott derdhin e sa vaj!
Por katundet e Malsisë,
Që Halldupi s' i pat shkelun,



Do t' i bijshin ushtërisë,
Sÿnin e kishin të çelun.

Ish përhapun shpejt kushtrimi,
Ishin gjith' të pregatitun,
S' u mungon aspak kuximi,
Ishin tepër të mërzitun.

Sa të treteshin më kambë,
Sa të vdisnin nënë zgjedhë,
Do t' u jepshin një pëllambë,
Si kur gjaku çurk të rrjedhë!

Dit' e arthme - dit' trishtimi -,
Si do qoftë do të shkrepse,
Ose dit' e një burrnije,
Dit' e bardhë, dit' liriye,
Ku me pushk' e bajonetë,
Shqipëtari kry-përpetë,
Me fuqin' e jataganit,
Do t' i delte zot mejdanit,
Ose ditë e një zije,
Që shkatrrim të plotë bije
Që do tretej porsì vesa
E Shqiptarit gjithë shpresa!

Ohi, Zâna ligjërore,
Gjakun e pafajshëm ndale,
Këto toka arbënore,
Këto fusha e moçale,
M' atë gjak të mos vaditen,
Djelmt' e njohmë të mos vriten!
Të mos vriten djelmt' e njohmë,
Si një lule, një aromë,
Ndryshe jepu llas e shpresë,
Frymzoji në detyrë,
Kush ka lindun do të vdesë,
Por, me nder, jo me mynxyrë!





ÇETA E ÇERÇIZ TOPULLIT;

IV.

Tradhëtija

Nem fuqí, o Nëmë, nem,
Nem fuqí të nam at' horrin,
Që farrosi kaqe djelm,
Nëmë, name ti tradhtorin!
Nam tradhtorin faqezí,
Që shkretovi kaq shtëpija,
Që shkaktoj kaq vaj e zî,
Në kaq mëma, motra e bija!

Ah, ne ka në Qijej shkëmbënj,
Tash të gjithë të lëshohen,
Të vershojnë prrënj, lumënj,
Gjith' tradhtorët të gropohen!
Të mos mbetet sijsh nishan,
Dheu të hapet t' i përpijë,
Në Sketerr' a në *Zëndân*,
Zjari, flaga t' i përfshijë!

I mallkuem qoft' aj fis,
E mallkume qoft' ajo farë,
E ju shembtë tjegull, plis,
Mos i mbift' as thëkën n' arë!
Verbën e pa sy u pafshin,
Pa plánk, lypës, dhjakonjarë,



Helm, e ankth sijsh mos u ndafshin,
E gjithmon' u heqshin xvarrë!

Tym e terr mbi ty u shkrepshin,
O tradhtor, gjithnjë lëngofsh,
Tamth' e trut' e tu t' u tretshin,
Një gzim kurrë mos ngjerofsh!
Mos t' u ndohtë hî në vatër,
Mos paç hîr, miqsi e hatër,
Mos paç bukë, një kothere,
As për veshje një levere,
Për ty shterrtë krua e vrell,
Të pafsha vjerr' a shkue n' hell!
Mos gjeç shtrofk' e mos gjeç shtek
Hû më hû e brek më brek,
Edhé natën djaj, lugetë,
Kurrë mos të lançin qetë,
Si shtërpî u heqsh për tokë
Ç' do që prekç t' u bastë trokë
Vofsh i mjerë mbi shtrat ratë,
Mos t' u heqt' as një lëngatë,
E mos paç as një njeri,
U mundofsh gjer në pleqni!
Dhe në vdekjen një të dytë
Mos paç kush të t' mbyllë sytë,
Sorrat kërmën ty t' a xhvatshin,
Qëntë eshtnat të shpërndafshin,
Bres-pas-brezi, mor horr-horri,
Për ty thançin: Qé tradhtori!

.....



Zot, ç' pësoj Qamili sot,
Që po sillet këtë natë,
Psé s' po flé i ngrati dot,
Mos dëgjoj ndo një mandatë?
Psé tregon kaq fort mërzí,
Psé rí tepër i hutuem,
Mos i arth ndonji lajm' i zî
E e la të pikëlluem?
Duket se nuk ka qetsí,
Ashtë tepër i drobitun,
Ka një ankth' një angushí,
Ftyr' e tij ásht e venitun!
Buz' e tij vner e pikllim,
Ka një dhimbje, një andrallë,
Nuku gjen as një ngushllim,
Sorrollatet, vjen vërdallë!

Ah, të mjerit çeç i ngjau,
Që s' ka mujtë me mbyll' sytë,
Diç e trembi, diç e vrau,
E në brengë e ka shtytë!
Deh, i gjori kapitan,
Dertin s' ka kujt t' ja dëftenjë,
Zembr' e tij duket se qan,
Një shërim nuk munt t' a gjenjë!

Pa një ândër për çudí,
Fort të keqe, të tmeruem
Që dhe vetë ky nuk di
Si e qysh duhet shpjeguem!



Ish ndër Qijëj e u gremis,
Ra përposh në disa vurqe,
Aty mbetet e s'lëvis,
E kafshuan fort do cfurqe!
Shum' i dhembti, u trondit,
Në trup ndjevi disa plagë,
Shum' u zbëh e u drobit,
Dhe në shpirt ju ndes një flagë!
Edhé gjaku ju bâ qelp,
E i morri gjithë shtatin,
Zembra ju droth gjer në thelp,
Si kur pa vdekjen, *xhelatin!*
Plagët i majisnë fort,
E ju çfaqnë në kangrenë,
Tjetër s' priste veç një mort,
Të vdekun në vorr t' a venë!
Dhe atjë ku ish gati,
T' epte shpirt e të mbaronte,
Ndjeu një hije më shpejtí,
Kamb' e duar t' i sharronte,
Që e lé galamsh e shyt,
Si kufomë pa gjymtyrë,
Q' e përplas edhe e zhyt
Në një llom, batak të ndyrë!

Këjo ânder shum' e vrau,
E përsllovi e e theku,
Ç' do vlak gjaku ktij i thau,
E gajasi e e meku!



Çohet shpejt me një vërtik,
Fërkon shtë si i marrë,
Ndjen një tmerr e një rrezik,
Kësij ândre s' kishte parë!
Shtije shtë nalt mbi Qijell,
E sheh hyjet që vettinin,
Edhé armët i përmbshjtjell,
Që si ari po shkrepnin.
Ri i shurdhën e s'ban zâ,
E mbleth vehten e mendohet,
Vërtet pa se s' ishte gjâ,
Por se shpirt' i tij s' qetsohet!

Ish një natë si stihí,
Mjaft e terrët e e rândë,
Nat' e keqe, plot mërzí,
Pa pik' er' e pa një ândë.
S' tundet rrap; as tundet lis,
Hone, gërxhe nuk jehojnë,
As një fletë nuk lëvis,
Thua gjithë se rënkojnë!
As një kang' as një xhurrâ,
As një fyell prej shtërpari,
As një sorrë nuk bân «krrâ»,
As një erë prej thimari,
As një shpesh nuk ligjëron,
Duket se ranë në gjumë,
Një pushim tek do mbretnon,
S' ndjehet as rëké, as lumë!



Qijell' i kalltërt hyje plot,
Duket det si një kërnjallë,
Hyjet si kur derdhin lot,
Hâna nuk kuxon me dalë!

Si një gocë, vash' e ré,
Q' u lint nemece, pa gojë,
Q' e vrerosun mëma e sheh,
E pret fjalën t' i dëgjojë,
Dke natyr' ashtu qendron,
E përzishme, e lënduem,
Për herojin q' andëron,
E që ri i dëshpëruem!
Thua se i bahet shoq,
Kapitanit buzë-plasun,
Q' ju zhurit, e që ju doq,
Shpirti i tij për shoqt' e dashtun;
Se i vinte shumë keq
Sepsé tepër i drithronte,
Mos bijnin në kurth, në leq,
Frikë kish, prandaj mendonte!

Cok at' natë, n' atë terr
Që njeri nuk shihej jashtë,
Që Korçarëve një tmerr
U kish thekun palc' e ashtë,
Nga një lagje, një shtëpi
Tej xhamis së Mirahorit,
Del me ngut një burr' i ri,
E çel derën e oborit.



Prej një grazhdi kalin nxjer,
E shalon fort mir' e bukur,
Dhe prej freni jasht' e nxjer,
Pa një buj' e pa u dukur.
Kalit at di ç'ka i tha,
Fort nga dal' i pëshpëriti,
Vitheve dy her' i ra,
Kali e ndjeu, e turfulliti!
M'andej mbi shpin' i kërceu,
Ktij karrajt, varvat, të gjallë,
Edhé tatëpjetën theu,
Drejt Vockopin tue përballë.

Në Polenë kryeplak,
Ish njeriu i asaj nate,
Që rrezik s' peshont' aspak,
Mveshun në sërm' e savate.
Kish një mik shumë besnik,
— Si ajy e kish kujtue —,
Q' i kallzonte ç' do rrezik,
Fshehtas e pa u kuptue.
Që memûr në policí,
Ku shërbente disa vjete,
Hypokrit e faqezi,
Që merrte me grusht rryshfete!
Kryeplaku këtë shpesh
Me mexhit' e darovitte,
Dhe kështu ky merrte vesh,
Ç' do të ré prej tij e shqitte.



Kryeplaku kish djéni
Për sa ngjisnin e takonin,
Edhé çetat gjer tani
Dijnin qysh të vepëronin.

Aj i ngratë e dinte mik,
Shumë her'i zbraste barkun,
Por ky ish njeri i lik,
Që nuk kishte shok në qarkun!
Kish haritë dal-ka-dal,
Sa t'i thesh këtij lugati
Ç'ngjiste me çetat në mal,
Ç'do lidhní që me 'ta pati,
Edhé, se shtëpí e tij
Ish një dëpo, një *xhephâne*,
Me arm' të systemit t'ri,
Edhé me disa shishâne.

Ish njerí pa djallëzí
Atdhetari i uruem,
Sa besoj një faqezí,
Besoj bishën e mallkuem!
Burr'i mirë, patriot,
U dallua n' Amerikë,
Psé dollarët me grusht plot,
Për Atdhé harxhoj pa frikë;
Edh'ahere kur dëgjoj
Se djelmnija zû të tundej,
As minutën nuk duroj,
Por me sa fuqí q'i mundej,



Ardhi shpejt në Shqipëri,
E përzjehet e merr pjesë,
Tok me djelmt' e Brezit t' rí,
E punonte pa përtesë.

Si një burrë me guxim
E i kthellët, i sinqertë,
I patrembun, fatos, trim,
Për Atdhenë shum' i vleftë,
Nuk kursente gjâ e mall,
Për nj' at' ideal të shëjtë,
Do përpiquej sa ish gjall,
Gjak fisnik i vlon ndër dëjtë!

Çetave shum' u ndihmoj,
Me të holla e me vepra,
I frymzoj, i inkurajoj,
S' kish pallavra, as kish gjepra!
Me ata kish miqësi,
Kapitanët fort e donin,
Ky u jepte ç' do lehtsi,
Dhe të gjith' e adhuronin.

Në Polenë kur u sos
Trimi Qamil Panariti,
Ish sigûr se do e mos,
Do t' a piqte, prandaj zbriti.
Në shtëpi shkoj e kërktoj,
Por, mjerisht, atjë s' e gjeti,
Dhe këjo mjaft e lëndoj,
Edhé mëndjen nuk e fjeti,



Pra, si mikun nuk e gjet,
Kafshoj buzën e më s'foli,
E kuptoj se di ç'ka ngjet,
Rëmbeu shokët edhe doli.

Heû! Moj Zâna-Perëndeshë,
Ndehu pak e më kallzo,
Më trego, o mbretëneshë,
Dhe mysterin m'a shpjego,
M'a zbulo atë myster,
Që shkaktoj shkatrim të plotë
Tradhëtorin se ç'po tjerr,
Që Korça u mbyt në lotë!

Ky polici mëkatar,
Ish njeriu i Xhemijetit,
I pa-shpirti ish Shqiptar,
Rob i shitun i Dovletit!
Bahej mik me ç' do njeri,
Harrin të loste kuleta,
Hiqej patriot i rí,
Shishte shtrejt disa të fshehta,
Por mâ tepër blinte ky,
Se sa shishte e kallzonte,
Të gënjente sÿ-ndër sÿ,
Të mashtronte, të tradhtonte!

Kryeplakut fukarâ,
I tregohej mlk me kokë,
I rëfehej e vlijâ,
Si për vehte, si për shokë.



Kish kurdisun po një pllan,
Që komitat shpejt të zihen,
Dhe pa tjetër, pa derman,
Turqve në dorë t' u bijen.
Prandaj mikun e kshilloj,
Që në fush' ata t' i hiqte,
Me dhelpnî e tradhëtoj
Istiqamesh t' i tërhiqte.
Tuke ditun ky lugat
Gjith' të fshehtat, hollësitë,
Çashtjen mâ tutje s' e zgjat,
Qyrd-Pashân' e qit në dritë!
Edhé çkoqun i kallzoj
Për llagamin e llogoret,
Një nga një ky ja zbuloj,
Si dhe një mashinë doret,
Që komitvet u shërbente,
Për marrveshj' e ç' do veprim,
Që as dreqi nuk e gjente,
Veç me dhel e me mashtrim!

Mirallaj kish një kollas,
Një spiûn nga Monastiri,
Që gjithnjë e mbante pas,
Ja rekomandoj Myshiri.
Shum' i poshtëm ky dushman,
Një katil, fis gjakatari,
Sarhosh, harbut e nopran,
Qen, shpëtuem nga litari!



Ish. i vrazhët, immoral,
Gjâ pa bâmë nuku linte,
Zembër-lik, cmir-math, një djall,
Desh Shqiptarët t' i përpinte!
Ish i dobët, burracak,
Priste dokra e kopalla,
Hiqej trim ky frikacak,
I njoftun si REXHEP-PALLA!

Ky një tjetër tiran ish,
S' i gëlltitte dot Korçarët,
Por si âl' në sý i kish,
Ndiqte tepër atdhetarët,
Dhe tue qënë sarahosh,
Nat' e ditë në mejhânë,
E kish shok atë bukrosh,
Policjotin Rustemânë!
E e shtynte në tradhtí,
Si spiûn e si hafije
Dhe Rustemi ish gati
Për ç' do farë therorije!
Kryeplaku u rrejt pas tij,
Djelmt e rí për me shpëtuem
Shkoj t' i merrte me shpejtí,
Që t' i kish të siguruem,
Do t' i sillte në Pojan,
Ku njeri nuk do t' i dinte,
Ose në çiflik Orman,
E kështu mëndjen t' a flinte.



Ku t' a dinte ky i ziu,
Ç' farë gjâm' atjë i priste,
Ku i futi, ku i shtiu,
Që me dor' të vet i vriste!

Dy-tri orë pa u gdhirë,
Mû në fshat harrin ky mik,
Një lanternë ndes n' ersirë,
Trish e ndes e trish e fik.
Këjo shënj' ishte parolla,
Dijeni kishte çdo trim,
Ku do t' ishin karakolla
Do përgjigjshin pa dyshim.

Ças më ças dalloj e pa,
Se një hije ju lëshua,
Përgjigjen me shënj' i dha,
Dhe kalorsit ju afrua.
— Mitkë, ti je? T' u ngjat' jeta,
(Me nga dal Qamili i flet),
— Unë jam, mir se të gjeta,
Kryeplaku ktij ja pret.
Fjalë tjetër nuk këmbyen,
Veç u panë sÿ-ndër sÿ,
Krah për krah u rëmbyen
Dhe u nisnë që të dy.
Zagorishtit ju drejtuen,
Tuke ecun shok me shok,
Në gërmadhat u ndaluen,
Ku të tjerët ishin tok.



Gjithë bashk' u përsëndoshnë,
U sheshuan gur më gur,
Çashtjen gjân' e gjat' e shoshnë,
Gjith' e kishin zembrën zhûr!

Kapitani pik-së-pari
Mitkën drejt në sýt' e sheh,
Dhe fytyrën por si ari
Me një her' atij ja njeh:
— N' a trego, i tha, çka ngjarë,
Psé u ngute kaqe sot,
A i kemi punët mbarrë,
Apo fati po n' a lot?
Ti mezi po merr firomë,
Po të shoh, nuk m' a fsheh dot,
Ç' po n' a tirret shpejt tregomë,
Mos n' a loth kështu më kot.
— Ç' të të them, or kapitan?
Çashtjen nuk e shoh kaq mirë,
Turqit muarr vesh ç' do pllan,
Mua gjaku më ka ngrirë!
Rreth e qark jini bllokuem,
Nuk e nxirni dot me 'ta,
Jan' mizrí' mor i bekuem,
Frikë kam mos ngjas' hatâ!
Miku im, — i qofsha falë —,
Rustemâj më këshilloj,
Që këtej duhet me dalë,
S' ka si bahet tjetër lloj,



Se Vockopi asht i zanë,
Prapa jush tjetër fuqí
Me topa ka për t' ju ranë,
Do bijni në kurth si mî!
Prandaj do vijni me mua,
Unë rrugën mir' e dí,
Nuk lé gjyrm' as lé torrua,
Do t' ju duket si çudí,
Po, t' a dijni se shpëtojmë,
Nuk n' a futin në pusí,
Ngrihi shpejt, pra, të nxitojmë,
Sa të mundni me ngutsí.
— Folë mirë, tha Qamili,
Me këto n' a u prish gjaku,
I zé bes' atij rezili,
Q' e ka vû' Anadollaku?
— E kam mik, bré, kapitan,
Ajy nuk më prek në besë,
Ashtë njeri me *vixhdan*,
Nuku kam as një vesvesë!
I pagova kaq parâ,
Mjaft mexhitka e gjashtarë,
Nuk asht' një *maskarâ*,
Sa më qafë të n' a marrë!
S' e besonj, për atë Zot,
Rustemáj të n' a mashtrojë,
Ky me fatin t' onë s' lot,
As që munt të n' a tradhtojë!



Çohi shpejt edhe me vrap
Sa s' ka dal Hyll' i mëngjezit,
T' a kalojmë këtë trap,
Brengën t' a largojmë mezit.
— Për ku shkojmë? N' a dëfté!
— Do t' i bijem Gjenomadhít,
Tuke shkuem si rrufé,
Do të dalim tej livadhít;
Pastaj bijem në Vinçan,
Marrim pllajën pak përpjetë,
Gjer t' harijmë në Melçan,
Ku babaj del n' a pret vetë.
— Në teqé do të qendrojmë?
— Jo! Aty do rijmë pak,
Pastaj prapë do vashdojmë,
Njeti do zámë jatak.
— Ku? Pa thuaj!

— Në Pojan,

Kemi miq, që po n' a presin,
Mos dysho, or kapitan,
Un' e di se ku do zbresim.
— Mirë fort, po a e peshove
Këjo rrugë ku n' a del?
E mendove? E pleqnove?
A mos fshihet ndo një dhel?
Ç' të të thom, unë s' zé besë,
Kopsës turke s' i besonj,
Do t' n' a qitnjë ngatëresë
Rustemáj, shumë dyshonj!



— Ti dëgjo, jam i sigurtë,
Atjë kujt s' i vjen ndër mënt,
Jé i matun, jé i urtë,
E merr vesh këtë kuvënt!
— Ç' ka, do bajmë si të thuash,
Veç më qafë ti n' a paç,
Se, pastaj, edhe të duash,
Për né s' ka shërëm, ilaç!
Do të lem' atjë lëkurat,
Si kur sqapi në kasap,
Do të tallen me né burrat,
Për né s' ka mëshir' aspak!
— Mos kij frikë, të thom unë,
As një drojë, as dyshim,
M' a lén mua këtë punë,
S' e vendosa pa peshim.
Sa për arm' edhe fyshekë,
Atë barrë un' e kam,
Për në dashçi me binekë,
Ja u sjell në istiqam.
Po, kujtonj se s' ka një frikë,
Atjë s' ju merr vesh njeri,
Atjë nuk shkelin anmikë,
Jini mjaft në siguri.

Kështu mbaroj Mitkë-plaku,
E dëgjoj secili trim,
Ky i nxori nga merakun,
Muarr pak nj' inkurajim.



Dhe filluan të gatiten,
Ulnë kryet, s' folë gjâ
Ndonse që të gjith' habiten,
U nemitn' e s' bânë zâ!

Muarr buk' e muarr mish
Dhe fyshëkë sa kërkuan,
Mitka u ndan ç' pare kish,
Dhe u nisnë edhe shkuan.

Plaku kalit i kërcen,
Tue i hipun për mbi shpinë,
Dhe përpara çetës vjen,
Edhé shokët pas i vijnë.

Moti ishte më të gdhirë,
Çeta tatëpjetën theu,
Rruga ish fort e vështirë,
Por askush siklet nuk ndjeu.

Sokllin vendi nga do shkojnë,
Me opingat fort të lehta,
Nga do bredhin e kalojnë,
Fluturojnë si shigjeta,
Cur mbi cur take thundrue,
Prru' e shpat take drethue,
E me vezmet plot fyshekë,
Hedhin kodra e hendekë,
Herë ecin në për vrî,
Çajnë mërquinja e ferra,
Her' i shkojnë malit brî,
Cok si hije, si sketerra,



Herë djathtas, herë majtas,
Herë pîjtas, herë barkas.
Si një lumë në Pranverë,
Që shbërthen me hov e vrundull,
E ushton si një humnerë
E rëkllehet fort i turbull,
Tue sjell' gur' e sdrall e plisa,
Shelgje, ahe, bungje, lisa,
Tue përmbysë ç' gjen përpara,
Tue përmytë fusha e ara,
Nj' ashtu derdhen ata trima,
Si murlân që shkrep me brîma,
Shkelin muzgje, kopsht' e arë,
Gardhe, sfrate marrin xvarë,
Prishin, shembin, ç' do gjâ shtypin,
Herë hypin, herë sdrypin,
Si tufâni me rëmbim
Që bjen dame e shkatrim!

S' kish ague, s' kishte zbardhë
Kur harinë Gjenomadhë,
Ku dhe ndejtin e u çlodhë
Edhé vehten pak e mblodhë.
Zunë vënt në një limer,
Nën' një shkëmp, si një qemër,
Dhe të nesërmet me natë,
Prapë çohen e vrapojnë,
Goskovës i shkojnë njatë,
Në Melçân vijn' e qendrojnë,



Ku babaj, nje patriot
Del i pret me duart plot!

Dy ditt ndejnë mysafirë,
Me të ngrân' e me të pirë,
E me fjal' e me kuvënt,
Babaj ish njerí me mënt!
Pas dy ditsh ky i përcolli,
Bekim' e urat' u dha,
Afër fushës vet' i solli,
Dy lott derdhi e i la.

Prej andej drejt rrugën zenë,
Çajné grunjat mes për mes,
Në Pojan ja mbajnë penë,
Aty sosin në mëngjes,
Dhe në një shtëpí fisnike
Gjejné strehë e jatak,
Çet' e vogël e kreshnike
Pritet mir' e ban *konak*.
Edhé Mitka i uruem,
Qysh pa gdhirë prap' u nis,
Djelmt' i la të siguruem,
Si në gjî të Perëndis!

Ajy patriot i nxehtë,
Çudí psé kaq shpejt u rrejt,
S' ish, të thuash, enk, i lehtë,
Po këtu e humbi krejt,
Dhe pa dashtun ky i çoj,
Në kanâre të vërtetë,



Ky gabim shum' i kushtoj,
Se i vrau të shkretët vetë!

Mitka vjen në Korçë prapë
Në një zhek e në një vapë,
Dhe me Rustemânë piqet,
Që ky mik me kok' i hiqet.
Ja tregon sër' e më sërë,
Që më pë e më gjylypërë,
Hallet një nga një ja qan,
Nga Polena si u nisë,
Si i çovi në Pojan,
E ku vanë e kondisë.

Rustemâj e dëgjon mirë,
Bahet si kur i vjen keq,
I vjen keq e ndjen mëshirë
Për sa Mitka i shkretë heq;
Dhe pa kthjem krahët miku,
Drodhi shpejt, u ngrit e iku,
Mirallajt vjen e i thotë,
Ç' ka dëgjoj ja sjell të ngrohtë!

Hafûz Pasha me një herë,
Rexhep Pallën dërgon thret,
Rast e kohë pa i bjerrë
I jep urdhën, i gërthet,
Dhe ky niset për Polenë,
I tërbuem e i marrë,
Aty sbuloj xhebhanënë,
Arm' e ç' gjet ja sjell me barrë,



I ban *temenâ, selam,*
— *Teslim,* thotë, ktu t' i kam!

Mirallaj kërcen përjetë,
Rexhep Pallën e shtërngon,
Bakshish i fal lira dhjetë,
Edhé shum' e ngatjeton!
— *Aferim,* bré Rexhep Palla,
Aferim, kolazi im,
Ti n' a zbardhe faqe e balla,
Bravo, bré, se qënke trim!
Léjen ti e ké nga mua,
Si të duash e me pash,
Të çmoj fort dhe fort të dua,
Do t' të baj shpejt një bimbash,
Dhe nishanin Osmanije,
Do t' fal se të ka hije!
Iq tani në këtë vrap,
E m' a bjerr' atë komitin,
Një *gotek,* një *ders* t' i jap,
Në konop t' a shkonj *jezitin!*

Kështu foli mirallaj,
Fërkoj mjekër, fërkoj duer,
Dhe kollazi Rexhepâj,
Therri vrik si një languer,
Edhé Mitkën e gllabron,
Një mëngjes edhe pa gdhirë,
Dhe Pashajt ja dorëzon
Lidhun pisk e me zinxhirë!



Ky stërfloket, egërsohet,
Sÿt' e tij flakrojnë zjar,
E zgjith e e thret t' afrohet
E e kqyr si gjakatar,
Sÿt' e tij si dy thëngjilla,
Po vettijnë si krongjilla,
Me zâ t' ashpër i bërtet
Dhe kështu Mitkës i flet:
— Bré, *hajini i Vatanit,*
Nga e ké këtë kuxim,
T' i shkëlsh besën ti Sulltanit
Me tradhtí e me mashtrim?
Nuk e di se qysh dënohet
Ç' do i marrë kuximtar,
A e di se në plump shkohet,
Ose vjerret në litar?
Folë shpejt ku i ké të tjerët,
Në ç' vënt janë më trego,
Vallahê, për Pejgamberët,
Mos më loth, mos më mundo,
Se, t' a dish, po më mundove,
Do t' të thyenj kosk' e bel,
Shokët ti po s' m' i kallzove,
Vet' i gjallë që ktej s' del!

— Or Pashâ, ty t' u ngjat' jeta,
Dorën ti të gjat' e ké;
Atë që kërkoja e gjeta,
Tjetër frikë nuk më vé!



Nga kjo qafa s'ka mâ hollë,
Baj ç'të duash, frikë s'kam,
Vehtes s'ime s'i ngjit njollë,
Bukën nuk e ha *harram!*

— Si, bré qen, përpara meje
Ti kuxon e flet kështu,
Nga kush morre këtë leje,
S'e di se të shkonj në hû?
— Baj ç'të duash!

— Nuk ké frikë?

— Frikën burri nuk e di,
Nuk më tremp pinjall'e thikë,
Plumb, konop, ose *sungji!*

— *Axhajip!*... Për ca kusarë
Po vé vehtën në rrezik?

Folë shpejt, trego, i marrë,
Mos hash sývet një *kamxhik!*

— Pashâ, mos u ngut, nga dalë,

Ç'thé për shokët s't'a pranonj,

Mos e thuaj mâ at'fjalë,

Se, për Zotin, s'e duronj!

Shoqt'e mij s'duall të vjedhin,

Si hajdutët mû në mal,

Ata sýtë nuku hedhin

As mbi plaçkë, as mbi mall!

Ata një lirí kërkojnë,

Kjo e drejtë s'ka mohim,

Për lirí jetën s'peshojnë,

O Pashâ, mos kij dyshim!



Kështu foli Mitkë plaku,
Mirallaj vranët e sheh,
Ju herr sÿni, ju prish gjaku,
Prej mustaqesh fill e zé,
Dhe me forcë ja përdrodhi,
Sa të ngratit ment ja zhgul,
Nj' a dy, a tri her' e drodhi,
Dhe pas murit vrik e ngul!
Po dhe Mitka nuk durovi,
Një shuplak Pashajt i a dhâ,
Atë çnderim i a shpagovi
Dhe me vrul Pashajt i tha:
— Për mustaqesh s' kapet burri,
O Pashâ *hasretleri*,
Vram' a diqmë me voj-guri,
Po mos baj këtë poshtri!

Po Qyrd-Pasha u harbua,
Qit revolen e qellon,
Mitka randë u shitua
Por se burr' aju qendron!
— Bjerrë, mor gjakpirës, bjerrë,
Se për né sot gjâ nuk mbet,
Sa fyshekë ké m' i shtjerë,
N' thënça «oh»; jam një *lanët*!
Ardhi koha t' i shpërbleni
Sa né vujtmë gjer taní,
Vdekjen këtu do t' a gjeni,
Sot mbaron kjo tiraní!



Kur dëgjuan oficerët,
Që aq tepër e çnderoj,
Turren shpejt, si Jeniçerët,
Por se Mitka s'i peshoj!
Nxuar kordhat, ju vërsulë,
Do t'a grijnin për njëmënt,
Po Pashaj ju preu ç' do vrulë,
Gjith' i ndali, s' u la vënt!
I shkon hallkat në për duar,
E pëlçet në një budrum,
Urdhën dha për t'a munduar,
Ky gjakpirës, ky dudum!
Dhe të nesërmet me natë,
Një trikamshe t' ish gati,
Një litar e dy xhelatë,
Që t'a vjerrte me shpejtë,
E t'a shihte gjith' polemi,
Burra, djelm e pleq e gra,
E t' u çpifеше *vervëmi*,
Të mos shijnin mâ n' at' vrâ!

Ah, moj Zâna ligjërore,
Ku të kam të më ndihmosh,
Dy-tri fjalë ngushëllore
Mitkës n' atë burg t' ja çosh!
N' atë burg atje të rritë,
Mbushun vruk e lagështi,
Ku gjerbon e nuk sheh dritë,
Ku njeriu vdes n' angushti,



Ku e çoj ajy lugati,
Për mundim' e mizori,
Ku s'pret tjetër ky i ngrati,
Përveç vdekjes, mortit t'zî!
Priru pak rrotull Pojanit,
Ata trima m'i lajmo,
Mbroji nga thonjt' e tiranit,
Ç' do të keqe u mërgo!

Ah, të mjerët ku t'a dijnin,
Qysh do kthehej fat'i zî.
Se në grackë do të bijnin,
Por si mini në kuvll!
Mitkën mâ nuk do t'a shifnin,
Ndihmë s'kishin nga gjëkunt,
Eshtnat atjë do t'i lijnin,
Jetës do t'i jepnin funt!

Qani grâ, m'ato sÿ qani,
Që tani trimat vajtoni,
Q'i trathtoj ajy *dushmani*,
Ata djelm mâ s'i shëkoni!
Lé t' i qajë trimërija,
Trupat me lott lé t' i lajë,
Lé t' i qajë Shqipëtarija,
Zi për jetë lé t' i mbajë!





ÇETA E LABËRISË

V.

Rrethimi

Te Mburrimi i Çekanit,
Në një shesh, në një lëndinë,
U çpall urdhni i Sulltanit,
Urdhn'i zî për Shqipërinë!
Hafûz Pasha kalit hipun,
Mveshun në petka zyrtare,
Oficerët kish radhitun,
Për ceremoní fetare.
Myftiu ja fillon *duvasë*,
Më një gjuhë arabike,
Drejt ushtrís e *ulemâsë*,
Kundra çetavet anmike!
I mallkon, i nâm i shkreti,
Si *hajîna* të *Vatanit*,
Të një Padishau, një Mbrëti,
Të *Halifit*, të Sulltanit!
Dhe ushtriya e dëgjovi,
Me respekt e bindje tepër,
Me *selam'* e salutovi,
Si një fort të shëjtë vepër!
Ulemâja, si Shqiptare,
Pikë zâni nuk qiti,



Si Korçare, s' dha vesh fare,
Shtrëngoj dhambët, nuk bërtiti!

Qyrd Pashaj i sheh fort mirë,
Por u mbajt e nuk i shavi,
U heth një sÿ të vështirë,
Dhe prej sheshit i shpërdavi.
M' andej kthehet nga ushtria,
Me një pomb' e *salltanët*,
Dha një shênj' e ra burrija,
Oficerve kshtu u thret:
— N' emën të Atij Sulltanit,
Padishaut e Zotit t' em,
Për nj' at' fushën e mejdanit,
Disa fjalë do t' ju them:
Mbret' i math i Osmanllisë,
Urdhën t' naltë më ka çue,
T' i vé zjarin Shqipërisë,
Kryengritjen me e shue.
Mos kujtoni se po kini
Luftë me disa komita,
Duhet fort mirë t' a dijni
Se Shqiptarët jan' petrita!
Ata sot një grusht po janë,
Por t' a dijni jan' agzoti,
Kurajo të madhe kanë,
Jan' shkëndí e një baroti!
Vaj, medet, po mori flagë,
Osmanllija do të vuajn,



Do n'a çelin shumë plagë,
Do n'a djegin, do n'a shuajn!
Rruhuni, qëlloni mirë,
Pun'e lehtë mos ju duket,
Për né ashtë e vështirë,
Propaganda po mos shduket!
Sot deri mbramë po s'u zunë,
Gjall'a vdek'në dor's'u vunë,
Nesër munt të jetë vonë,
Rasti bjerret për gjithmonë!
Do n'a msynë fshatrat mbarrë,
Do n'a korrin si kallitë,
S'lohet me këta Shqiptarë,
Sado shihni ca komitë!
Ata gjithë jan' betue,
Mbi flamûr e bes' Shqiptari,
Për me dek'o me shpëtue,
Si u a ka lan' i pari!

Faji jyn' ashtë q' i lamë,
Që me koh's'u kujdesuam,
Sot nuk shijnin në' këtë lāmë,
Por ç' të bájme? E pësuam!
Por yryshi duhet prerë,
Duhet prer' edhe shkurtue,
Qysh nga rrâja duhet nxjerë,
Kryengritja duhet shue!
Rrâja pra, e këtij sheri
Ashtë një kjo Korça plakë,



Ktu duhet tregu' *hyneri*,
Ktu duhet dhanë shuplakë!
Duhet të tregohi trima,
Mos kurseni xhebhanetë,
Bini me hov si bumbllima,
Gur mbi gur, nishân mos mbettë!

Kështu foli Qyrd' i zî,
Me një pezm' e një mërzi,
Oficerët jan' përzî,
Kanë ngel' zî e mâ zî,
Kanë ndejt' tue u mendue,
Tue u prek' tue u trishtue,
Si ca shkerbe çartallue,
Kush me folë s' kish kuxue!

Kur i sheh kështu Qyrd Pasha,
M' ato vetullat e trasha,
Fort u pré, u vargëllua,
Fort u nxeh, u zgurdullua,
Dhe s' u mbajt, as ju durua,
Vrik përpjet' me nj' her' u çua:

— Bré, *gotinj*, fillon, me folë,
Që tani e pattë hollë?
Psé përtrypi e po silli,
Psé vërtiti e po mbshtilli?
Një grusht djelm ju kallë tmerrin,
E s' e nxirni në shesh vnerin,
Po qëndroni por si drurë,
Si ca trungje, ca kërcurë,



E po dridhi si esgjiti,
Uh! Jazëk Shteti q'ju rriti!

N'atë heshtje e pushim,
Që nuk pat njeri kuxim,
Mirallajt kundtejt t'i dalë,
E t'i flasë dy-tri fjalë,
Befas çohet kajmekami,
Q'ishte priës i ushtrisë,
Q'i kish dalë gjithkunt nami,
Si fatos i Osmanllisë,
Dhe me gjakn'e tij të ftohtë,
Mirallajt këto i thotë:

— Mos kujto, or t'u ngjat'jeta,
Se peshojmë një grusht veta,
Por i njoh Shqiptarët mirë,
Se me 'ta kam ngran'e pirë,
Kam luftue disa here,
Kam shijue ç' do poterë,
Pra, i di se ç'burra janë,
Që shok tjetër nuku kanë!

Vërtet janë një grusht trima,
Por rrufë e gjilldërma,
Që do shkrepin si humnera,
Si dragonj e si skyftera,
Do kërdisen Turq së vrari,
Mjafton sa të ndizet zjari!
Fshatrat rrotull do t'n'a bijen,
Fyt. për fyt me né do grihen,



Pra, m'a fal, ti Pashaj im,
Se po marr këtë kuxim,
E ju parashtronj dy fjalë,
Për në liksht s'kishte me dalë!
Sa të derdhet gjith'ky gjak,
Sa të lozë drû, dajak,
Mjafton të n' a japin besën,
Që të lir' ata të mbesën,
Prandaj them, mos t' i ngacmojmë,
Mjaft për në t' i çarmatojmë,
Ç' do lëvizje të pushonjë,
Ky gazep lé të mbaronjë!
Ndryshe unë ja kam frikën,
Se kjo punë do malcohet,
Po u vumë në fyt thikën,
Ky millet do të harbohet,
Do të çohen shkëmbënj, gurë,
Baltë, tulla, qeramidhe,
Lufta zgjatet, s' mbaron kurrë,
Litar Vranje, kaçulidhe!

Mirallaj kur e dëgjoj,
Si s' e griu, s' e copëtoj,
Si s' i ra e s' e vrau fare,
M' ato duar gjakatare!
Ju prish çehrja e surati,
Ju prish nuri e fytyra,
Gjithë ândra, që ky pati,
Iu gremis në ca shëmbtyra!



Me inat sheh kajmekamin,
I ndrit^ë dhambët si lugati,
Zembr' e shpirt atë e namin,
Nuk duroj, po i vikati:
— Qysh kuxon, bré *axhami*,
Kshtu të flaç si *çilimi*,
Kshtu më kot edhe pa matun,
Si i çmendun, i shushatun?
Ti, me fjalët që po flet,
Gjithkujt tmerin po ja kllet!
Qysh kto fjalë po të dalin,
Qysh i prish ushtrís moralin?
Qysh è pave kaqe hollë,
Qysh n'a vé leqé e njollë,
A s'e dí, bré, mënt-pisqollë,
Se tash raf tel për Stambollë,
E të shqep nj' ato gradime,
Q' i k'ké marrë me mundime,
Të nxjer jashta ushtërije,
E të çonj ku të ka hije,
Të dënoj me plump që mprapa?
Mbassi të ka zënë vaça?
Del, pra jashtë, ti prej rangu,
Qerr' e thyme, q' ju prish vangu,
Drû i shtrembët, trâ, kërcû,
Piss, allçak, qopek-ogllû!

Kshtu gërthiti Mirallau,
Kajmekamin fort e vrau,



Q' atë çasht e çregjistroj,
Dhe në burgun drejt e çoj,
Dhe komandën nuk vonoj,
Një bimbashi ja ngarkoj!

Kishte gdhî një dit' e Shtunë,
Një dit' zîje, dit mjerimi,
Tré tabor' Orman' ¹⁾ e zunë,
Ishte dhanë shpejt kushtrimi.
Gjithë fshatrat fusharake,
Tjetr' ushtrí i kish qarkue,
Plot ordhí Anadollake,
Kënt e cep kishin bllokue!

Në Sejtâ-Çiflik komitat,
Aty nj' a dy dit mâ parë,
Po qendronin në për pritat,
Fort të lodhun e të vrarë.
Kishin marrë vesh rrezikun,
Që për dit' i kërcënonte,
Kishin par' afër anmikun,
Që mbi' ta ngutsisht marshonte!
Tradhëtin' e kishin ndye,
As një çasht të qetë s' qenë,
Ishin rrejt' ishin gënjye,
Por, mjerisht, s' kishin ku venë!
Gjithë vîset ishin zânë,
S' munt të -loste as një alë,

1) Orman Çifligu



As një rrugë s' kishin lanë,
S' muntte kush q' andej me dalë!
Topat qark ishin stallue,
Mitrалozat përgatitun,
Turqit gati me sulmue,
Urdhnin ishin tuke pritun.

Deh, moj Zânë, pa më thuaj,
Fill' i tyne qysh do vejë,
Më trego, me kta të huaj,
Halli, vallë ç' funt do gjejë?
Gjithë kjo morri ushtriye,
Një grusht trima do luftonjë,
Vallë, a i ka kshtu hije,
Kaqe pisk t' i qarkullonjë?
Psé, kaq randësi u dhanë,
Një tuf trimave lufttarë,
Kaqe frikë prej sijsh kanë?
Kaqe tmerr i paska marrë?

Bellkameni me të tijtë,
Në Dërsnik merr vesht tradhtinë,
Turqit qysh u zunë pritë,
Qysh përsipër po u vijnë!
Paska marrë vesh rrezikun,
Atë gjâm' e atë mnerrë,
Shokët q' ishin krejt të fikun,
Të dëshpruem e të mjerë,
E i ngriu gjaku ndë dejtë,
Lajmi mjaft e piklluvi,



S' merrte vesh qysh ishin rrejtë,
Kjo e keq' e përvëllovi!
Flokët i ngrihen përpjëtë,
U shpërlesh, u kreshperua,
Çohet shpejt me vrul të nxehtë,
Fort u prish, u dëshpërua!
Po i dridhen mish e ashtë,
Po i terren sÿt e tija,
Si kur se kalliu i lashtë
Kur e përsëllon stuhija!
Pikë gjak s' i kishte mbetun,
Duf e afsh' i lëshon goja,
Në fytyrë asht' i zbetun,
Nga marrazi, jo nga droja!

Me një sÿt të turbulluem,
Që flakronte zjar e flagë,
Shokëvet u që drejtuem,
Shpirt' i tij ndjente një plagë!
Gjâ përpara nuk dallonte,
Trimat gjith' më kamb' i ngriti,
Goj' e tij shkumbra lëshonte,
Dhe sa mundi u bërtiti:
— Çohi, djelm e mjaft qendruat,..
Në kto prita, në kto usha,
Ju rrezikun e kuptuat,
Ç' ngjet atjë përtej nga fusha!
Shokët t' onë jan' qarkue,
Janë mbshtjell' e piskëllue,



Turku çoj ushtrí sa mundi,
Shpresë s' kan' as nga gjëkundi!
Né ktu kot po rijm' e presim,
Duhet tok me' ta të vdesim,
As dakikja s' duhet bjerrë,
Për ata trima të mjerë!
Shpejt në ndihmë né t' u vemë,
Kusur për 'ta të mos lemë,
Ngishni shpejt armët e lehta,
Mos n' a dhimbet për' ta jeta,
Turp për né po nuk vrapuam,
Turp për né po s' i shpëtuam!
Duhet tok me' ta të jemi,
Një qellim të gjithë kemi,
Ja me' ta bashkë të vdesim,
Ja se gjallë të mos mbesim!

Ktij ju gjegj kushri-Mihali,
Trim i leht' e një zok mali:
— Pasha fenë e Shqiptarvet,
Pasha hijet e të parvet,
Pasha një kto arm' kreshnike,
Kto breshân' e këto mike,
Nuk e nxinj, jo, fisin t' em,
Sa jam gjall me nder do jem,
Nuk qendronj nënë mynxyrë,
E ndjenj se ç' kam për detyrë,
Jam gati t' u shkonj në ndihmë,
Shokëve s' u ndahem grimë,



Jam gati për ç' do kanë,
Jeta s' më bën as një parë.

Këto tha Mihali, trimi,
Gjith' burrinin' e tij rëfevi,
Zân' i tij si zâ gjëmimi,
Shokët gjith' i mallëngjevi!

Kondillari, që po rinte
Maj' atjë një curri t' thatë,
Armët bukur po i fshinte,
Ishte çue qysh me natë,
E si pa sé koha s' priste,
Para shokve vjen, qendron,
Nj' a dy fjalë shpejt t' u fliste,
Zembr' e tija nuk duron.
Shkrep me nj' herë si duhija,
Zân i tij shunglloj sa mundi,
Gjith' ata djelm si selvija,
I tronditi e i tundi:

— Djelm e dijni për sé duallm,
Për ç' qëllim këtu u suallm,
Për se muarm mal e vrî,
Ç' pret nga né nâna Shqipri!
Besën né të gjith' ja dhamë
Për mbi armët u betuam,
Në kto prita që né ramë,
Mâ fort vdekjen preferuam!
Pra, ja qysh e solli rasti,
Atdheut besën t' ja dëftejmë,



Ardhi koha, ardhi çashti,
Mâ të mirë rast nuk gjejmë,
Burra djelm, pra, për mbi 'ta,
Ky stan këtë bulmet ka!

Edhé Lapi e Tërbaçi,
Që të dy më kamb' u çuan,
Njiten majë një kutllaçi,
Edhé rreth e qark vështruan,
Shtijen syt' e vëshgëllojnë,
Përtej fushës ushtërinë,
Që si bletat po ushtojnë,
Kur nga zgjojt dalin, shëndijnë!
— Shpejt, bërtet ky Nuçi Lapi,
Sa pa mbyllun ajo anë,
Sulemi tej atij rrapi,
Shokëve t' u vemi pranë,
Se q' andej munt t' i afrojmë,
Munt t' u nqasemi, t' harrijmë,
Brî me 'ta né të veprojmë,
Këtu nuk bân mâ të rijmë!

Edhé s' pritnë, u lëshuan,
Anës maleve tue ikë,
Në Pojan për pak afruan,
Pa një trembje, pa një frikë.

Panariti qënka çue,
Midis shokve ka qendrue,
Fort i lodhët, fort i vrarë,
Dy nejt gjum' me sÿ s' ka parë!



Duket tepër i mërzitun,
I menduem, i drobitun,
Gjâ në gojë nuk ka shtî,
Nuk ka etje, as uní,
Ka një ankth që e lëndon,
Shpirt e zembër i ngufon!
• Shef për qark nga një dritare,
Fusha, luadhe e ugare,
Që po nxijnë me ushtarë,
Që kan' zân' hendek' e arë,
Që s' kan' lanë çip e pllambë,
T' armatosun deri në dhambë!
Shokëve, q' i kish për rreth,
Një bisht sÿni po ju heth,
Edhé djersët si i fshîn,
Nxjer një zâ, si një ulrim,
E me zjarm po ju bërtet,
Fjal' e tiji mek, i vret:
— Burra ju, e shihni mirë,
Këtë gjendje të vështirë,
Që ushtrit' n' a kan' rrethue,
An' e kant n' a kan qarkue,
Jemi rrejtun e trathtue,
Jemi tepër keq shtërngue!
M' qaf' n' a pastë tradhëtori,
Që në këtë vënt n' a nxori,
E n' a hoth këtu të zinjte,
Brenda mû në kurth si minjtë!



Nuk n' a mbet, pra, as një shpresë,
Kush ka lindun ktu do vdesë,
Por do vdes' gjithkush si burrë,
Dhe do mos harrohet kurrë!
Gjaku ynë do dëshmojë,
Qysh të gjith' e mbajtëm benë,
Gjaku ynë do tregojë,
Qysh e duam né Atdhenë,
Qysh për 'të në turp nuk mbesim,
Qysh për 'të dijmë të vdesim!
Gajirët, pra, ju, o shokë,
Se dy duar për një kokë
Trimëni do të tregojmë,
Gjoks për gjoks do të luftojmë!
Gjaku ynë do vaditë
Dhen' e shëjt' e Shqipërisë,
Dhe prej nesh, një grusht komitë
Do të çel' Hýll' i Lirisë!
Mos u tremb' aspak rreziku,
Lé t' i bijem ktij anmiku,
Mos u dhimbet, burra, jeta,
Delni zot trojave t' veta!

Kështu foli kapitani,
Shokët në sý e shëkonin,
Dhe me shpirt të një asllani,
Fjalët bukur ja dëgjonin!

Çohet vrik Sabri Dajlani,
Syn' i tij flakron shkëndí,



Si gjëmim i shbërtheu zâni,
Sa shunglloj mal, fush' e vrî!
I kqyr shokët me nj' afsh zjari,
Një bisht sÿni, që gjith vrân,
I tërheq si kehlibari,
I mbërthen, në vënt i mban:
— Hej, o burra, sot asht' dita,
T' u tregojmë një burrní,
Të kujtojn' se kta komita
Dijn' e vdesin për Shqipnî!
Nuk prish punë q' u tradhtuam,
Në një vdekj' e kemi sÿsh,
Po tani që nuk shpëtuam,
Duhet ndamun njana dysh.
Duhet t' i hidhemi si burrat,
Sÿsh për sÿsh ktij Turkushaku,
E t' ja shesim shtrejt lëkurat,
Sa në dëjtë n' a vlon gjaku!
Në me kta s' e nxjerim mb' anë,
Janë si far' e sinapit,
Pra, në këtë kasaphanë,
T' i kushtojmë mjaft kasapit!

Ktij ja priti Pasho Butka,
Me një qeshje, një galldim:
— Edhe mua m' a pret tutka,
Dhe më vjen se s' kam gabim,
Se këtu, ku ngelm' e rasmë,
Çarë tjetër nuk n' a mbet,



Kjo më duket si një dasmë,
Inshallah del për kësmet!
Lé t'a bajmë nj'herë fora,
Të përleshemi me 'ta,
T'u japim disa spalora,
T'u shkaktojmë një hatâ,
Një fyshek kot mos n'a vejë,
Shpatat të ngjinjen në gjak,
Gjâma m'e keqe t'a gjejë
Këtë Turk Anadollak!

Ktij i gjegjet Bajaziti,
Dhe në sÿ e sheh gjithkush,
Qeshi mjaft dhe Panariti,
Kur pa se qëndroj si bush,
Si një lis, që nuku epet,
Si një buall, si një kâ,
Se e din, se, kur i shkrepet,
Ky të fik me ca shakâ:
— Psé s'e merrni pak nga dalë,
Oré çuna, oré shokë,
Psé humbisni kot ca fjalë,
Kaq'ju trembnë kta malokë?
Tash, kur të fillonj'andara,
Do t'i njihni këta burra,
Qysh do t'i vemë përpara
Dhe sa grosh u bân lëkura!
Këta ikin porsi minjtë,
Shoqi-shoqin do të hanë,



Janë ljepura të zinjte,
Do të shihni ç' kambë kanë!
Mjafton t' u heth gunën t' ime
Dhe me nj' herë do përçahen,
Do të ikin me ulrimë,
Do mos dijnë si të mbahen!
Do n' a lodhin krah e dorë,
Nga e zeza, që i pret,
Do n' a vinjë festja torrë,
Gjith kto sorra kush i vret?

Unë them t' ja marrim nj' herë,
Të këndojmë ndo një kangë,
T' a nxjerrim përjashta vnerë,
Me bozुकun dangë-dangë.
Të pëlcas' Halldup' i gjorë,
Tue u shue prej nakari,
Pra, bozुकun merr në dorë,
Ti, oré Musaj nga Psari!

Shokët gjithë fiken gazit,
Këto fjalë kur dëgjojnë,
Dhe freskohen prej marrazit,
E fillojnë të këndojnë.

Kangës ja nis Bajaziti,
E ja pret Kostaq Kosturi,
Musajt një beshllëk i ngjiti,
Dhe në ballë bash ja vuri!
Tingëllon zân' i bozुकut,
E ja marrin bukur. shtruar,
Selenica ¹⁾ i fryn dudukut,
Gjithë duken të gëzuar:

¹⁾ *Tosën Selenica.*



«N' atë Psar të shkretë ca martina ranë,
«Lufton Samarnjoti tok me Myftaranë.
«Ca kishin mavzerka, ca kishin dugranë,
«Lufton Samarnjoti tok me Myftaranë.
«Disa shokë trima në luftë ç'ju vranë,
«Del, o Samarnjot, bré, të shohç Myftaranë.
«Ikni, mor. kusarë, mos gjeni belanë,
«Del, o Samarnjot, del, të njohç Myftaranë.
«Udh' e Monastirit mbushur plot nizamë,
«Ikni, Samarnjotë, ikni se ju ramë.
«Po ky Samarnjoti kryet mban më nj'anë,
«Ik' o Samarnjot, bré, s' e njeh Myftaranë.
«Dy plumba me tela ç' e pritnë në ballë,
«Samarnjot'i shkretë për të qarë hallë.
«Se ç' e qavi nënja bashkë me vëllanë,
«Të muarr më gafë, biri im, të vranë!».

Më të lumt', or zok Rehove,
Ja pret Qamil Panariti,
Besa, fort n' a ngushëlllove,
Kanga jote n' a përsriti;
Po tani, djelm, armët zijni,
Pregatiti që të vdesim,
Por si shqypet ju të bijni,
Se veç vdekjes tjetër s' presim!

Edhe armët gjith' i kapin,
Zene vëndet e qendrojnë,
Shoqi-shoqit besën japin,
Pregatiten të luftojnë.



Shbërtheu zâni, si gjëmimi,
Rrnofsh, o moj Shqipni, bërtasin,
An'e kant u dha kushtrimi,
Brohorisin e gërthasin!

.
.

Zân'i i luftës, i barotit,
Zân'i bijve të Kastriotit,
Zân'i djelme të Shqipnisë
Shkoj te vesh'i Perëndisë!





TJETËR ÇETË ELBASANASE

VI.
Ndashje Gjigandësh

N' atë brek, mbi Shënt-Ellí,
Ishin ngjit' dy Turçellí,
Dy zabita korrozí,
Njani Qyrd, tjetri Llazí,
Hafûz Pasha, komandanti,
Dhe bimbashi adjutanti,
Me nizam' e me zhandarë,
Qyrd' Arabë e Konjarë;
Bisedojnë me zjarmí,
Me një etje, një lakmí,
Rreth e rrotull po shëkojnë,
Përtej fushës vezhgëllojnë.

Hafûz Pasha një lubí,
Shtërngon sýtë mbi dylbí,
Shtërngon sý e shtërngon dhambë
E i merren kry' e kambë,
Fushës një vështrim i heth,
Trupn' e tij një heth' e ngjeth;
Sheh një tym, që del tue endun,
Një lloj mjergulli të dendun,
Një si ré, që shkon me ravë,
Prej Ormanit ¹⁾ në Çëravë,

¹⁾ Orman Çifligu.



Që po çohet majë Qjellit
Dhe mbulon rezet e Djellit,
Edhé shtrihet an' e mb' anë,
Dhe pushton fushën e tanë!
Një e drithme i kap shtatin,
E thret shpejt bimbash-Muratin,
Që e kish si një *javër*,
Për ç' do dhun' e ç' do *hyner*,
I ish çpifun tepër frika,
Si kur do t' i binte pika,
Edhé me dëshprim i flet:
— Bimbash, ç' ashtë kjo që ngjet?
Mos u vrejt gjësendi moti,
A mos vjen humnerë Zoti,
Mos vjen tymi që nga vrâjet,
Gruni bykut që po ndahet,
Q' harmanxhiu me shoqt' e vetë,
Me tërplot' e heth përpjetë?

Dhe bimbashi shtije sÿtë,
Me një tej-kqyrje të dytë,
Një dylbÿ të ré ushtrijet,
Që të ndan qimet e fijet,
Sÿsh i derdhen nj' a dy lotë
Dhe Pashajt kështu i thotë:
— Pashaj im, *hazretleri*,
S' ashtë ré kjo që sjell shÿ,
S' ashtë tym, që vjen nga vrâjet,
S' ashtë mjergull prej ogrâjet,



S' âsht' aspak humnerë Zoti,
Ashtë tym i një baroti!

Qysh pa zbardhun édhe drita,
Me një tmer, Pasha, u ngrita,
Më zgjoj shpejt një bataré,
Që ka dyndun tok' e dhé,
Ka kris' topi me furrí,
Gjëmoj mal e gjëmoj vrí,
Aman, Zot, sa shum' u ndí,
Lufton çeta me ushtrí,
Gjoks për gjoks e ball' për ballë
Si me pushk' edhe me pallë,
Vrengllin kordha, jatagani,
Brihet tigma e luani,
Dridhet toka nënë kambë,
Pash më pash e pllamb' më pllambë,
Se Shqiptari s' lé mejdan,
Kënt e cep me thonj i mban,
Gjaku shkon çurk e rëké,
Por Shqiptari vënt nuk lé!
E prandaj po tutem shumë,
Se mos vejë gjaku lumë,
Mos humbasim djelmtë t' onë,
Shumë frikë kam, për Zonë!
— Ç' flet ashtu, bré, për Allah?
Qënke i marrë, budallá!
Kujton se ca djelm të rí
Do t' a venë me nj' ushtrí,



Që ka arm' e që 'ka topa,
Që të grîn sa të bash 'hopa',
Që të gjuan përsëlargu,
Jo me teke e pushkë çargu?
Uh! Jazëk, s' qënke ushtar,
S' qënke ti burrë lufttar!
— *Af-edërsën*, Pashaj im,
Mos kujto se nuk jam trim,
Kam luftue shum herë,
Kam shijue ç' do poterë,
Por e di se një Shqiptar,
S' është Llaz, ose Konjar,
Luft' atij i vjen për shtat,
Pushkën e ka për zanat,
Pashâ, duket, nuk i njeh,
Prandaj një rrezik nuk vé,
Por se unë i di mirë,
S' kan' as frikë as mëshirë,
Nuku dijnë ç' është tuta,
Bijen verbën por si huta,
Dhe goditin ku harrijnë,
Sjellin dërmën e kërdinë!
Që, pra, psé po trembem sot,
Mos n' a vejë mundi kot,
E mos mbesim në turpnim,
Kshtu po them, or Pashaj im!

Po Qyrd Pashës s' i arth mirë,
Vrazhët bimbashin e pa,



Dhe me gjakn' e tij të ngrirë,
Hipi kalit e e lã,
Dhe merr bregun tatëpjetë,
Në sarajin e tij vjen,
Sillet posht' edhe përpjetë,
Një ngushllim prej kujt s' e gjen!

Aman, Zot, në fushën ç' ngjet,
Kërcet topi, kumbaraja,
Tallaz âsht' apo tërmet,
Që buçasin kodra, pllaja?

Deh, moj Zâna belbërore,
Më trego se ç' ngjet atjë,
Ç' janë gjith kto pushk' mizore,
Ky rrebesh, kjo bataré!
Mos shkëmbënjtë po rëzohen,
Mos malsinat po shkatrohen,
Mos teptisnë gjithë prrënjtë,
Mos vershuan krejt lumënjtë,
Mos fishkllen tufan' i marrë,
Mos përmbysset Bota mbarë,
A mos u lëshuan retë,
Mos shbërthyen gjith' rrufetë?

U ndes Qjelli, u bâ flagë,
Bimës, barit s' i mbet vlagë,
Gjâm' e madhe gjithkund ndihet,
Gjâ nuk shifet gjâ nuk njihet,
Një ulrim gjithkah mbretron,
Thua jeta po mbarron!



Një grusht trima si skyfterë,
Kanë zënë meterizet,
E përhapin vdekjen, tmerë,
Lufta sa vjen e po ndizet!
Një ushtriye mijra vetash,
Po i mbajnë krahënorë,
Një ushtriye, sogje bletash,
Plot ordhí e plot taborë!

Qysh pa gdhirë filloj zjari,
Flag'u ndes Sejtá-Çifligu,
Si luan lufton Shqiptari,
Kundra një anmiku, shtrigu!
Ashtë zënë ç' do frangjí,
Ç' do luftar ka zjarm në gjí,
Dhe po shtijen si ca trima
An'e kant jehon ushtimá,
Plumbat si breshën po shkojnë,
Trupa një më një po çpojnë,
Topat zjejnë si vullkani
Si sketerra si zëndani,
Mitrалozat po pëlccasin,
Fusha, kodra po buçasin,
Kullon djers' e flak' mavzeri,
Tue flakrú' zjarm si krateri,
Kullon gjak krahu e dora,
Afsh' e duh zembrat e gjora,
E po shkon gjaku rëké,
Qindra Turqsh kafshojnë dhé,



Mbeten në zî grat' të vehja,
Mëma, motra, vajza t'reja!

Deh moj Zânë t'qofsha falë
Kush lufton me kaqe valë
Ç'jan'ata burra Shqiptarë,
Që po shtijen si të marrë,
Ç'jan'ata sokola vallë
Që s'po lenë Turk të gjallë?

U nxî ajri, u vrân Qjelli,
U mbulua me ré Djelli,
Gur e dhé, bar e lëmpjetë
Si sifûn çohen përperjetë,
Zjari korr edhe nuk lot,
Zot ç'gazep âshtë ky sot!

Mbi një kullë, si kalâ,
Qendron Qamil Panariti,
Shokët gjithë pas i ka,
Por mungon veç Bajaziti!
Ku të jetë ky fatos,
Që nga shokët qënka ndarë,
Mos i ngrati u plagos,
Mos gjëkundi mbet i vrarë?
Nuk e pa sot as njeri,
As një gjyrmë nuk ka lënë,
As polak, as një barí,
S'tha për 'të se ku ka qënë!

Mos e dî, moj Zânë ti,
Ku u fsheh ky ujk i vjetër,



Mos u zhduk në arratí,
A i ngjet ndo një gjâ tjetër?
Psé, në çashtin mâ kritik,
Ky detyrës i mungojti,
Mos i shkrepni një rrezik,
Mos ndo një nizam e gjojti?
Ndryshe ky do t'ishte tok,
Se nga shokët nuk shpërndahej,
Vrî më vrî e plok më plok,
Bajaziti sijsh nuk ndahej;
Por, ah, frikë për 'të kam,
Mos e gjeti sot *exheli*,
Mos u vrâ në istiqâm,
Mos u korr si kokër meli!

Jo, mor zot, ky âshtë gjall,
Ky sokol e sý-shkëndija,
A j ka një tjetër hall,
Që s'ja din as Perëndija.
Ashtë fshehun e s'pëzan,
Se pret kohën e volitshme,
Kush di kë ka në nishân,
Ka zakone të çuditshme!
Plumbi atij s' i shkon kot,
Di ku heth e di ku shtije,
Bajaziti nuku lot,
Kur vjen rasti di ku bije.
A j gjuan si langor,
Për me zânë vënt mâ t'mirë,



Ka tri zembra në krahnor,
Ashtë tigër, egërsirë!

Pushka po vazhdon pa prerë,
Njeri s' munt kryet me nxjerë,
Se e korr shpejt plumb'i shkretë,
Që vjen si rrujë nga retë!

Shemben murret e çatitë,
E pullazet e avllitë,
Topi po gremis ç' do shëjë,
Mitralozi korr ç' të gjejë,
Zjari po djek e shkatron,
Ç' gjen përpara e farron,
Aman si zhurrit pa prerë
Mos u hap ndo një Sketerrë?

Panariti po bërtet;
— Shokë, bëni ju gajirët!
Mos ju trembin pushka e topa,
Lé t' n' a grijnë copa-copa
S' jemi berra, bagtí, lopa
Lé t' a marrë vesh Europa,
Lé t' a marrë vesh gjith' bota,
Se sa kthehet rrotull rrota,
Atdheu ka shpresa të plotta,
Dhe kto brihje s' jan' të kotta,
Do luftojmë gjer më një,
Jetën s' e kemi për gjë!
Bini ujkut e çakallit,
Bini në lulen e ballit,



As një plumb kot mos ju vejë,
Zotsí gjithkush të dëftejë!

N'ato fjalë të Qamilit,
Prej ushtrís një rêm' shkëputet,
E tue bredh' njatë trifilit,
Në për misërishtat futet,
Por at' çast një bataré,
Kërcet befas si rrufé,
Tymin gjer në Qjêj e ngréh,
Një nizam më kambë s'lé!
Për mbi tok' â tue i shtruem,
Do të vram' e do t' varruem!
Një qint shpirt, sikundër qenë,
Ranë flî edhe kurbânë,
Tue ulrit' kafshuan dhenë,
Tmerin me sý vet' e panë!

Tjetër ordhí u lëshua,
Me një hov, e me një zhurmë,
Dy qint çape u afrua,
Ajo grigje, ajo turmë!
Një yzbash përpara prín,
Tuke shar' ata komita,
Por, i ngrati nuk harrin
T' u afrohet në për prita,
Se një plumb në ball' e gjen
Râ galamsh yzbash-Hamiti,
Plumbi posht' e rëkëllen,
E kish vrâ trim Bajaziti!



— *Aferim*, bré Bajazit,
I bërtiti Panariti,
Më të lumtë, mor petrit,
Ajo dorë q' e goditi!

Pushka vazhdon me rrebesh,
Plumbat si breshën po bijen
U ndez zjari n' atë shesh,
Të dy palët dendun shtijen.

Po Petraq Krastafilaku,
Djal' i aft' e tepër trim,
Del nga prita - ju nxeh gjaku -
Qellon Turqit me kuxim;
Dhe si vravi disa veta,
Si shtriu një dyzin' përdhé,
Te e mbramj' e gjen shigjeta,
Dhe të vdekun posht' e lé!
Shokët shtinë sýt' e panë,
U ka ardhun shumë keq,
Kondillar' i hqaset pranë,
Dhe të vramin e tërheq.
Nj' a dy lott derth Panariti,
U pikllua e ngufoj,
Dhe me sýt' e një astriti,
Një zabit të rí qëlloj,
E e shtriu mbi dhé të vvarë,
Një pellk gjaku e mbuloj,
Gjakn' e shokut e kish marrë,
Dhe kjo pak e ngushëlloj!



Po një gjyle ra pa pritun,
Një cep murri e rëzon,
Gur e dhé përpjet' tue ngritun,
Shokët gati i verbon,
Dhe plagosen nj' a dy veta,
Odhyseja me Kosturin,
Plagët ishin fort të lehta,
Këta prap' e zunë murrin,
E qëllojnë Turq sa mundin,
Me sa fuqi kan' u bijen,
Fort moralin u lëkundin,
Njani për mbi tjetrin shtrihen!
Stiva-stiva po storasen,
Plot të vram' e të plagosun,
Rukullisen e përplasen,
Edhé s' kan' aspak të sosun!

Një tabor nga vëndi shtanget,
Dhe fillon me t' shpejt' ritrata,
Çavurrí shkrep në për ranget,
Turqit i ka zânë data!
Por ahëre thret bimbashi,
Një çerqez i Kaukasisë,
Q' e kish emnin Karabashi,
Q' ishte prijës i ushtrisë:
— Kthehi prapë, bré hajinë,
Se ju vuna mitralozin,
Vallahi e për Perndinë,
Kush prej vëndi të mos lozin!



Se për ndryshe ju krastita,
Si nizamë, si zabita,
Njollë nuk i lamë Mbretit,
Besën s' ja çartim Dovletit,
Do të bijem deri m' një,
Marsh, mos e përsritni më!

Kështu foli Karabashi,
Dhe sado qështërngoj vapa,
Mjaftoj urdhn' i një bimbashi,
Ushtërija kthevi prapa,
Dhe fillon me hov betëja,
Plumbat korrin e s' pushojnë,
Gjëmon topi, batarëja,
Thua se titan' luftojnë!
S' ashtë luft' ashtë kanëre
Luftë trimash, homerike,
Ku mavzerkat Shqipëtare,
Çfaqin pamjen mâ tragjike!

Një kollas dolli prej rendi,
Mjaft i shtatshëm e dají,
Që kur fliste dridhej vendi,
Ishte trim e *fedají*,
Ky thret Qamil kapitanë,
Me një buj' e një furrí,
E kndjell, i tregon mejdanë,
Dhe i flet me pezm' e mri;
— Del, bré ti, që trim më hiqesh,
Q' e rrit vedin si fatos,



Del me mua të përpiqesh,
Del me mua u fjalos.
Del të matemi si trima,
Në t' a mban e në jé burrë,
E mos fshihu në për vrima,
Nër mazgâj e nëpër gurë!
Në jé ti një zok Shqiptari,
Dua bojin të t' a shoh,
Të shoh sa të ngreh kandari,
Trimërinë të t' a njoh!
Po më duket se ké frikë,
E po fshihesh si një grua,
Ti përsipër s' ké gjak pikë,
S' barasohesh dot me mua!
Jam i zot' i jataganit,
Në jé burrë del te fusha,
Të njohsh trimat e Sulltanit,
Që të ndajn' kryet nga gusha!

Panariti e dëgjoj,
Vrik përjashta pritës dolli,
Me sý t' egër e vështroj,
Dhe kollazit kshtu i foli:
— Mâ nga-dal, zogu i Çagatës,
Bir i Ferrit, bir i Natës,
More shumë të përpjeta,
Duket se t'u rëndka jeta!
Ti s' ké parë zok Shqiptari,
Klysh dragoj e bir lúfttari,



Nuk ké njoft' teh kordhëtari,
Që të krastit por si bari,
Por tani prit se do shohsh,
Shpatën t' ime do t' a njohsh,
Bâne që taní *duvânë*,
Pa t' a hequn jataganë,
Se pastaj nuk do t' harrish,
Edhé tash....kordhën e çvish,

Pallat çvishen me një herë,
Si dy shproha në shkëterrë,
Njani tjetrin e avitin,
Ngulin' sýt' e mâ s' i shqitin,
Që të dy msyjn' e lëshohen,
Jataganat kryqëzohen,
Shkrepin n' erë e vrençllijnë,
Shndritin, llampsin e vettijnë,
Shkëndí, iskra po flakrojnë,
Zjar e flagë po lëshojnë!

Si dy ré që po përpiqen,
Njani-tjetrit nuk i hiqen,
Tue bërtit' e tuke sharë,
Kryet tjetrit kush t' ja marrë!
Herë vëndet po i ndrojnë,
Flag' e gjak shpatat kullojnë,
Fort përpiqen fort mundohen,
Ndeshen, brihen e akrohen,
Marrin frym' e prapë derdhen,
Herë zbehen, herë mverdhen,



Si dy ré me hov kur hasen,
Kur sulmojn' e kur përplasen,
Njana-tjetrën si t' a msyjë,
Reja-rënë si t' a shtyjë,
Edhé nxjerin zjarm shkëndija,
Tue flakrû' rrufé, stuhija,
Shëndrit Qjelli, shkrep gjëmimi,
Ushton era, ruzullimi,
Nj' ashtu dhe këta dy trima,
Ndeshen si t' çelikta lima,
Nxjerin flag' e shkumb' nga goja,
Si dy llamje, dy zhgaboja,
Që me sqepet shpesh goditen,
E përgjaken e sfiliten,
Njani-tjetrit vënt s' cedojnë,
Sa të shuhen, të mbarojnë!

Më së fundi Panariti
Mblodhi vehten e e priti,
Vrink shunglloj një zâ në erë,
E shkurtoj me një të prerë,
Edhé kryet e kollazit
Rrukulliset përtej jazit,
Përtej vinit ra e shkreta,
Kshtu i mbaroj të ngratit jeta!

Brohoritin shokët mbarë,
Këtë gjâmë tuke parë,
Mbetnë drû Turqit e ngratë,
Panë ç' do me thanë shpatë,



Ç' do me thanë shpat' Shqiptari,
Shpat' çeliku, shpatë zjari!

Zot, nj' at' çast se ç' paska ngjarë,
Ç' farë tmer e ç' far' tromarë,
Ushtërija zû me u tutë,
Nuku di se ku me u futë!
Disa thrasin e bërtasin,
Disa armët i përplasin,
Disa çohen edhe shkojnë,
Disa duan të qendrojnë,
Një ngatrim shmbërthen si reja,
Si tallazi, si rrufeja,
Kërcet prapa mitralozi,
E ndjeu Zvezda e Gramozi,
Kërcet prapa revolveri,
Gjith' i kapi frika, tmeri,
Zjejnë grindjet e vigamet,
Lanë topat, istiqâmet,
Dhe komitat rastin gjejnë,
Qindra Turqsh poshtë rrëkllejnë!
M'anën tjetër oficerët,
Shtijen mbi asqer' e shkretë,
Stiv' e turr' i shtrojn' të mjerët,
Aty vlon *Xhehnêmi* vetë!

O, moj Zâna e Shqipnisë,
Zoti ç' do lumni t'a pruftë,
Jepi llas ti djelmënisë,
T'a fitonjë këtë luftë,



Faqe-bardhë ata të dalin,
Dhe qellimin t'a mbarojnë,
Ata Zotin e ty falin,
Ata ju u adhurojnë!

Zot' i math, ç' âsht' ajo ré,
Që po vjen nga Shën-Mërija,
Ato grigje e kopé,
Që po sulen si mizrija?
Ç' janë gjith' ata taborë,
Ato sogje, por si grera,
Si oqiçat me këmborë,
Si bagtí, si dhí, si berra?
Oh, sa trembem e sa dridhem,
Për ata trimat e mjerë,
Më vjen, ah, për sýsh t' u hidhem,
T' u pres hovin me një herë!

Asht' asqeri, që Qyrd-Pasha,
Si *imdat* i çon ushtrisë,
Ah, gjaksorin n' hû e pasha,
Që s' i ndahet ksaj djalrisë!

Marrin rrugën tatëpjetë,
Lenë prapa Burgalecin,
Ecin me një gjak të nxehtë,
Zenë Rovin e Rëmbecin,
Edhe bijen nga Pojani,
Ku një tjetër pushkë ndihet,
Ku, në Qjejtë shkon *dumani*,
Ku, prej tymit gjâ nuk shihet!



Atje lufton Bellkameni,
Kërcet pushka, dridhet toka,
Një yzbash që nga Jemeni,
Si i çmendun po luftoka,
E po shtije si i marrë,
Mbi komitat që sulmojnë,
Rrâj' e degë s' lé pa sharë,
Fusha, male po ushtojnë!

Orë plot vazhdon luftimi,
Turqit sulen të harbuem,
Fort i math qenka zembrimî,
Lufta nuk ka të pushuem.
Në yryshet ranë shumë,
Si të vram' e të plagosun,
Rrodhi gjaku si një lumë
Turqit janë mjaft brengosun!

Bellkameni m'ata trima,
Ushtërin' e copëtuan,
Zoq të lehtë, si shkrepitima,
I dhjetuan, i farruan,
Edhe udhën shpejt e hapin,
Ndihm' i vijnë çetës tjetër,
Pran' Ormanit mbajnë vrapin,
Si ca luftëtar' të vjetër!

Tjetër bylyk me rëmbim,
Msyn me hov e me kërcnim,
Vjen përçark me i rrethue,
Çetën pisk me e shtërngue,



Çashti ishte mjaft kritik,
Burrat ishin në rrezik!
Por, pa prit' e pa kujtue,
Një spalorë ka gjëmue,
Ka gjemu' e u trand dheu,
Dhe bylykun krejt e theu!
Një ulrim, një vaj zhurmiti,
Panaritin e habiti,
Vé dylbin' e sheh së largu,
Sheh se ishte thyem vargu,
Ajq varg që i sulmonte,
Tani klithte' e vajtonte,
Një pas një bijnin të vrarë,
Si ca lisa, si ca trarë!

Ishte Spiroja me shokë,
Që bylykn' e bânë trokë,
Një të mirë msim i dhanë,
Gjall më kambë njeri s' lanë!
Do të tjerë që shpëtuan,
Në një pus' tjetër ranë,
Nuk u mbajtnë, nuk qendruan,
Gjer më një të gjith' u vranë!
Kishin ndesh' mbi Panaritin¹⁾
Mbi Sabrinë që përgjonte
Ky vrau ç' mbet, vrau dhe zabitin,
Kreu një ânder që dëshronte!
U rrit gazit kapetani²⁾
Gjithë shokët u freskuan,

¹⁾ Sabri Panariti. ²⁾ Qamil Panariti.



Bellkameni dhe Dajlani
Trimat mjaft i ngushëlluan!

Por, Zot!.. Ç' u bâ Nuçi Lapi,
Që s' po duket n' as një rrjeshtë,
Mos shkoj si sqap te kasapi,
Mos shkoj si qeni në vneshtë?
Folm' o Zâna bukuroshe,
Ç' u bâ ky fatos i vyer,
Mos e pé më ndonjë qoshe,
Mos gjëkundi ka kërcyer?

Nuçi Lapi n' atë valë,
Në një vrâ na paske dalë,
N' a ish veshun harmanxhi,
Si í huaj *jabanxhi*,
Kishte fshehun nër ca duaj,
— Ku po shijnin disa kuaj —
Manliher' edhe fyshekë,
Gunë, xhamadân, jelekë,
U përzjë me ca argatë,
Q' hithnin grunin me lopatë!

Një ordhí aty kalovi,
Nuçi-Lapin e takovi,
Pyesin në ka komita,
Aty rrotull në ka prita,
Edhe Nuçi i drejtovi,
Poshtë një përroj i çovi.
Dhe si ranë në përrua,
Nuçi shpejt një vënt e zuni,



Pak asqerit ju afrua
Dhe nga shpina pushk' i vuni,
Një nga një për dhé i shtronte,
Një plumb kot atij s' i shkonte,
Vrau e vrau, bani kërدينë,
Për mbi një zet vet' u shtrinë!
Por të tjerët vëndet zunë,
Lapit pushkën drejt ja vunë,
Dy-tri bataré i ranë,
Por s' e preknë, as e vranë,
Harmaxhijt' ikn' e e lanë,
As një ndihmë nuk i dhanë,
Der' sa mbrin tjetër ordhi,
E msyn prapa me furri,
Midis zjarve dy e venë
Shosh' e bajnë, gjall s' e lenë!

Kshtu mbaroj jet' e ktij trimit,
Që një shok nuk kish të dytë,
Ky, q' ish shëmblla e kuximit,
Ra dëshmor e mbylli sÿtë!

Kristaq' i Furxhiut i pari,
Gjâmën e zez' e dëgjovi,
Sÿt' i mbushen lott së qari,
Rembeu pushkën edhe shkovi,
Dhe mes grunjve tue kalue,
Tue ec' barkas, tue u drue,
Heth hendeq' e disa ara,
Vrasësvet u del përpara.



Fillon pushka, gjaku ndizet,
Dhe nizamët e hutuem,
Zunë ngutthi meterizet,
Ball' për ball' tue e luftuem.
Lufta mbajti n' a dy orë,
Dhe nizamë mjaft u vranë,
Po Kristaq Furxhiu i gjorë
Nuk pat as një ndihmë pranë!
Gjith' fyshekët ju mbaruan,
Tjetër shpresë nuk i mbeti,
Turqit rrotull e qarkuan,
Ç' munt të bante ky i shkreti?
Çvesh ahëre jataganë,
Sulet krejt i dëshpëruem,
Bije si ujku mbi gjâhnë,
Tue i ngrim' e tue i shuem!

Thret e çirret mylazimi,
Asqer, vini shpejt sungjitë,
Bini me vrul këtij trimi,
Bini me turr me gargitë!
Dhe asqeri ju lëshua,
Fort i nxeht' e i etuem,
Por aspak nuk ju afrua
Ktij luani të tërmbuem!
Vrengëllinte shpat' e tija,
Ku do shkrepse vdekjen binte,
Ku do sillej çfaqej zîja,
Turk më kambë nuk po linte!



Te e mbramja ktij fatosi
I arth sosja, i arth fundi,
Mylazimi e plagosi
Dhe herojin e lëkundi!

Ra për dhé rand' i plagosun,
S' kishte ma fuqí të mbrohet,
Ra i mjeri i vnerosun,
Edhé s' mundi mâ të çohet!

Si një ujk që msyn kopenë,
Me një hov e turr si era,
Dhe sa do qënat s' e lenë,
Ky çvat, çquan dhí e berra,
Sado plagët i kullojnë,
Edhé lum' i vete gjaku,
Sado qënat e sulmojnë,
Nuk e tremp plumbi, dajaku,
Dhe galamsh kur poshtë bije,
Barí, qëna e pushtojnë,
Ajy me dyfek i shtije,
Ata me dhamb' e coptojnë,
Ashtu dhe Kristaq' i mjerë
Prej barbarvet u coptua,
Sÿt i panë tmer, poterë,
Me kondakët u dërmua,
Por i mori gjakun Lapit,
Vrau e griu asqer sa mundi,
Msim të mir' i dha kasapit,
Turqit funt e krejt i tundi!




Deh, moj Zâna-Perëndeshë,
A ké pa ksij zok Shqiptari,
Me kaq' ushtëri të ndeshë,
E të çquhet ky mâ i pari,
Një me një qint shpirt të brihet,
E t' u japë dërm' e datë,
Me një kaq' kuxim të grihet,
Kur me pushk' e kur me shpatë?


Ah, dëshmoja ti trimninë,
Kët trimni kaqë kreshnike,
Ah, ligroja ti burrninë,
Edhé armët kaq' fisnike
Ish afrue mez' i ditës,
Djelli diqte, përvëlonte,
U rallua pushk' e pritës,
Dhe ushtria zû pushonte.
Komandanti i ordhive,
Panaritin e lajmovi,
Dhe midis të dy ushtrive,
Pushka prajti e pushovi.

Ishin lodhun të dy palët,
Dojshin pak të marrin rrymë,
I drobitnë tepër valët,
Aju gjak e ajo rymë!





NJË GRUP KOMITASH ELBASANAS



VII.

Betëja në kulmin.

Ish një vapë, ish një zhek,
Që përvlon e që të djek,
Hafûz Pasha i brengosun,
Aparjasun, hallakosun,
Kishte dalë në hajat,
Ishte shtritun për mbi shtrat,
Fort mundohet, s' e merr gjumi,
Djers' e tij kullon si lumi,
Ka në trûtë mij' andralla,
Mënt' i ka te Rexhep Palla,
Q' e ka çue me luftue,
Kryengritjen m' e shkatrue;
Pa një lajmë ka dy orë
Nuk i bân as kamb' as dorë,
Nuku din ç' ka të mendojë,
Kjo betëjë si do shkojë,
Lufta ç' farë funt do marrë,
Me komitat Shqipëtarë!

Si i pîjshëm me një deje,
Jep e merr e nuk gjen prehje,
Çohet shpejt edhe lén shtratin,
Kërkon me shalue atin,



Fushës nj' herë t' i vërsulet,
Shpirt e zembër pak t' i ulet,
Por se prapë ndryshon mëndje,
Fort vështir' e sheh at' gjëndje,
Merr një fron, ulet e rí,
Me këmish' e anterí,
E me flokët e shpërleshun,
E me rallët e shpërveshun,
Ndes të shkretën nargjilé,
Her' e thith e her' e lé,
Në një hall të math ka râ,
Si dikush t' a kishte vrâ!

Cok, ku s' fryn as pik' e erës,
Çilen flégurat e derës,
Hyn me vrap e tue gulçuem,
Një çausht i shpartalluem,
— Fol' i thotë, folë ç' ngjet,
Kush fiton e kush humbet?

Dhe çaushti fort i trembun,
Si i lujtun mëntsh, i çmendun,
E çel gojën, tue u drashtë,
E i dridhen mish e ashtë,
Shumë droje ka të flasë,
Frik' e tij kalon ç' do masë!
Më së fundi fillon flet,
Me një drithme, një siklet:

O Pashâ, ty t' u rrit' jeta,
Hith një sý në kto të fshehta,



Në kët' zarf, që është mbyllë,
Me kto vula, t' kuqen dyllë,
E pastaj urdhnoni ç' duhet,
Se ç'ka ndoll' me gojë s' thuhet!

Zarfin Qyrd-Pashaj e merr,
E e çel me të math tmer,
E kur pa se ç' ka po ngjet,
Fjala mû në fyt i mbet!

Zot, n' at' fushë ç' paska ngjarë,
Sa asqer i është vrarë,
Qënka çue gjithë Fusha,
Por si dhemja, si këpusha,
I kan' râ asqerit t' gjorë,
Fusharak' e malësorë,
U ngrit Rovi e Rëmbeci,
Pëndavini, Malaveci,
Belortaja, Vashtëmija,
Plasa, Kuçi Podgorija,
U ngrit Barçi e Dishnica,
Floqi, Gjançi, Kamenica,
E Dvorani e Pojani,
E Vloçishti e Sovjani,
Ngritnë krye dhe Malsinat,
Gjithë qarqet e rrethinat,
Por u çuan edhe gratë
Me diqela e me spatë,
Me latoshka e me kazma,
Prej Maliqit te Najazma!



U lëshuan edhe qëntë,
Turqit ndiqen por si dhëntë,
Heu, se ç' gjâmë ka shbërthye,
Që nuk sheh as funt, as krye,
S' di asqëri ku të futet,
Oh, sa dridhet e sa tutet,
Mish e lesh janë ngatruë,
Zot i math, ty t' qofsha true!

Pashaj çohet, si i marrë,
Adjutantit e tij thret,
Flet i vrazhët, tuke sharë,
Aju lajmi fort e vret!
Ajo shkres' e lajmëronte,
Se atjë, n' Orman Çiflik,
Ndihm' ushtria i kërkonte,
Ishte tepër në rrezik!
Ças më ças po kortarisej,
Nuku merte dot as frymë,
Funt e krejt po batërdisej,
Fshatrat kishin râ si brymë!

Zânë, më trego me fjalë,
Ç' ishte ky tallas, kjo valë,
Që ka shkrepun si stuhija,
Qysh nga Pirgu e Vashtimja,
Qysh nga Zvezda e Belortâja,
Si koléra, si murtâja?
Aman, Zot, ç' na shohin sÿtë,
Ata s' paskan shok të dytë!



Pashaj thret disa zabitë,
Q'ishin me zembrën e ngritë,
E u sillet, u bërtet,
Sa të zinjve gjak s'u mbet:
— Eni shpejt, ç'ju duhet merni,
Turri, një minut' mos bjerrni,
Shtypni, ah, ata komita,
Ata qëna e jezita,
Një të gjallë të mos lijni,
Gjall' a vdekun të m' i zijni,
Ndryshe një nuk lé më kambë,
Do t'ju zhgul nofuj e dhambë,
Ja se luften t' a fitoni,
Ja se shuhi e mbaroni,
Çaré tjetër nuku kini,
Këtë fort mirë t' a dijni!

Nisen shpejt ata të ngratë,
Të luftojnë dhe me gratë,
M' ato grâ, q' u bânë burra,
Që e murn' asqerin zvura!

Deh, moj Zânë, që pingron,
Mbi mburrim' e mbi çdo kron,
Pa më thuaj ç' gjet n' at' shesh,
Që kurr gjâ nuk merret vesh,
Si luftojn' ata Shqiptarë,
Q' u ka has' gozhda n sharrë,
Si po derdhen për mbi flagë,
Si u marrin Turqvet shpagë,



Si luftojn' e si ju bijen
Si kërleshen e po grihen!

Msyn, si tigër Bajaziti,
Me Tosûn' e Musa-Psarë,
Një bylyk nga vëndi e shqiti,
Kush e din sa mbetnë vrarë!
Që të trë si ujq lëshohen,
Kok-për-kokë ngatërohen,
Mitrалoz një e zaptojnë,
Me fyshek' e ç' tjetër kishte,
Zunë vënt e i qëllojnë,
Thyejn brinja e kërbishte,
Ndizet lufta, si vullkani,
Tymi, flaga shkon përpjetë,
Rahin topat si batani,
S'mbet barishte, as lëmpjetë!

Ata trima, si pantherë,
Po përhapin dërmën, tmerë,
Trulli shtrohet me të vrarë,
Si kjo luftë s' është parë!

Gjëmon fusha, dridhet toka,
Po buçasin kodra e boka,
Aman, Zot, termet po bije,
A Tomori rrufë shtije?
Pshtym' e flag' e shkrumb gjithkunt,
Funt e krejt tokën e shkunt!

Turqit gati ment pëlçasin,
Për nj' at' dhunë që pësuan,



Dhe si sorrat po bërtasin,
Duan shpejt t'umarrin huan,
E shkëputen do shëjtarë
Mbi ata të trë komitë,
I qellojnë si të marrë,
Tue përdorë dhe sungjitë.

Ç'ish ajo luftë kanë,
Luft'e egër, çnjerëzore,
Luft'e ashpërt, gjakatare,
Aq'e tmershme, aq' mizore?

Bajaziti merr do plagë,
Por s'ligshtohet, as që shmanget,
Turret mbi tym e mbi flagë,
Bije si stuhí mbi ranget!

Paska marrë tepër fora,
Shkel e shtyp e ban kërدينë,
Vret e pret sa i ha dora,
Si një shqype, gjeraqinë,
Por, ah, plumb anmik e gjen,
Gjall mbi dhé e rëkëllen!

Shkoj dhe ky luftar i rallë,
Ra theror, si trim me pallë,
Shkoj e nuk do shifet kurrë,
Ky fatos, ky luán, ky burrë!

Rreth herojit Bajazit,
Një betëj' u përsërit,
Turqvet një pengim u qit,
Në gjak lahet ky astrit!



Duan kryet t'i shkurtojnë,
Mirallajt peshqesh t'ja bijen,
Prandaj sulen e vrapojnë,
Dendun mbi komitat shtijen.

U mbush sheshi me të vdekun,
Vershoj gjaku si përrua,
Mjaft asqéri ishte thekun,
Ky dëshmor në gjak u mblua!
Sillet për mbi gjak kufoma,
Si trunk lisi, tue notue,
Ushtëris ju pré firoma,
Për sa ky u kish kushtue!

Bërtet Spiro kapitani,
Gajret, Qamil, gajret,
Bajazitin mos e qani,
Ashtë gjall e po n'a thret,
Po n'a thret t'i marrim gjakun,
T'u a marrim mirë hakkun!

Dhe shungllon një bataré,
Por si një shkatruëse ré,
Fshîn, për lan ç' do që stërdit,
Turqit i korr, i krastit!

Aty rrotull mbi nj' avllí,
Odhyseja me Kosturin,
Kqyrin disa Turçellí,
Që mundohen me ngjit' murrin,
Edhé në nishan i venë,
I qëllojnë një nga një,



Turk të gjallë nuku lenë,
Gjër sa nuk u ndye zê!

Por nga dale dera hapet,
Një zabit po hyn me vrap,
Fyt për fyt me Kottën kapet,
Ish i zî, si një harrap!
Në gushmaq ja nguli dhambët,
Kjo kulçedër e harbuem,
E e mori në për kambët
Ky harrapi i mallkuem!
Por m'at ças e pret Kosturi
Me kondakun majë kokës,
Dhe të vdekun posht' e vuri,
Trut' e tij ju derthë tokës!

Një yrysh bajnë përpara,
Këta trima e fatosa,
Nizamët i marrin xvara,
Si ca pata e ca rosa!
Tuke bredh' e tue kuxue,
Istiqamit jan' largue,
Kapitanët kot u thrasin,
Kot i kndjellin, u bërtasin,
Të dy trimat nuk dëgjojnë,
Brihen, grihen, nuk pushojnë!
Por nj' ushtrí u vjen pa pritun,
Prej një kodre tuke zbritun,
U zën krahët, i qarkon,
Dhe nga shpina i qellon!



Priru pak këtej, moj Zânë,
Më kallzo se ç'ngjet m'at'anë,
Ç'jan'ata drangoj që çqyhen,
Që kërleshën e po shgryhen,
Si me grusht e me pëllambë,
Si me thonj edhe me dhambë,
Si me shkelm'e me shuplakë,
Me sungji e me kondakë?

Paskam marrë shumë pezmë,
Por s'u mbet fyshek në vezmë,
Prandaj paskan xhveshun shpatat,
E po therren me xhelatat,
Presin, vrasin e rëkllejnë,
Qindra Turqsh vdekjen e gjejnë,
Por, ah, ky kuxim i fiku,
I rrethoj të dy anmiku!
Tani s'dijnë nga t'ja mbajnë,
Bukur fort e ndjejnë fajne,
Por kurajon nuk e bjerrin,
Sÿsh për sÿsh, me thonj i çjerrin,
Llamat djers e gjak kullojnë,
Dorzat nxehen e përvlojnë,
Nuku preken as me dorë,
Mjaft e lyen dhen'e gjorë,
Çpuan shumë krahënorë,
Pellgje gjak, mushknë e zorë!

Aman, Zot, këjo betëjë,
Qysh do shkonj'e qysh do vejë,



Tokën me gjak do t' a lajë,
Sa shtëpi në zî do mbajë!

Të plagosun e plot varrë,
Po luftojn' ata Shqiptarë,
Shumë msyn' e shumë nguten,
Po dërmohen, po këputen.
Odhyseut i thyet shpata,
Mbetet me duart e thata,
E aty bije i vrarë,
Në djers' e në gjak i larë!
Ra theror i mjeri djalë,
Shpirt'i tij po shkon përpjetë,
Syt' e tij mbyllen nga dalë,
Vdiq, perdoj fatos' i shkretë!

Si një gonxhe, një burbuqe,
Q' e plakosi tepër vesa,
Si e kandshmja lulukuqe,
Q' u rronit e ju pré shpresa,
Ashtu uli kryet trimi,
Mbylli syt' e fluturovi,
Hov' i tij edhe kuximi
Shumë tepër i kushtovi!

Mbeti fyll Kostaq Kosturi,
Ky djaloshi i pa pjekun,
Me të gjith' ushtrin' e vuri,
Sa dhe vetë râ i vdekun,
Edhë trupin n' atë moshë,
Me suëgj! ja bënë shoshë,



Dhe m' andej i vijnë hakkut
Me fuqinat e kondakut,
Kryet ja dërmuan copë,
Dhe e flakën në një gropë!

Shokët këto kur i panë,
Shum' u prekn' e shum' u vranë,
Që të dy me lot i qanë,
Në dëshprim të thellë ranë!
Një trishtim, një valë zije
Gjithë trimat i përsllon,
Si një nap' e zez' u bije,
S' ka se kush i ngushëllon,
Por se zembra nuk i lâ,
Frym e llas të rí u dhâ,
Ç' do prej sijsh, si një luan,
Armët i shtërngon i mban!

U çudit fort Hafûz Pasha,
Që Shqipnija s' mbet në vasha,
S' mbet në grâ për avlëmënj,
Që lëvrojnë në krëhënj,
Që çepkasin lesh e tjerrin
E me fjalë kohën bjerrin,
Por ka burra e djelm si Zâna,
Që nuk i lint lehtas nana,
Burra që dijnë si vdesin,
Që në turp e dhunë s' mbesin!

Lufta fort e ashpër ndizet,
Shum' asqer fuqin' e shkrin,



Plot ushtri vjen e përmbliidhet,
Hafûz Pasha vet' u prîn!
Ashtë fort i dëshpëruem,
Se ushtria ju dhetua,
Ashtë tepër i trishtuem,
Se qellimi s' ju mbarua,
Edhé djelmt' e shohin pisk,
Nuku dijnë nga të ruhen,
Zân' i Pashës u shkon brisk,
Nga t' ja mbajn' e nga të druhen?

Por në mes t' atij ngatrimi,
Si një krizmë, një tërmet,
E flakrume prej një trimi,
Nj' alamët bombe pëlçet!
Një ulrim, një vaj i dendun,
Po jehon brek e më brek,
Turqit ikin si të çmendun,
S' kanë ku me gjet' një shtek!

Bomba u hoth nga plevica,
Që shytoj asqer' e ngratë,
E flakroj trim-Selenica,
Ja çoi Pashës si dhuratë!

Ishte koha më të ngrysun,
Djelli dal-nga-dal perndonte,
Ushtërija ishte krysun,
Por se luftën e vazhdonte.

Por, Zot ç' pat Sabri Dajlani,
Që kërcëu përposh hendekut?



Mos i befti ktij dushmani,
A s' i bân zjari dyfekut?

Jo, jo, gjâ nuk pat pësue,
Se Sabriut s' i trembet sÿni,
Veç u hoth për me shpëtue,
Sepsé Rexhep Palla e msyni,
Por ky prap' i ka qellue,
Gjer në bres në llom i zhytun,
Pushk' e tij i ka trillue,
Turqit përtej i ka shtytun,
Dhe gjen kohën e merr vrapin,
Tue i râ përmes ushtrisë,
Si një shpesh e kaloj trapin,
Mori anën e Vashtmisë,
Dhe shpëton prej një rreziku,
Edhé kapet në Polenë,
Asqérit prej sÿsh u iku,
S' munt në kurrsesí t' a zenë!

Vendi ADA *) i Sejtâjt,
Shumë shtrejt i râ Pashajt,
Se u derth gjaku përrua,
Sa dhe vetë u tmerua!...

Një kollas, një shishmanllí,
Një zheshkan, një Gjiritllí,
Hafûz Pashën e afron,
Duket lejen i kërkon.

*) Ada ashtë një shesh i vogël trë-çipash j qarkuem me hendeqe të thella të rrafshuem me llome e bataqe, brenda në çiflik të Sejtâ-Panaritit, në fushën e Korçës.



Do të pjekë Bellkamenin,
Që e shef si macja qenin,
Do të matet në mejdan,
Të fitonjë zylm' e shan!
Shum' i ka lakm' e cmirë,
Do t' a shdukë nj' her' e mirë,
Sepsé ky sokol ky burrë,
Dâme shumë u kish prurë,
E kish njoftun tjetër herë,
Kishte pà prej tij, poterë,
Atjë tej, nga Negovani,
Ku, ky Spiro kapitani,
Trim' i rrall' e i padrojtun,
I kish fikun, i kish shojtun!

Lejen ky zabit e merr,
E fillon me vjellë vner,
Fort e tremp, i kërcënohet,
Bellkamenit i afrohet,
Në duello shpejt e thret,
Kordhën xhvesh, aspak s' e pret!

Edhe Spirua kur e sheh,
Fort u nxeh, u kreshperua,
Se kollazin mir' e njeh,
Me atë shpesh u takua.
— T' u ngjat' jeta, Kamber aga,
Po t' a ndjenj dhe nj' herë zânë,
Do t' a hethsh sot ter' a laga,
Malli fort të paska zânë!



Diku n' a përpoqi fati,
Diku n' a gjet taksirati,
Tej, atjë nga Negovani,
Ku ju kishte çu' Sulltani.
Tani arthke të shfrysh prapë,
T' u rrit mëndja se je trim,
Qysh s' përtove në kët vapë,
Të tregosh kaqe kuxim?
Por se ç'ka, or' t' u rritt' jeta,
Mir se m' ardhe e mir se të gjeta,
Duket shpirti t' u mërzit
Jepi funt, pra, bré evgjit!

Kështu foli kapitani,
Jataganin myllit nxjer,
Sÿn i tij, si sÿ luani,
Flakron zjarm, si shk'ndi në terr!

Po Kamberi kur e pà,
Fort u mverth e fort u vrà,
I qé dukun si shakà,
Por u tremp, zembra e lâ!
Vehten shumë ngusht' e sheh,
Në fytyrë fort u zbeh,
Shumë dridhet e ka frikë,
Don të shmanget e të ikë,
I vjen turp s' di nga t'ja mbajë,
Si t'a fsheh e si t'a lajë!

Të dy anët zun' e tallen,
Dridhe, i thonë, Kamber, vallen,



Po Kamberit s' i ban zembra,
Ju drodh trupi der' te thembra,
U çnderua në aq' burra,
Ju dhims jeta e lëkura!

Hafûz Pasha po e kqyr,
Atë loj' atë *qyfyrr*,
Edhé shpejt' atij i sulet,
E kap supash e e shtyn
Burracakun, q' i përulet,
Edhé në surat e pshtyn!
— Këput xverkun, bré *mavije*,
Çporru, qën, lanét, jezit,
Që s' të mbet lezet e shije,
Që po dridhesh si evgjiti!
Kush të tha ty m' u përzî,
Bré allçak, bré faqe-zî?
Kshtu si ty grua mos qoftë,
Uh! Allahu të marroftë!

Dhe i derdhet vrik për sÿsh,
I shqep gradat e ja flak,
Kordhën ja thyen më dysh
Dhe ja heth tej në batak!

Sí u ngrys e perdoj Djelli,
Edhe lufta po rallohej,
Çeta vjen afër një vrelli
E zû lahej e freskohej,
Dhe si pa rrugën e lirë,
Ulen barkazi të gjithë,



Dal-ka-dal' e fort vështirë,
Hyjnë në kallijt me drithë,
Edhé ikin e largohen,
Marrin udhën nga Pojani,
Shumë lodhën e mundohen
Gjer sa sosin te Sovjani.

Shkojnë lehtas e ka-dale,
Sa që ishin, -dhetë vetë-,
Por, ah, zhyten në moçale,
Edhé bijen në kënetë!
Edhé Turqit i nuhatnë,
E në pritat kur s'i panë,
Vrap, me sa fuqi qi patnë,
Sipër trimavet u-ranë.

Folmë ti, o Zân' e malit
Ç'ngjau atjë përtej moçalit,
Si u mbajtn' ata të shkretë,
Zhytun brenda në kënetë,
Si qendruan, si luftuan,
Ata shpesh, ata pullumba,
Si s'u fikn' e si s'u shuan,
Pa fyshekë edhé pa plumba!

Turqit mû në llom sulmojnë,
Edhé tepër i afrojnë,
Duan krejt aty t'i zhytin,
T'i farrosin e t'i mbytin!
Por, ah, ç'ka s' të mson nevoja,
Kur të vjen shpirti ne goja,



Mëndja çelet si një pishë,
Njeriu bâhet si një bishë!
Nj' ashtu dhe ata asllanë,
Me sa hov e fuqi kanë,
Derdhen me grusht' e pëllambë,
Duan t'i çqyejn me dhambë!
Në batak brenda i krydhnin,
I fundosin e i shtrydhnin,
Filluska plot lëshon kënetë,
S'ban një pare bajoneta,
Gryka-grykas po përfyten,
Me duzina Turq po mbyten!

Një onbash kap Dilaverin,
E kërkon me thonj t'xhvatë,
Shumë liksht e zû të mjerin,
S'ka ç'bân Dilaver' i ngratë!

Vrik kërcen Halim Tërbaçi,
Dhe onbashin e përkuli,
Si në një kafshat' kulaçi
Dhambët mù në vesht ja nguli,
Ja coptoj, s'desh t'ja lëshojë,
Ja këputi deri në rajë,
Vesh' i tij i mbet në gojë,
Onbashi fillon të shajë!
Por ahere Panariti,
E përfshin e i zhyt kryet,
Thonjt' e tij në fyt ja ngjiti,
Trup' i tij epet e thyet!



Nuk e panë mâ të ngratin,
Jet' e tij në llom mbaroj,
Se Qamili ja nxiu fatin,
Vaj, i shkret' onbash ç' pësoj!
Bimbli, sa do q' ishte thellë,
U çon peshqesh një sharpnellë,
Shkndit' e saj si hÿj çkëputen,
Turqit s' dijnë ku të futen!

Trimat gjejnë rast e dalin,
Vrapin as një çasht s' e ndalin,
Kapërxejn' atë kënetë,
Me trimni e gjak të nxehtë,
Edhé nga Starova bijen,
Krejt të ndryshmë, sa nuk njihen,
Kështu jetën e shpëtuan,
Shumë vujtn' e u munduan!

Por mjerisht k' ta kapitanë,
Që të dy mâ von u vranë,
Bellkameni ra mâ parë
Si dëshmor nga Negovani,
Dhe Qamili mbet i vranë,
Kot më kot prej një dushmani!
Dhe Themistoklin' e mjerë,
Atë trim me atë vlerë,
Mû në Selenik e vranë,
Tradhësisht Francezt' i ranë!

Nesërmet, kur agoj dita,
U ngarknan më një qerre,
Që të gjasht' ata petrita,
Pa kunora e pa ndere,
Mû në Korçë janë prurë,
Prej asqerit të Dovletit,



Dhe pa kasa, pa qivurë,
N' atë sheshin e hyqmetit,
Gjithë tok u sërënditnë,
U storasnë pa një zhurmë,
Një-pas-tjetrit u radhitnë,
I rrethoj përçark një turmë.

Hafûz Pasha rafi tel,
Te Valiu i Monastirit,
E krekohet si një gjel,
I lavdrohet fort Myshirit!

Fton me vrap prindët e shkretë,
Të dëshmorëve të mjerë,
Që t'i shohin edhe vetë,
T' a ngjerojn' atë poterë!
Desh t' i hithte t' pavarrosun,
Që të xhvatëshin nga qëntë,
Desh t' i shifte të xvarrosun,
Që t' u hyjshin thellë mëntë!
Por u çue pësh qyteti,
Hafûz Pashën protestojnë,
Sa mbrîn urdhën drejt nga Mbreti
Që me ndere t' i varrojnë.

Prindët kur ardh'e i panë,
Përmbys mbi të vramit ranë,
Por një lot prej sÿsh s' lëshuan
As i qan' as i vajtuan!
Se u qanin thellë zembrat
Me mallngjime, me ngashrime,



E u dridhshin deri n' thembrat,
Vner kullonin e pikllime!

Kur mâ von u mblodhë gratë,
Të shpërleshuna, të marra,
Kur i qan' ata të ngratë,
Me gazepe, me llahtara,
Ku, ku, ku, se ç' ngjau s' tregohet,
Ajo gjâmë nuk harrohet,
Lotet, vaji, ulërimi,
Kan' kalu' ç' do mas' tregimi,
Jehoj brîma an' e mb' anë,
Korça, rrethet në zî ranë!

Por dhe Pashës ju droth shtati,
Ju droth shtati atij gjaksori,
Atij ujku e xhelati
Ju thek zembra e krahnori,
Dhe në mes të grave futet,
Tue u dhanë ngushëllime,
Shpirt' i tij sa vjen po zbutet,
— Mjaft, u thotë, kto vajtime!
Këta trima nuk vajtohen,
Po përcillen me këndime,
Veç me kang' ata ngushllohen,
Me gëzime, me kërxime!
Këta te këuaqun ranë,
Se detyrën e mbaruan,
Këta vdekje kurrë s' kanë,
Jan' të gjallë, shentëruan!



Makar' gjith' kështu të vdesim,
S' ka mâ e madhe lumtëri,
Atë dit' edhe né presim,
S' ka mâ t' shëjtë therorí!

Këta djelm né n' a luftuan,
N' a krastitnë kaq' asqerë,
N' a coptuan, n' a shkatruan,
S' ishin burra, po pantherë!
Né anmiq këta i kemi,
Dâme shumë n' a kushtuan,
Po të drejtën lé t' a themi,
Këta vehten e nderuan!
Po nderuan dhe Shqipninë,
Kaqe fort, sa nuk kujtonim,
E treguan mjaft burrninë,
Sa nuk prisnim, as shpresonim!

Therorija s' u mohohet,
Do t' i shkruaj Historija,
Vepr' e tyne nuk harrohet,
Do t' i mbajë mënt Shqipnija!
Si një-një me fè të gjallë,
Gjer në gjû e derdhë gjakun,
Bota si këta sheh rallë,
Nuk ju hamë kurrë hakkun!

Këto foli Qyrd-Pashaj.
Rreth tij u mbloth gjith' asqeri,
Dha një urdhën Mirallaj,
E qendroj në shëjë nderi!



Dhe shbërtheu një bataré,
U tund Korç' e rrethe ç' janë,
Pashaj trimat qet' i lé,
Shmanget asqeri më nj' anë.

Si largohet pak ushtriya,
Që të gjasht' ata i ngrehnë,
Popull plot, si mizërija,
Një nga një në vorr i venë,
Dhe nga dale i lëshojnë,
Në një çurk lottesh i lanë,
Tremben se mos i lëndojnë,
Djelmtë, që dëshmorë ranë!

Kështu funt kjo luftë mori,
Armët t' ona u nderuan,
Kombin faqe-bardh' e nxori,
Ata trima shentëruan!

Kur dëgjoj Sulltan Mehmeti,
At' trimni të patreguem,
Tepër i habitun mbeti,
I përzishm' e i çqetsuem,
Por, s' i râ mohit burrnisë,
Sado që s' u ngushëllua,
Për luânat e Arbnisë
Shpirt' i tij fort u përsllua,
Dhe s' u-mbajt, me zâ bërtiti,
Me një zâ si një llahutë,
Dhe shpeshher' e përsëriti,
Ashkollësûn, bré Arnautë!





Odhisé Kotta



Kostaq Kosturi

VIII.

G j a k m a r r j a

Ç' është' ajy kapodajf,
Si *subâsh*, e si *spahî*,
Kaleshân, mustaqe-dredhun,
Që po vjen tuke përdredhun,
Që po tundet e po shkundet,
Që po ecën e lëkundet,
Q'i lëshojnë vënt kaq veta
E po i bajnë «t'u ngjat' jeta»?
Vehten fort të math e mbajtka,
Një nishân sa mir'i vajtka,
Qënka veshun n' uniformë,
Si aktori në pplatformë,
Paska ngjitun dy shirita,
Dy ardhushka, dy astrita,
Që ban, ç'ban e i verrén,
E gëzohet e dëfrén,
E qesh buza e nuri,
Qysh minutën që i vuri!
Ky nâ qënka Rustemâj,
Q' e kish vegël Mirallaj,
Që me t'holla e me mitë,
Ja shpërblente tradhëtitë!



E gradoj si komisër,
Se i bâni shumë nder,
Pra, i fali dhe nishân,
Që në krahënor e mban!

Sa i lumtun që po duket,
Herë qesh e herë nkuqet,
Si kur fitoj një *kalâ*,
Psé u hoqi një *belâ*,
Psé i hoq një breng Dovletit,
I shërbeu si besnik Mbretit,
Sado q'ishte një Shqiptar,
Ky trathtor, *katil*, kusar!

Gjith' e presin, e ndrojnë,
Me gëzim' e përhirojnë,
Shesh i duket e lëndinë,
Thua se zû Perëndinë!
Ashtë tepër i qetsuem,
Çetat tuke i shkatruem,
Festen për mbi sÿ e mban,
Ky dangall, ky shakllabân,
Sepsé Mitka ish burgosun,
Jet' e tij ish më të sosun,
Pret t' a shohë kur t' a marrin,
Mbi trekambëshen t' a mvarrin,
Pengim tjetër nuku ka,
Ç' do që ngjau ju duk *shakâ*!

Gjith' ajy gjak që u derth,
As e kuq e as e mverth



Gjaku që u derth si krua,
Që shkoj rëké e përrua,
Që vaditi tok' e dhé,
Për lirí e për Atdhé!

Si kur shkerba, ose bisha,
Që s'lé vazhd' e monopat,
Që hyn shkarthi në për pisha,
Edhé gjahun e nuhat,
E mbassi në gjyrm'i vihet
As minutën s' e lëshon,
Përçan ferra, dushnja, shkrihet
Gjer sa gjahun e vezhgllon,
Edh' ahëre vrik i sulet,
E përfshin e posht' e vé,
E me etje gjaut i vrulet,
E me thonj në gryk' e zé,
E i çel të madhe varrë,
Fut turrinjt' e kokën s' ngreh,
Gjer sa i thith gjakun mbarë,
E pik vlagu nuk i lé,
Nj' ashtu dhe këtë gjakpirës,
Nuk e ngjinji ajy gjak,
Dhe si një çanak-lëpirës,
As *ryshfet*, as gjâ s' e mjak,
Po dhe n' ândër rí mendohet,
A ka ndo një poshtërsí,
Që mjafton sa t' i kujtohet
E t' a bâjë ky fat-zî!



Si u ngrys, ja shtron me nj' herë
Me rakí, pastaj me verë,
Bahet thump e kokën-drasë,
S'ka njeri kush t'a përkasë,
Edhé dehet, bahet but,
Shpirt-lugati, ky harbut,
Dhe nga mez' i natës çohet,
Nga shtëpíj' e tij drejtohet,
Fort i skuqun, fort i nxehun,
Sillet rrugës mjaft i dehun,
Dikur shkon e has më mûr,
Dikur shkrep mbë ndo një gur,
Dikur bije e rëzohet,
Dikur plaset e varrohet,
Dikur pingulthi më bark,
Se shtëpit' i vijnë qark!
Dal-nga dale tue u hequn,
Derën gati e ka gjetun,
Edhé çelsin xhepit nxjer,
Brenda hyn, gjumi e merr.

Kthehet rrotull e vërtitet,
Çfryn, rënkon, gulçon, përpíqet,
Rakí, ven' i ndizen flagë,
Zgrofin s'ka me se t'a lagë,
Në për ândër flet preçart,
Gjoksi i çohet posht' e lart,
Kush di ç'ândër sheh lugati,
Ky shpirt-kazmë, shpirt xhelati!



N'ato ândra e kllapí,
Dikush hyn n'atë shtëpí,
Tue u hedh'prej një avllíje
Si një *xhínd*, a si një hije;
Çilet vrik e dhomës dera,
Dhe hyn hija si Sketerra,
Edhé vjen afër një shtrati,
Ku ish shtritun arrakati.

Mû në terret tuke ecun,
Hija 'di ç'ka po kërkon,
Herë ndalet tuke ngecun,
Mbi karig' a mbi një fron,
Herë zé e hiqet xvarë,
Edhé do di ç'ka të marrë,
Herë muret prek me dorë,
I pa-qet' e i pakorrë,
Deri sa has në një kamë,
Që ka një të ndritshme llamë,
Dy gjarprushka për mbi myll,
Me një hânëz' e një hýll,
Has dhe një *alltipatllake*,
Një revole karadake,
Që të dyja shpejt i rrok,
Njanën mik' e tjetrën shok,
Dhe katilit i afrohet,
E shkunt supash që të zgjohet,
Se në gjumë s'do t'a vrasë,
Dy-tri fjalë do t'ja flasë,



Shkakun do që t'i tregojë,
Arësyen t'i kërkojë,
Ç'pat me shokët q'i tradhtovi,
Psé kaq poshtër i mashtrovi,
Psé u hangri kaqe pare
E i fiku, i vrau fare!

Ashtë Mitka ky i shkreti,
Që nga burgu kishte dalë,
Si e qysh i gjallë mbeti
Nuk përshkruhet dot me fjalë!

Atë natë të tmeruem,
Që në burgun, si sketerrë,
Të plagosun, të dëshpruem
E përcuall me poterë,
Atë natë, që s'harrohet,
Natë tmeri, natë zîje,
Që nuk ka si krahësohet
Me vampire, xhinde, hije,
Si e muar, e xvarosnë,
Bot me shkelm'e me dajakë,
Si e çuan e burgosnë,
E e ngopnë me kondakë,
Në një qoshe e përplasnë,
Dhe më terrët fill e lanë,
Brenda një birruc'e rasnë,
Buk'e ujë nuk i dhanë!
Se s'e panë me nevojë,
Të kujdesen aqe tepër,



Ç'ka, se urët do kalojë,
Ky litar do, jo gjâ tjetër!
Se të nesërmen pa gdhirë,
Mbi trikamshen do t'a vijnin,
Për atë nuk kish mëshirë,
Mitkën varrun do t'a shihnin!

Mez'i natës kish kalue
Mitka kur ka ardh'ndër mënt,
Dhe një pik'e kish pikue,
Kur pa vehten n'atë vënt!
Por harron plagët që mori,
Harron shkelmë e dajak,
Një pshertim nga zembra s'nxori,
Vehten s'e sajoj aspak!
Dhe atjë ku po mendohet,
Ku nuk shift' as një shpëtim,
Prapë ky nuk dëshpërohet,
S'e lé zembra, áshtë trim!
Kqyr atjë nga fund'i burgut,
Një dritor të vogël sheh,
Ju kthjell mëndja këtij murgut,
Zembra fillon e i rreh!

Ish një *baxh'* e rrrumbullaktë,
Drita brenda mezi q'hyn,
Një shkëndí i shkoj e flaktë,
Sulet dhe baxhoren msyn,
E me një të vogël sharrë
Hekurat e saj sharroj,



Kërcen gazit si i marrë,
Kur qëllimin e mbaroj!
Del me nj' herë e jashtë gjindet,
Vuni ré që s' kish njeri,
Edhé më së fundi bindet,
Që s' që ândër, as kllapi,
Psé e pa vehten të lirë,
Pa zinxhira, pa vargoj,
Fati i tregoj mëshirë,
Që prej burgut gjall shpëtoj!

Ulet barkas tue përgjue,
Mos dëgjojë ndo një fjalë,
Tue u heq' tue u xvarrue,
I rreh zembra palë-palë!
Kur afron te karakolli,
Dëgjon disa pëshpërime,
Kambët afër tij i solli,
Dhe dallon ca bisedime.

Aty ishin dy rrojtare,
Shok me shok po kuvëndonin,
Ç' kishte ndodhun, ç' kishte ngjarë,
Shoqi-shoqit i tregonin.
Mitka ri edhe mban veshin,
S' merr firomë, nuk lëvis,
I dëgjoj mirë se ç' theshin,
Shum' u vrâ, u sêkëlldis:
Mori vesh luftën që ngjavi,
Shokët, që ju vranë kot,



Kapi kryet edhe qavi,
Syt' e tij ju mbushnë lott!
Fort u droth, u turbullua,
U prish mëntsh e u mahnit,
Sÿn'i tij ju zgurdullua,
Mbet pa goj' e u nemit!
Por, e mblodhi prapë mëndjen,
Kohën më kot nuk e bjerr,
E peshovi mirë gjëndjen,
Ndonse zembra çurgon vner!

Karakollit i shkon njatë,
Edhë barkazi largohet,
E ndihmonte ajo natë,
Nat' e terrët, që s' harrohet.
Si e pa se kish shpëtue,
Mori rrugën për së gjati,
Tuke bredh' e tue nxitue
Me sa shpirt e fuqi pati.

Tash po kujton Rustemânë,
Shkakëtarin e mallkuem,
Dhe barbarin Qyrd-Pashânë,
Egërsirën e tërbuen!
Tash e njovi mirë mikun,
Tash e njovi tradhëtinë,
Tash e mori vesht anmikun,
Fort e vrau këjo të zînë!

Një zjarmë edhe një flagë
I përsllon shpirtin e gjorë,



Dhe kërkon të marrë shpagë,
Gjaku i vlon nër krahnorë!
I jep vehtes e trimnohet,
Ter' a laga e heth zarrin,
Rustemâjt po i drejtohet,
Që t' a vrasë gjakatarin!

Vjen e gjen shtëpin' e tij,
Hipën nga dal' mbi avllë,
Edhé hidhet në obor,
I rreh zembër e krahnor;
Nje dritare zë e hap,
E hyn brenda me një vrap,
As kurrkushi s' e kuptoj,
Se njeri ky nuku zgjoj.
Rustemâj po flé i humbun,
Pijaniku, sarahosh,
Se rakija e ka mundun,
Flé fat-keqi bukurosh!

Si një tigër e shituem
Prej gjujtarëve të saj,
Trupin plagë të ngarkuem,
Këlthet, pshertin pa uzdaj,
E ulrîn e dëshpëruem,
Me një sÿ të turbulluem,
Se i dhembin plagët shumë,
Se i shkon gjaku si lumë,
Dhe sado që e lëndojnë,
Sado gjak që i kullojnë,



Ajo dhimbjet i duron,
Sepsé shpagën dëshiron,
Ashtu dhe heroji jonë,
Gjakn' e shokëve kërkon,
Dhe sado qe e gjen vonë,
Ky gjaksorin s' e lëshon,
Po me nj' etje të pashojtun,
Gjoks e bark kërkon t' i çajë
Sa ata prej tij kan' vojtun
N' atë gjak të tij t' i lajë!

Brof prej supash, pra, e zuni,
M' kâmb' e çoj, mbi shtrat e vuni
Dhe ashtu si ish mbi shtrat
E ka pshtymun në surat,
Edhe zânin tue e dredhûn,
Një sÿ t' egër i ka hedhun,
Dhe kështu i flet tradhtorit,
Ktij të poshtrit, këtij horrit:
— Çohu, qen, bré qen, bir qeni,
Rob i poshtëm, i mallkuem,
Që s' të lan lumi, liqêni,
Për tradhtit' që ké punuem!
Ngreu, bré klysh, bré klysh ulkonje
Bir i bushtrës, horr, evgjit,
Ti që sheshash n' a tradhtonje,
Çohu shpejt e mos bërtit,
Se, për Zotin, mjaft një fjalë
Faqe-zi, po të shpëtoj,



Shpirti yt q' at ças ka dalë,
Jeta jote krejt mbaroj!

Psé, mor' njeri i fëlliqtë,
N' a u solle kaq i lik,
Psé n' a shite në anmiqtë,
Psé n' a fute në rrezik?
Psé më qafë kot n' a more,
Mos të bâmë ndo një faj,
Psé kaq djelm më kot i korre,
Kaq shtëpi shtive në vaj?
Nuk t' u tha e zeza gojë,
Kur n' a shite te Harrapi,
S' u hap dheu të të farrojë,
Kur n' a çove te kasapi?

Kështu foli Mitka i gjorë,
Rustemâj mbet, u nemit,
I ngriu gjak e kamb' e dorë,
Mbet si drû e u stapit!
Ju shpif hethja, tartakuti,
Këtij horri e laduti,
I kërcasin nofuj, dhambë,
Djersa i shkon gjer në kambë,
Frika eshtnat ja dërmoj,
Palc' e dëj i depërtoj!
S' ka guxim vehten t' a mbrrojë,
Ky i dobët burracak,
S' munt rrezikun t' a largojë,
S' i ka mbetun pikë gjak!



Se tradhtori kur stërditet
Me atë q' e ka tradhtuem,
Fjala me një her' i pritet,
Ç' far' do shpres' i është shuem,
Dhe s' i ban as kamb' as dorë,
Se mëkati e verbon,
Ngrin e bahet akull, dborë,
Gjaku i tjetrit e dënon!

Si një shtazë e drobitun,
Si një qen që s' të kafshon,
Ky njeri i neverritun,
Ndryshon si *hameleon*.

Përa Mitkës krye-ulun,
Me një herë gjynjëzon,
I përzishm' e i përkulun,
Me lot mëshir' i kërkon,
Po, kur pa e veshgëllovi
Se ç' do lutje kot i shkoj,
Uli kokën e pushovi
U nemit edhe nguroj!

— Për lugetët s' ka mëshirë,
I përgjigjet Mitkë plaku,
Për tradhtorët e pështirë,
Fjalën e ka vetëm gjaku!

Rustemâjt i del e pira,
E shëkon që s' ka shpëtim,
E fillon me fjal' të mira
Që t'a zbutin atë trim;



Por se Mitka s'dëgjon fjalë,
E përfshin e posht' e lé,
Me një pezm' e me një valë,
Giunin mbi krahnor i a vé!
Kërkon fytin t' ja përdredhë,
Si një pule, një këndezi,
Matet me revol t' i hedhë
E t'a shdukë krejt nga mezi,
Por ka frikë mos pikaset,
Edhé lagjen mos çqetsojë,
Me patrullat mos të haset
Dhe qëllimi mos dështojë!

Rustemâj *vé behriâjnë*
Po njeri nuk e dëgjon,
Syt' e tij me lott i qajnë,
Por nga Mitka nuk shpëton!
Dridhet i ziu si purteka,
Fort i zbetë në të pamë,
I ka mbrijt' *exheli*, vdeka,
I ka ardhun ora e mbramë!

Një nga një ata dëshmorë,
Ja përment atij fat-ziu,
Kamën e përdreth në dorë,
Dhe me gjashtë plag' e griu!
E godit kryq e tërthori,
I çan bark, i çan krahnor,
Zorë e mushkní i nxori,
Kshtu e vrau atë tradhtor!



E e la në një pellk gjaku,
Goj' e tij vjell shkumbë plot,
Edhé kamën tej e flaku,
Sÿsh ju derdhë nj' a dy lott!

Kishte dhanë kryet Hâna,
Mbi ç' do cep e mbi ç' do skaj,
Rustemâjt i ish e thana
Mos t' a shihte paskëtaj!
Ajo ish e fundit natë,
Që tradhtori nuk shpëtoj,
Sa shkaktoj ky dorë-thatë,
Atë natë i shpagoj!

Ishte afër më të gdhirë,
Gjâ s' lëviste as gjëkunt,
Mitkës ju duk e vështirë
Ajo natë që s' kish funt!
Veç një kang' e ngushëllonte
Nga sherif' e minarésë,
Ku një myezîn këndonte
Sabahinë, si mbas fesë!

Mitka rëmbeu revolverin
Me fyshek' ashtu si ish,
Heth mbi supet mauzerin,
Që Rustemi arm' i kish,
Edhé turret si rrufeja,
Një dritor' e shkapërxeu,
Shkel në rrug' e shkon si reja,
Dhé përpinën, posht' e theu.



Shtije sÿt' e sheh e përpjetë,
Kujton shokët me mallngjime,
Shpirt' i tij nuk është i qetë,
Zembr' e tij ngufon pikllime!
Desh t' i japë funt një jete,
Që ju dukte kaq mizore,
Desh të zbrazë dhe mbi vehte,
M' atë dorë aq' gjaksore,
Desh të lante një gabim,
Një gabim që s' e mohonte.
Deshte si një burrë trim,
Ndjesë shokye t' u kërkonte!
Por mendoj se gjakn' e tija,
S' kish të drejtë kot t' a bjerrë
Kish nevojë Shqipërija,
Për at' gjakn' e djelmve t' tjerë !

Ikën, ikën e largohet,
I kënaqun, po pa shpresë,
Do me shokët të bashkohet
T' u kërkojë gjithve ndjesë.

Ecën si një vang i çartun
Rruga gjatë ku e çon,
Edhë kryet tuke vartun,
S' shef përpara, as dëgjon!

Kur kalon nga Dunavecì,
Ulet pakëz e qendron,
Fuqí tjetër nuk i ngeci,
Shtrihet krahas e pushon.



Por s' u çloth aq' mir' i ngrati,
Prapë çohet pak-nga-pak,
Sÿtë me uj' i spërkati,
Plagët lan, q' i kish plot gjak,
Edhé me nga-dale niset
E vjen afër një mullini,
Afër jazit tij aviset,
Q' i gurgllon rëshqitas vini.
Hyni prapa një korrite,
Nënë lugun e saj fshihet,
Mizorit' e asaj dite
Desh t' harojë, desh të shtrihet.
E e merr një i âmbël gjumë,
Flé i ziu i rackapitun,
Ashtë lodhun, rregjun shumë,
I këputun, i drobitun!

Atjë gjithë ditën fjeti,
S' e pikasi as njeri,
U çloth dhe fuqin' e gjeti,
Por prap' i piklluem rí.

Si merr rrugën e përpjetë,
Has më një kopé me dhí,
Dhe bariu q' e njithe vetë,
I tregoj fatin e zí,
Gjâmën, që çetat pësuan,
Tmerin që panë me sÿtë,
Si u vranë e u shuan
E si s' patnë shok të dytë!



Mitka gati vargëllovi,
Shtërngoj zembrën, s' foli má,
Një pshertim nga zembra i dolli,
Ikën prapë e s' ban zâ;
Merr shushavat, arratiset,
Se ku shkoj s' e pa njeri,
Se ku gdhihet e ku ngryset,
Shêjë s' la ky trim i rí!...

Pak má von, nga Ramazani,
Në një kafé të çarshisë,
Kishte dal' ajy dushmani,
Ajy ndjeksi i djalrisë,
Q' i shkaktoj aq' shum' andralla,
Aqe burgje e sfilitje,
Aj kollazi Rexhep Palla,
Për dëfrim' e për zbavitje.
Mbi një fron ishte sheshue,
Kishte ndezun nargjilënë,
Si rà topi ja kish shtrua
Me rakin' e me mezenë.
Rrotull kish disa zabitë,
Që me Rexhepânë pinin,
I kish shoq, i kish të tjtë,
Rexhep Pallës pas i vinin.

Flisnin, qeshnin, llomotitnin,
Shanin, tallshin me Korçarët,



Ç' do ndyrsí prej goje qitnin,
Kusur s' lijnin për Shqiptarët!
Goj' e tyne kapërxente
Tullumbxhijt' e Gallatâsë,
Shpirt' i tyne vlonte, zjente,
Si kazan që do pëlcasë!

Shëmbëll s' kishte Rexhep Palla
Në fëlliqj' e në të sharë,
Nuk i djerste veshi, balla,
Por, . . . kish has' gozhda në sharrë,
Se Themistokliu Gërmëni,
Kishte kohë q' e vezhglonte,
Rrotull tij sillej si qëni,
Hapa-hapin e gjyrmonte!
Më së fundi rastin gjeti,
Mori pas Vasil Tromarrën,
Dhe Dalipin nga Përmeti,
Tok të tré e muar barën,
Edhé shpejt shtegjet i zunë,
Rexhep Pallën e qelluan,
Që të tré në plump e vunë,
Edhé poshtë e rëzuan!
Një gulçim nga zembra i doli
Ngufoj, thiri, ulëriti,
Një val' gjaku i shkreti volli,
Por patllaken dot s' e qiti!

Rexhepâj kot u mundua,
Huan vrasësve t' u kthejë,



Ky më kambë mâ s' u çua,
S' mundi dot t' u a shpërblejë,
Se, prej plagëve që mori,
Nuk' i mbeti as një shpresë,
Një vdekje mizor' e korri,
E pa bukur se do vdesë!

Kshtu kta horra u spastruan
Mbet e qetë Korça e gjorë,
Trimat t' onë triumfuan,
Shpagën e muar me dorë!

Hafûz Pasha kur u kthye,
Si i çmendun e i marrë,
Tjetër vepër don me krye,
Mitkën dëshiron t' a mvarrë!

Ditën tjetër, pa râ Djelli,
Dy xhelat' ishin gatí,
Por se kot u vajti zelli,
Mitka u shduk në arratí!
Mirallaj qënke hidhnuem,
Dhe zhandarët i qertoj,
Qënke bâ qën' i tërbuem,
Por se zogu....fluturoj!
Nami e mallkoj sa mundi,
Fshau e fshau po gjâ s' fitoj,
Kjo e keqe e lëkundi,
Shdukja e Mitkës i kushtoj!

Filloj prapë do marrina,
Do përdorte hekur, zjar,



Do të qitte ngatërina,
Do të vjerrte në litar,
Por rà randë i sëmutë,
Një lëngjyer e godit,
E përsilloj fort liksht në trutë,
Korçës qafet ky ju shqit!
Nga qyteti shpejt e ngritnë,
T'a dërgonin n' Anadoll,
Por nuk muntnë, nuk harritnë,
Ky dha shpirt mù në Stamboll!...

EPILOGU

Ishte or' e Shqipërisë,
Dita e bardhë kishte lé,
Kjo kulçedër e Turqisë
Mos të dukej mâ n' at' dhé!
Korça plakë dhe Korçarët
Qysh at'çash kishin shpëtue,
Me ata dhe gjith' Shqiptarët
Ç' do rrezik kishin kalue!
Shkrepi lufta e Ballkanit,
Kontinenti u ndryshua,
Mori funt jet' e Tiranit,
Dhe Shqipnija u lirua!
Mbi kështjellat e ç' do majë,
Valoj Flámur' i shentnuem,
U rilint shpres' e uzdajë,
U ringjall Komb' i shelbuem!



Por ata burra therorë,
Që për Kombin jetën dhanë,
Do të mbeten si dëshmorë,
Kujtim t' amëshuem lanë!

S' duhen qitun ne harresë,
Dhe ata që u ndihmuan,
Që me t' holl' e ç' do pagesë,
Kryengritsit i forcuan.

Një prej sijsh ish Luarasi,¹⁾
Që komitat i ndihmovi,
Në shtëpi te tij kush hasi,
Përkrahj' e shtektí ngjerovi.
Ky me t' holla e me libra,
Me përpjekj' e me mundime,
Pa një zhurmë e pa qibra,
Kombit i dha mjaft fitime.

Farën që mbolli Naimi,
Sami beu e Efthim Mitkua,
Kristoforidh Kostantini,
Veqil-Harxhi, Vretua²⁾, Çakua³⁾
Pjetër Budi e Bogdani,
Pashko Vassa e të tjerë,
Q' an' e kant u dolli zâni,
Geg' e Tosk' shkrimtar' të ndjerë,
Këta trima e patnë korrë,
Me pushk' e me shpat' në dorë!

1) Kristo P. Luarasi.

2) Jan Vretua Postenani.

3) Anton Çakua, Çajupi.



Këta ishin djelmt' e parë,
Për liri që derdhë gjakun,
Nga të paktët Shqipëtarë,
Që u muar Turqvet hakkun!
Lanë eshtnat aq' të vlerta,
Bash në vllugun e djalrisë,
Pra, statua të mermerta
Meriton kjo lul' e Arbnisë!

Sa të llampsin drit' e Qjellit,
Hyjt' e Hâna sa të jenë,
Sa të ndritë flaga e Djellit,
Tokë, detë e liqênë,
Sa rrutllon ky lamsh' i Dheut,
Ata trima do kujtohen,
S' vdesin, jo, djelmt' e Atdheut,
Hijet do t'u adhurohen,
Dhe mbi krye të ç' do varri,
Emnat lé t'u llamburitin,
Thurrun me kunora lari,
Brez-pas-brezit t' u shëndritin!

.....
Dhé të leht' e ndjesë patshin,
Më Parajs si ëngjej vajtshin!

F U N T



FJALORTH

i

DISA FJALËVE TË TEKSTIT

A

Ahenk: këngë, dërim me këngë e valle.

Alltar: tryez' e shëntrume, elter.

Amëshuem: i përhershëm, shekullor.

Ankth: siklet, randësi shpirti.

Angushti: ankth, mërzë shpirti.

Aparjas: heq dorë, më pritët shpresa.

Astrit: një farë gjarpni pullalli.

Avân: tiran, dhespot.

B

Bagllamâ: një farë bozikut.

Baluke: flokë që zënë ballin.

Befas: pa pritun, pa pandehun.

Beft: kap befas.

Behriâj: kushtrim, allarmë.

Bel: ndi mez' i trupit

Belth: gjith' ajo (mezi)

Beng: një lloj shpëndi, verdhash.

Bërlok: copë-copë. hi, pluhun.

Binek: hajvan qiraxhiu i ngarkuem.

Birrucë: vrim' e vogël.

Bishë: shtaz' e egër, derr' i egër, ujë.

Bli: një farë shelgu, që fletët e tij zjehen pëjen.

Bokë: kodrinë, sukth i mveshun me shelgje.

Bolbë: mjerim, e keqe, poterë, fat i zi.

Bubrec: një far' insekti, brumbull, krymp.

Bung: një farë lisi, përnar, çinar i vogël.

Burazân ose burazânë: shallvar, poture.



II

C

- Cak: vënt, tamam.
- Carrân: çerrep, votër.
- Cedonj: lëshonj, dorëzonj, baj havalé.
- Cmir: nakar, hasèt, zili.
- Curril: rëkë, vin' i vogël uji.

Ç

- Çart: prish, coptonj, shkatronj.
- Çarruvi: ngatrim, nderlikim, trillim.
- Çinar: rrap i motshëm.
- Çurgon: rrjedh çurk, gjerbon, pikon.

D

- Dallonj: çquanj, ndanj për së largu, zgjeth.
- Dangall: bark-math, shishman.
- Deli: i çmendun, i marrë.
- Div: i ranë prej Qjelli, hynor.
- Dokër: fjalë e trash' e e kotë, gjëpur.
- Drithronj: dua fort, dua përballshëm.
- Drudhëm: sulem, turrem, vrulem.
- Duhí: er' e marrë, stuhí.
- Dushnjë: shelgjishte të ulta, ferrishte
- Dynd: trondit, shungllonj.

Dh

- Dhæl: djallëzi, mejtím i keq.
- Dhjakonjar: lypës.
- Dhrom: udhë, rrugë.

E

- Enk (gu): i marrë, budallë.
- Etuem: ajy që ka etje.
- Evlíjâ: i mirë, i singertë, shëjtë.

F

- Fajkua ose fallkua: Shkyfter, petrit.
- Fatos: trim, burrë, herô.
- Fëllqinje: mundim, përpjekje.



Fërtymë: hov, vrulë, sulmim.
Flegë: fleta e derës, kanati i derës. (shum. flégurat)
Flegmatik: gjakftohtë.
Fli: theror, kurban, viktim.
Fqollë: i rahun e i krehun gati për m' u tjerrë.
Frushkull: kamçik, fshikull, kërbaç.

G

Gajas: më merret mëndja, fryma, më bjen të fikët.
Galamsh: i paralyzuem.
Galldim: gëzim, kënaqësi.
Gëm: degë shelgu, ose pëme.
Gërthas ose këlthas: thres, bërtas.
Gërxi: grykë malësh të thata, skërkë, thermopyl.
Gorren: murlan. tufan.
Grigje: kope, tufë, sogori.
Gurgullonj: vjonj, zjenj.

Gj

Gjepur: fjalë boshe, pallavër, dokër.
Gjeraqinë: femna e skyfterit.
Gjerbon: rrjeth, pikon.
Gjilldrim (Tr.): rrufë, zjarm Qjelli.
Gjyfkem: lodhem, këputem, aparjas.

H

Hajin (Tr.): andart, tradhtor.
Hameleon (Gr.): Një farë krymbit që ndron shpesh ngjyra.
Harbut: jo fisnik.
Hôn: luginë, valëe.
Horr: njeri i poshtëm, kopuk, i dobët fort.
Hulâr: një vegël bujqësore, që u venë qëve më qafë për më
 lëvrue.
Humnerë: poterë Zoti, mot i keq, stuhí.

J

Javer (Pr.): ndihmës, adjutant.
Javo: befas, atë ças.
Jehonj: tingllonj sa dëgjohet e përsritet zani.



IV

K

- Kanáre, ose Kanaré :** thertore, kasaphané.
Kangréné : mish i kalbët prej qelbi.
Kaproll : ndré ose drë.
Kashec : lëçitës, lajmtar, tellall.
Katallân : njeri i nalt' e i trashë, kykllöp.
Körnjal, ose körnjalë : det i hapët, oqean.
Kithi : njanas, shkarthi, tërthoras.
Kllapi : efiat, ankth gjumi, fantazmë, andër e keqe.
Kollas (koll-agasi) : kapitan ushtrieje.
Konop : litar.
Kontinent : tok' e gjat' e e gjanë.
Kopallë : fjal' e trashë, dokër, gjepur.
Kratër : grykë vullkani.
Krenar : kryenaltë.
Kreshnik : fatos, trim, sokol, i fortë.
Kreshperohem : çprishëm flokësh, më çohen flokët përpjetë.
Krongjill : kristall, akulli që bahet prej pikësh e që ndrit.
Krydh, ose kryth : fundos në ujë, zhyt.
Kumbonj : baj si kambana, tingëllonj.
Kumtonj : baj me dijt, komunikonj.
Kurreshtim : kuriozitet.
Kurth : leq, çark minjsh, grackë.
Kushtrim : lajm, parollë, shëj allarmi.
Kuvli : kafas zoqsh.

L

- Labiç ose labiç :** lufgat, xhind, kusar i natës.
Lamë : lëmë, fushë nderi, olok, patalok.
Lanët : i namun, i mallkuem.
Lar : dafinë.
Legjendar : shekullor, historik, mythologjik.
Lëq : kurth, grackë që zanë zoq.
Lodër : lojnë, daulle.
Lubi : llamje, kulçedër, drangû.
Luk (gu) : sifun, koritë druni.

LI

- Llanternë :** fener nate.
Llaz : vendas i Llazistanit.



Llas : fuqí, kurajo.
Llastim : përkëdhelje.
Llogor : vent strategjik, istiqám.
Llurrit : një farë gjarpni me vijza e i tmershëm.

M

Magjup : jetk, evgjit.
Majtas : nga an' e majtë, ose nga e mëngjera.
Mbrinj : harrinj.
Mek : gajas, i pres fuqinë dikujt.
Mëngjis : mjekonj, shëronj.
Mërgim : largim, kurbet.
Merqéz : qendrë administrative.
Mërqinjë : ferrë, ferrishte.
Mitë : ryshfet.
Mjak : vdes për bukë, lodhen, kapitem, mjaftonj.
Monopat : rrug' e ngushtë për njerës, ose shtëza.
Mriz : vënt i fshehtë, limer.
Murg : i mjerë, i përzishëm.
Murlân : tufan, gorrën, er' e marrë.
Murrâsh : i murmë, zheshkan.
Murrizë, ose mrrizë : ferrë, mërqinjë.
Muzg, ose muzgë : vallto, vurrk, kënetë.

N

Ndraq : fëlliq, pëgënj, leros.
Ndrydh : mbyll, shtërngonj pisk.
Ndrynj : mbyll mbrenda me çelës.
Ngec : ndalem, mbetem, qendronj.
Ngel : pengohem, ndalohem.
Ngjoti : gjetkë, gjetiu, në tjetër vënt.
Ngjiz : shkaktonj
Ngufonj : fuskosem, mbushem me vner, me siklet.
Nguronj : mbetem si guri.
Njanas : nga njana anë.
Njatë : afër, anës, përbrí.
Njollë : leqé, mynxyrë.
Nopran : gojë-prishun.
Nuhat : mar erë me húndë, gjyrmonj.



VI



Ograjë : kullotë, livath, merâ.
Onbash : tetar (dhetar i ushtris turke).
Ortë : çetë, taraf, kompani.
Orvat : punonj, lëvronj.

P

Pasvant : rrojtar nate.
Përdëllim : mëshirë.
Perrëpinë : tatëpjetë.
Pezme : inat, zembrim.
Pijtas : mpijtas, me frikë, me drojë.
Pingall, ose pinjall : kamë, stileto.
Pirollo ! : bravo, të lumtë, aferim.
Pizgë : pipëzë, gërnetë e vogël (klarinetë jevgsh).
Plânk : rësk, mall, pasuní, randësinë.
Plok : bjeshkë, vri, vent malsor i veshun me shelgjë.
Polem : popull, llaús.
Prehje : qetsí.
Preje, ose Pré : kusari, grabitje.
Prozhmë : bjeshkë, pyllishte.
Pullás : kulm, çatí.

Q

Qé : shëko, kqyr, ja!
Quar : qllar, katua, budrûm.
Qymë : tufë, kopë, grigjë.
Qyrd : vendas i Qyrdistanit.

R

Rackapitem : coptohem, lodhem fort, këputem.
Rang (gu) : sërë, rrjeshtë, radhë.
Raqe : levere, lecka.
Ravë : ndërmjeti midis dy, ose má shumë reve..
Regjem : lodhem, ropatem, punohem.
Rëshqitas : tuke shkarë.



Rr

Rrap: çinar, një farë lisi i gjatë.

Rrushkull: një farë gjambi.

Rrymë: rrjedbë e ujit, vrulë.

S

Sajonj: numuronj, llogaris.

Savat: argjënt, sërmë e punueme.

Sdrulë: një lloj gjambi që çpon keqas.

Skërkë: grykë, ose luginë midis dy maleve të thata.

Skundill: pëqin' i një mali.

Sllok: vënd' i naltë pyllor.

Sogori: kopë qënsh, ujqsh, çakajsh.

Sokëllin: buçet, gjëmon, ushton.

Sorrollatem: sillem rrotull, vërdallë.

Spalorë; batarë pushkësh.

Spillohem; nisem, stolisem.

Stalis; storas.

Stelë; folë, ose çerdhë egërsinash.

Stërdit; has. takonj, gjenj përpara.

Stërflokem, çprishem flokësh.

Stihi (Gr.), hiçe, llamje, kulçedër.

Stuhi, er' e marrë, murlân.

Sukë, kodrin' e veshun me shelgje.

Sung, një farë lisi i ulët.

Sungji, shish, kasaturë, bajonetë.

Sy-qutë: i zgjutë.

Sh

Shakllaban, llapazân, njeri që të mërzit së foluni

Shakullinë, er' e shi bashkë, breshëri.

Shejtar: ajy që shtije mirë më nishan, nishanxhë.

Shelbonj: shpëtonj një njeri prej rrezikut.

Shitonj: plagos.

Shlligë: hij' e keqe.

Shpat: pllajë mali me lisa, ose me bredha.

Shpinë: kurris.

Shprohë: llamje, kulçedër, drangua.



VIII

Shqerbe: egërsinë, bishë.
Shqimit: krejt, me gjithsej.
Shtangem: hiqem më nj'anë, ndahen pa bā fjalë.
Shtërpar: barí që kullot berrat shtërpa.
Shtërpi: shtazë përdhese si kur se ardhusha, gjarpni.
Shtrokull: çerdhë egërsinash.
Shujzë: pijavicë që thith gjakun.
Shushavë: arratí, çporje.
Shytonj: lé shyt, shkurtonj, gërshtënonj.

T

Tamthet: të dy anët e kokës andej e këtej ballit.
Tërmal ose tërmall: anë mali.
Tërplotë: lopatë hekuri, ose druni.
Trant: shkunt, tunt.
Trishtim: hidhnim, acarim, mellankoni.
Trojë: mall, pasuni e palujshme.
Turfullon: kur kali shkunt turrinjt'e hëngëllin.

Th

Thark: kënetë, moçal, vure, vallto.
Thimar: një farë shelgjishte që mban erë të mirë.
Thundronj: shkel me thundrë.

U

Ugursëz: pa ugúr, pa fat
Utronj: gjëmonj, ushtonj, buças
Uzdajë: shpresë.

V

Vang: rrotë qerreje, ose mullini.
Vargëllonj: më bije të fikët, vilani.
Vargua: vark, zinxhir.
Varfë: dervish.
Varrë: plagë.
Varvat: i tredhun, hanuer.
Vershon: mbushet rrafsh sa derdhet, teptis jashtë, inondon.



- Vërtik** : shpejti. (Vërtik plumbi).
Vesvesë : dyshim, ndërtime.
Veshillon : ka produkt të math, lulëzon e ent mirë (Arat veshillojnë, kur se pemët zërdëlljnë = janë plot pemë).
Vezmë : fyshekllek, gjerdhan që venë fyshekët.
Vigân : gjigand, herô, shprohë.
Vikas ose Vikat : bërtas, thres sa munt.
Vjerr : mvarr. (U vorr në litar = u. mvarr).
Vlak-gu : lagshtinë, njohmësi, pikë lagshtine.
Vluk-gu : lulja e moshës.
Vrazhët : vrejton.
Vrell : mburim, pus.
Vrëngëllim : zhurmi i shpatës kur bën „vring, vring“.
Vrëngër : të pamit shtrembët, çakërthi.
Vrëngët (i) : ajy që shef shtrembët, çakëri.
Vrik : shpejt, me vrap.
Vrug-gu : myk, muhlë, ndryshk, mërshtë.

Z



- Zagushi** : e nxehtë e madhe, vapë.
Zallahi : furtunë deti, tallas.
Zurná : gajde, gërnetë kurbatësh
Zbehem : mverdhem në fytyrë, më priset fytyra, më ikën gjaku.
Zylnë : famë, emën (gloire).

Zh

- Zhugë** : thupra kënetash.
Zhyt : kryth, fundoj në ujë.

Xh

- Xhurrá** : fyell, xhamarë, çudak



E r r a t a

Faqe	radhë	në vënt	këndo
7	12	shqagën	shpagën
7	20	t' i lenë	m' i lanë
8	24	Ijenën	Hijenën
10	11	trashigimí	trashgimí
14	22	Ehé	Edhé
15	7	Prevera	Preveza
16	12	Lubojnë	Lubonjë
16	27	Komitetiti	Komiteti
16	nën.20	Gavril Reppua	Gavril Pëppua
26	15	merrnin	mernin
35	24	dorriu	doriu
40	5	Rruji	Ruhi
48	16	i fortë	i fort'
50	17	djalarija	djalrija
55	12	thot'	thotë
58	22	të tij'	të tijt'
60	24	të fushës	të fush's
61	32	Frymzoji	Frymëzoji
68	9	Dke	Dhe
70	1	djeni	djeni
79	9	Do të lem'	Do të lam'
84	6	e ngatjeton	e ngjatjeton
86	2	Baj	Ban
91	15	Mbrëti	Mbreti
92	6	i shpërdavi	i shpërndávl
93	7	deri	der'
95	2	Shteti	Shtetit



<u>Faqe</u>	<u>radhë</u>	<u>në vënt</u>	<u>këndo</u>
95	17	here	herë
99	28	e pikllovi	e pikëllovi
103	7	Njiten	Ngjiten
104	4	uní	urí
123	19	Çavurrí	Çarruvi
126	10	shkëterrë	Sketerrë
131	27	kapetani	kapitani
133	13	ordhi	ordhí
134	24	të tërbuem	të tërbuem
136	22	rrymë	frymë
136	12	fisnike	fisnike !
143	20	Që e murn'	Q' e muar
143	26	n sharrë	në sharrë
148	9	Paskam	Paskan
151	1	ushtri	ushtrí
154	26	Si t' a fsheh	Si t'a fsheh'
156	22	Pa fyshekë	Pa fyshek'
158	28	U ngarknan	U ngarkuan
160	25	të këuaqun	të kënaqun
165	17	E qesh	E i qesh
166	12	trathtor	radhtor
166	24	trekambëshen	trikambëshen
172	6	killapi	killapí.
175	18	të poshtrit	të poshtmit

— Ndollinat që tre gojmë kanë ngjã më 1911, në muajin Kë
— Kërkojmë ndje së edhe për disa të tjera gabime ortho-
fike që a' a patnë shpëtue, për shkak ngutsije shtypi.



Veprat e auktorit

I. POEZË

Tingëllimet e zembrës (e konsumuar).
Shkëndijat
Qerthurri Politik.
Shqiptarët
Tallaze e Valë (e pa shtypur).
Dëshmorët e Rilindjes.
Fé e Kombësi.
Epopëja e Vlorës. (e pa shtypur).

II. DRAMA E TRAGJEDË

Karlo Topiija.
Pirro Neoptolemi.
Skënderbeu n' Itali, (e pa shtypur)
Virgjinesha ose Fatzeza.
Qyprillinjtë.
Meço Qafëzezi
Të dy rështerët, (përkthim)
Atdheu.
Fedora.
Mreti Oedipus. (tragjedi klasike e pa shtypur).
Antigoni
Elektra.
Medëja.

III. KOMEDË

Rrogat e nëpunësve.
Lojnat e studentëve. (e konsumuar).
Do të vras vehten.
Vllazni e interesë.
E bija e banqerit.
Dhëndër me përdhunë.



Merre t'a marrim.	(e konsumuar)
Nder e qytetni.	• •
Kundrështarët e prikës.	• •
Pësimet-mësime.	
Zi e më zi.	
Reklamë e blufë.	
E mbes'e krahinarit.	
Akraballëket.	
Ministri Kandidat.	
Doktorilëket.	(e pa shtypur).
Veteranët.	• •
Përfundimet e zhalluzisë.	• •
Viktimit e modhës	• •
Të pavluarit - të vluar.	• •
Kopracl.	• •
Usta - Patozi.	• •

IV. TË NDRYSHME.

Administrata, me 500 faqe.	
E Drejta themelore (e konsumuar).	
Ekonomi politike e sociale (e pa shtypur).	
Ligja mbi ekzekutimin e gjyqimeve.	• •
Historija e Greqisë së vjetër për gjymnaz. (pa shtyp).	
Historija e Romanëve.	• •
Karakterl. (përktbim prej anglishtes,	• •
Kosova - Sërbë e vjetër!	• •
Patriotizmë e Nacionalizmë.	
Fjalor i plotë i gjuhës shqipe (fjalë 22.300).	

V. FARSA.

Shpina e jeme.
Një natë tmerri.
I marri mentsh.

